INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE E KULTURORE TË SHQIPTARËVE – SHKUP

# *70–VJETORI I BOTIMIT TË GAZETËS "FLAKA E VËLLAZËRIMIT"*

*(Tribunë shkencore, 4 prill 2015)*

- 10 -

Shkup, 2015

Boton:
**INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE E KULTURORE TË SHQIPTARËVE –**
SHKUP

Vëllimi 10 – 2015

Biblioteka: **SCUPI**

Kryeredaktor:
*Dr. Zeqirija Ibrahimi*

Këshilli redaktues:
*Dr. Sevdail Demiri*
*Dr. Skender Asani*
*Dr. Sefer Tahiri*
*Dr. Mixhait Pollozhani*
*Mr. Ardian Limani*

Sekretar i redaksisë:
*Mr. Agron Salihi*

Redaktor teknik:
*Naser Fera*

Copyright© ITSHKSH, 2015
Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për botuesin.

ISBN 978 –608–4653–26–4

Botohet me vendimin e Këshillit të ITSHKSH–së nr. 0201–236/8
të datës 23.6.2015.

www.itsh.edu.mk

INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE
E KULTURORE TË SHQIPTARËVE – SHKUP

# *70−VJETORI I BOTIMIT TË GAZETËS “FLAKA E VËLLAZËRIMIT”*

*(Tribunë shkencore, 4 prill 2015)*

# *70 ГОДИНИ ОД ИЗДАВАЊЕТО НА ВЕСНИКОТ „ФЛАКА Е ВЕЛАЗЕРИМИТ“*

*(Научна трибина, 4.4.2015, Скопје)*

# *THE 70TH ANNIVERSARY OF PUBLISHING THE NEWSPAPER "FLAKA E VELLAZERIMIT"*

*(A scientific tribune, 4.4.2015, Skopje)*

- 10 -

**SCUPI**

Shkup, 2015

# TRYEZA E LËNDËS:

NË VEND TË HYRJES ........ 7

**SKENDER ASANI:** FJALË PËRSHËNDETËSE... ........ 11

**NASER SELMANI:** FJALË PËRSHËNDETËSE... ........ 13

**SEVDAIL DEMIRI:** 70–VJETORI I BOTIMIT TË NUMRIT TË PARË TË GAZETËS "FLAKA..." ........ 16

**ISMET OSMANI:** PUBLICISTI, PEDAGOGU DHE STUDIUESI PETRO JANURA (1911–1983) ........ 24

**FEJZI BOJKU:** FLETË NGA DITARI... ........ 29

**TAHIR ZAJAZI:** "FLAKA..." E VËSHTRUAR NGA KËNDI PEDAGOGJIK DHE KULTUROLOGJIK ........ 64

**XHELADIN MURATI:** KONTRIBUTI I "FLAKËS" NË AFIRMIMIN E MENDIMIT PEDAGOGJIK ........ 83

**BERTON SULEJMANI:** KUJDESI NDAJ NORMËS GJUHËSORE PARA DHE PAS 1972–SHËS NË GAZETËN "FLAKA E VËLLAZËRIMIT" ........ 94

**ZEQIRJA REXHEPI:** GAZETA "FLAKA", MEDIUM NË TË CILIN BESOJA ........ 109

**DAUT DAUTI:** NJË BETEJË MADHORE E FITUAR NË MONIZËM DHE DËSHTIMI NË PLURALIZËM ........ 117

**MIXHAIT POLLOZHANI:** – *NGA NOTESI I NJË KORRESPONDENTI* – KRONIKË STRUGANE DHE GJURMË KOHËSH ........ 137

PAMJE NGA TRIBUNA DHE EKSPOZITA ........ 147

# NË VEND TË HYRJES

Më 4 prill të vitit 2015, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve (ITSHKSH) në Shkup, në bashkë–punim me Shoqatën e Gazetarëve të Maqedonisë (SHGM) dhe Shoqatën e Historianëve Shqiptarë të Maqedonisë (SHHSHM), shënoi 70 vjetorin e botimit të numrit të parë të gazetës shqipe "Flaka e vëllazërimit".

Me këtë rast, në ambientin e Institutit, u hap ekspozita me disa fotografi – imazhe të gazetës "Flaka..." ndër vite, ku edhe u zhvillua një debat i ngjeshur lidhur me kontributin e kësaj gazete ndër vite.

Sefer Tahiri nga Këshilli organizativ, tha se një muaj më parë ishte bërë ftesë publike për të gjithë të interesuarit për të marrë pjesë aktive në këto aktivitete, dhe se një pjesë e protagonistëve kryesorë të gazetës "Flaka", iu kishin përgjigjur thirrjes.

Ndërsa, Skender Asani, drejtor i ITSHKSH, duke folur për rëndësinë e gazetës në fjalë, tha se "Flaka" paraqet një konti–nuitet të zhvillimit të shtypit shqiptar në këto troje, që nga ga–zeta "Bashkimi i Kombit" në Manastir e "Shkupi" në Shkup, dhe si e tillë ka zënë një vend të merituar në historinë e shtypit shqiptar. Sipas tij, gazeta "Flaka" është një trashëgimi e pasur kulturore e historike e shqiptarëve të këtyre trojeve, dhe si e tillë meriton vëmendje dhe kujdes të veçantë institucional.

Naser Selmani, kryetar i SHGM–së, tha se pushteti komunist gazetën e themeloi për qëllime ideologjike, por megjithatë

nuk duhet të mohohet roli pozitiv që ka luajtur kjo gazetë në informimin në gjuhën shqipe. "Ndër vite, qindra gazetarë, në mesin e tyre edhe emra të shquar të letrave shqipe, me shumë guxim dhe përkushtim profesional, kanë trajtuar çështje jetike për lexuesin shqiptar", tha Selmani.
Në vazhdim, një referat historik për 70 vjetorin e botimit të numrit të parë të gazetës "Flaka...", në emër të Këshillit organizativ e paraqiti koordinatori Sevdail Demiri, i cili tha se në vend se ky përvjetor i 70–të të shënohej me akademi solemne dhe me një format më festiv nga vetë udhëheqja e gazetës, sot po shënohet në mënyrë modeste – përkujtimore nga Instituti dhe dy shoqata respektive. "Derisa simotrat e saj, sot vazhdojnë të jenë ndër gazetat më të lexuara dhe të respektuara në vend, 'Flaka...' po bën gati se një dekadë që ka kaluar në histori", u shpreh Demiri.
Ndërsa, Naser Selmani, në emër të Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë, i dorëzoi Mirënjohje post mortum Petro Janurës – kryeredaktorit të parë të gazetës "Flaka e vllaznimit", të cilën mirënjohje e pranoi i nipi i tij, avokati Petro Janura.
Më pas, në debat aktivisht morën pjesë ish–kryeredaktorët e gazetës: Fejzi Bojku, Abdylhadi Zylfiqari, Faik Mustafa, Zeqirja Rexhepi, Daut Dauti, ish–redaktorët e gazetarët Halil Zendeli, Shkëlzen Halimi, Nazif Zejnullahu, Mixhait Pollozhani, Tahir Zajazi, Xheladin Murati, Mustafa Peza, Enver Shala, Abdurrahman Kurtishi, studiuesi Blerton Sulejmani, etj[1]. Të gjithë këta

[1] Në këtë botim janë përfshirë vetëm se ato kontribute të pjesëmarrësve cilët janë sjellë në formë të shkruar deri te Këshilli organizativ. Ndërsa, në pjesën e fundit të këtij botimi, në formë të fotografive paraqesim disa pamje të tribunës dhe një pjesë të ekspozitës.

folën për aspekte të ndryshme të kësaj gazete ndër vite, dhe sidomos duke vënë theksin në humbjen e këtij brendi të rën–dësishëm, me të cilin u rritën gjenerata të tëra.

Gazeta "Flaka..." dhe revistat e saj "Fatosi" dhe "Gëzimi", u vlerësuan si trashëgimi kulturore e historike të shqiptarëve të Maqedonisë. Një nga konkluzat e debatit ishte, që të shqyrtohet seriozisht mundësia e ruajtjes së asaj që ka mbetur pa u zhdukur deri tani. Një punë shumë e rëndësishme dhe e mundur të realizohet, është digjitalizimi i plotë i gazetës, për ta parandaluar shkatërrimin e plotë të arkivit të saj që në gjendje jo shumë të mirë, gjendet në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Shkupit, ndërsa parcialisht në disa biblio–teka tjera. Ky projekt kërkon mbështetje serioze nga institu–cionet shtetërore.

Çështja e mundësisë së rikthimit në jetë të emrit të "Flakës", gjithashtu ishte një nga impenjimet serioze të të gjithë pjesë–marrësve, të cilët theksuan nevojën urgjente për një hap të tillë sa më shpejtë që të jetë e mundur.

*SKENDER ASANI*
*Drejtor i Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup*

# FJALË PËRSHËNDETËSE...

Të nderuar të pranishëm.

Fillimisht më lejoni që të shprehë mirënjohjen time dhe të institucionit që drejtoj, për interesimin dhe prezencën tuaj në këtë shënim të rëndësishëm për historinë e gazetarisë shqiptare në Maqedoni – 70 vjetorin e botimit të numrit të parë të gazetës "Flaka e vëllazërimit".

Ç'është e vërteta, historia e gazetarisë shqiptare në Maqedoni, rrënjët i ka më të thella se sa 70 vjet më parë. Pas Revolucionit Xhonturk të vitit 1908, intelektualë të shquar nga të gjitha trevat shqiptare, në Manastir dhe Shkup zhvilluan një veprimtari të ngjeshur kulturore e arsimore, mes tjerash, duke vënë edhe bazat e publicistikës shqiptare të këtyre trojeve.

Kështu pra, gazeta "Flaka e vëllazërimit" paraqet një kontinuitet të zhvillimit të shtypit shqiptar në këto anë, që nga gazetat "Bashkimi i Kombit" në Manastir e "Shkupi" në Shkup, dhe si e tillë ka zënë një vend të merituar në historinë e shtypit. Në gazetën "Flaka..." defiluan pena të njohura të gazetarisë shqiptare, duke ndikuar fuqishëm në arsimimin dhe kulturimin e masës shqiptare në Maqedoni, në kushtet e vështira pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore.

Edhe pse kjo gazetë doli nga një sistem politik i cili më vonë u bë i njohur për shtypjen dhe nëpërkëmbjen e interesave kombëtare të shqiptarëve, megjithatë, ky institucion e luajti rolin e tij më së miri që ishte e mundur, në korniza të mun–dësive të veprimit që i lejoheshin.

Sëkëndejmi, gazeta "Flaka" paraqet një trashëgimi kulturore e historike të shqiptarëve të këtyre trojeve, dhe si e tillë meriton vëmendje dhe kujdes më të madh institucional dhe shoqëror. Prandaj, është një obligim i jonë si shoqëri në përgjithësi, që të merremi më seriozisht me kultivimin dhe valorizimin e asaj tradite të gjatë të shtypit tonë, e cila fatkeqësisht u ndërpre atëherë kur ishin të gjitha mundësitë që ajo të vazhdojë të zhvillohet edhe më fuqishëm në tregun pluralist të mediave.

Ju faleminderit për kujdesin, dhe uroj të zhvillojmë debat të frytshëm...

*NASER SELMANI*
*Kryetar i Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë – Shkup*

# FJALË PËRSHËNDETËSE...

Të nderuar kolegë,
Zonja dhe zotërinjë,
E nderuara familje Janura.

Sot mbushen 70 vjet, nga botimi i numrit të parë të gazetës "Flaka e vëllazërimit". Ky jubile i rëndësishëm është ditë e shënuar për shqiptarët e Maqedonisë. Të pakta janë institucionet shqiptare që kanë frymuar gati një shekull në gjirin e shqiptarëve të këtushëm.

"Flaka e vëllazërimit" ka luajtur një rol shumë të rëndësishëm në emancipimin kulturor dhe politik të shqiptarëve. Kuptohet, për mua si gazetar dhe kryetar i Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë, roli më i spikatur është ai i informimit në gjuhën shqipe, nga themelimi i gazetës në vitin 1945, e deri në mbylljen e saj.

Pushteti komunist gazetën e themeloi për qëllime ideologjike, megjithatë nuk duhet të mohohet roli pozitiv që ka luajtur gazeta në informimin në gjuhën shqipe. Ndër vite, qindra gazetarë, në mesin e tyre edhe emra të shquar të letrave shqipe, me shumë përkushtim dhe guxim profesional, kanë trajtuar çështje jetike për lexuesin shqiptarë. Duke përdorur atë pak liri dhe hapësirë veprimi, ata shpeshhere kishin bërë të pamundurën, që me shkrimet e tyre të faktojnë gjendjen e

vërtete të shqiptarëve gjatë periudhës komuniste. Prandaj, shfrytëzojë rastin, në emër të Shoqatës, t'iu shpreh mirënjohje të thellë për kontributin e tyre të çmuar për informimin e drejtë në gjuhën shqipe.

Gjatë tranzicionit demokratik, "Flaka e vëllazërimit" ishte media më me ndikim ndër shqiptarët e Maqedonisë. Ajo u bë gazetë e përditshme dhe ishte shndërruar në zë të fuqishëm të opinionit demokratik shqiptar në Maqedoni.

Unë jam shumë me fat që karrierën time si gazetar e fillova pikërisht në "Flakën e vëllazërimit". Ajo për gazetarët shqiptar ishte shkollë gazetarie. Me githë respektin për mediat tjera në gjuhën shqipe, megjithatë, "Flaka" do të mbetet brend në gazetarinë shqiptare në Maqedoni, sepse ka luajtur rol qëndror në zhvillimin e gazetarisë në gjuhën shqipe.

Me këtë rast dua të theksoj edhe kontributin e gazetës për kultivimin e gjuhës, arsimit dhe kulturës shiptare. Flaka ishte institucioni i vetëm shqiptar që u bëri ballë të gjitha presioneve të pushtetit komunist për shpërfytyrimin e toponimeve shqiptare. Për "Flakën", çdoherë Shkupi mbeti Shkup, e Manastiri – Manastir.

Sot, kur shënojmë 70 vjetorin e themelimit të gazetës "Flaka e Vëllazërimit", si gazetar, nuk mund të mos e shpreh indinjatën time, sepse gazeta nuk është më mes nesh. "Flaka" u shua në mënyrën më të keqe të mundshme. U shua nga neglizhenca, injoranca, primitivizmi i njërëzve të papërgjegjshëm të politikës. Kaq pushtet kanë partitë shqiptare, një ga–

zetë, që dëshmon për memorien kolektive të shqiptarëve ndër vite, s'qenë të zotët ta mbajnë gjallë.
Një thesar të çmuar si "Flaka", që me shumë saktifica e kishin themeluar, ndërtuar dhe ruajtur ndër vite gazetarë dhe intele–ktualë shqiptarë në kohën e komunizmit, e mbyllën batakçijtë e demokracisë.
Me këtë, nuk dua të shfajsojë veten. Secili prej nesh mbanë një pjesë të përgjegjësisë për shuarjen e "Flakës". Të gjithë e morëm si fakt të kryer duke treguar mungesë vetëbesimi.
Një popull që nuk di të respektojë vlerat e veta, nuk mund të pres të respketohet nga të tjerët.
Faleminderit!

***Sevdail Demiri***
*Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup*

## 70–VJETORI I BOTIMIT TË NUMRIT TË PARË TË GAZETËS "FLAKA..."

Të nderuar të pranishëm...

Në vend se ky përvjetor i 70–të i gazetës "Flaka e vëllazërimit" të shënohej me akademi solemne dhe me një format më festiv nga vetë udhëheqja e gazetës, sot po shënohet në mënyrë modeste – përkujtimore nga Instituti jonë dhe shoqatat respektive.

Derisa simotrat e saj, sot vazhdojnë të jenë ndër gazetat më të lexuara dhe të respektuara në vend, "Flaka" po bën gati se një dekadë që ka kaluar në histori.

Por, pavarësisht nga kjo, dhe pavarësisht nga zërat që edhe sot e kësaj dite vazhdojnë të hedhin gurë e dru për "Flakën" dhe të kaluarën e saj, ne megjithatë kemi vendosur që sot ta shënojmë 70 vjetorin e botimit të numrit të parë të kësaj gazete. E bëmë këtë duke u nisur nga arsye thellësisht parimore dhe profesionale, duke mos i parë gjërat bardh e zi, por me gjithë larminë dhe mozaikun e tyre në kontekstin e caktuar kohor. Pra, e bëmë këtë për të vlerësuar punën e një institucioni mediatik, i cili edhe pse në kohë dhe rrethana të caktuara politike, shumë të rënda për shqiptarët, luajti rol të madh në

procesin e arsimimit dhe kulturimit të shqiptarëve të Maqedonisë dhe më gjerë.

Të nderuar të pranishëm.

Tani më lejoni të themi disa fjalë për historikun e botimit të gazetës "Flaka e vëllazërimit" [2].

Gazeta në fjalë, me një ekip të vogël redaktues, e përbërë nga 4–5 njerëz, më tepër amatorë në këtë profesion, filloi të botohet në pranverën e vitit 1945 në Shkup. Me kalimin e viteve, ajo u zhvillua në një magnat mediatik, në të cilin u pasqyruan nevojat, problemet, mundësitë dhe aspiratat e shqiptarëve të Maqedonisë, në sferën e politikës, ekonomisë, sociales, kulturës, artit, arsimit, argëtimit, sportit, etj.

Domethënë, kur flasim për shtypin informativ shqip në Maqedoni pas Luftës së Dytë Botërore (LDB) e deri në kohën e pluralizmit politik, asociacion të parë e kemi gazetën e vetme në gjuhën shqipe të asaj kohe "Flaka e vllaznimit".

Numri i parë i gazetës "Flaka e vllaznimit" doli nga shtypi më 4 prill të vitit 1945 në Shkup, si "organ i Frontit Nacionalçlirimtar për Shqiptarët e Maqedhonisë". Ajo, që nga viti 1945 së pari filloi të botohet një herë në dy javë, pastaj që nga viti 1958 një herë në javë, nga viti 1971 tri herë në javë, që të bëhet gazetë e përditshme informative që nga viti 1994, dhe për fat të keq, dhjetë vjet më vonë të shuhet përgjithmonë, në

[2] Pjesa më e madhe e këtij punimi mbështetet në disertacionin e doktoraturës së autorit, mbrojtur në Institutin e Historisë Nacionale në Shkup, më 10.10.2013: "Shtypi shqiptar në Maqedoni 1945–1991 (aspekti kulturor–arsimor)";

kohën e pluralizmit dhe demokracisë, kur u privatizua dhe për pak kohë shkoi në histori.
Nga gjiri i redaksisë së gazetës "Flaka...", në vitet e pesëdhjeta dolën edhe revistat për fëmijë "Gëzimi" (1950), dhe më vonë "Fatosi" (1955), të cilat në fillim formalisht botoheshin në kuadër të "Detska radost". Në vitin 1962 fillon botimin revista prestigjioze për shkencë, art, letërsi dhe kulturë "Jehona", e cila edhe pse formalisht ishte e ndarë nga gazeta "Flaka...", në të punonin një pjesë e madhe e gazetarëve të saj me përvojë. Revista "Jehona", në fillim të viteve të 70–ta bëhet pjesë e veprimtarisë gazetare–botuese të redaksisë së gazetës "Flaka...".
Poashtu, me siglën e "Flakës..." u botuan edhe qindra tituj të librave të ndryshëm me mijëra ekzemplarë, më tepër nga sfera e letërsisë shqipe (për fëmijë dhe të rritur), si dhe përkthime nga gjuhët tjera.
Gazeta "Flaka...", sikurse edhe pararendëset e saj "Nova Makedonija" në gjuhën maqedonishte dhe "Birlik" në gjuhën turke, kishin shumë ngjashmëri njëra me tjetrën. Ato ishin organe të Frontit Popullor të Maqedonisë, dhe e reflektonin strukturën nacionale të vendit. Këto organe shtypi u udhëhoqën në mënyrë të drejtpërdrejtë nga ana e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Maqedonisë dhe Komisionit të saj për Agjitacion dhe Propagandë.
Redaksitë e këtyre gazetave u formuan në Shkup, dhe u shtypën në shtypshkronjën "Goce Dellçev" në fshatin Vranovc i Epërm i Velesit. Përgatitjet rreth hapjes së këtyre gaze–

tave, i kishte bërë Shtabi kryesor i Frontit Popullor të Maqe–donisë, me një grup të aktivistëve shqiptarë dhe turq. Ashtu si "Nova Makedonija", edhe "Birlik" dhe "Flaka e Vllaznimit", objektivat e tyre themelore i përputhën me kushtet specifike në të cilat Maqedonia u gjet menjëherë pas luftës, por ato duhej të ishin në përputhje edhe me kushtet specifike me të cilat jetonte popullsia shqiptare dhe turke.

Meqë gazeta filloi me punë në fund të Luftës së Dytë Botëro–re, edhe tematika e përshirë në përmbajtjen e saj, ishte e li–dhur kryesisht me luftimet e fundit që në atë kohë zhvillohe–shin në frontin e Sremit, ku në kuadër të korpusit të XV–të të ushtrisë jugosllave, merrnin pjesë edhe shumë luftëtarë shqiptarë. Brigada e VII–të Shqiptare nga ajo përbërje, kishte luftëtarë të cilat nga fronti dërgonin lajme për "Flakën...".

Njëri nga iniciatorët kryesor për themelimin e gazetës "Flaka e Vllaznimit", ishte ministri i parë shqiptar në qeverinë e parë të Maqedonisë, Dr. Nexhat Agolli.

Nga ana e Frontit Popullor të Maqedonisë, kryeredaktor i parë i gazetës "Flaka e vllaznimit" ishte emëruar Dr.Petro Janura, i cili shërbeu edhe si drejtor i saj deri në vitin 1946. Petro Janura, i cili konsiderohet se ishte me origjinë vllehe (arumune)[3], i lindur në Fier të Shqipërisë më 1911, ishte in–telektual i shquar, shkencëtar dhe profesor universitar. U shkollua në Shqipëri, Rumani e Itali, dhe gjatë LDB–së mbeti në Maqedoni, ku la gjurmë në arsimin dhe kulturën shqiptare.

[3] Gazeta "*Frația/Vëllazëria*", nr.11–12, v.2014, Shoqata "Arumunët e Shqipërisë", Tiranë, fq.6.

Përpos kontributit në themelimin e gazetës "Flaka e vllaznimit", ai është edhe një nga themeluesit e Katedrës së Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe në Universitetin e Shkupit, delegat në Kongresin e Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe më 1972 në Tiranë, etj. Ndërroi jetë në vitin 1983.

Në fillim, përpos Janurës, si gazetarë–redaktorë në gazetën "Flaka...", u angazhuan edhe Kamber Xherija dhe Ali Mullai.

Në ekipin e vogël të gazetës "Flaka..." në fillim si përkthyes punonin Xheladin Palloshi dhe Hashim Toplica, të cilët pas 3–4 muajve u zëvendësuan nga dy përkthyes tjerë, konkretisht Skender Pustina dhe Mustafa Hatibi.

Me punën e gazetës, në kuptim të materialeve të cilat duhej të botoheshin, drejtpërdrejtë udhëhiqte Petro Janura, pastaj Kamber Xherrija dhe Ali Mullai, derisa Xheladin Palloshi dhe Hashim Toplica (e pas tyre Skender Pustina dhe Mustafa Hatibi), më tepër punonin rreth përkthimit të teksteve të ndryshme nga maqedonishtja dhe gjuhët tjera në gjuhën shqipe. Në fillim, pjesa më e madhe e teksteve të botuara në "Flakë..." ishin materiale të përkthyera nga gazeta në gjuhën maqedonishte "Nova Makedonija". Personi i fundit i angazhuar që në fillet e gazetës "Flaka e vllaznimit", Ahmet Shabani, punonte si punëtor teknik.

Pas Petro Janurës, kryeredaktorë të gazetës Flaka ishin: Myrteza Peza, Resul Shaqiri, Lutfi Rusi, Sejfedin Sulejmani, Xhevat Gega, Rexhep Zllatku, Fejzi Bojku, Abdylhadi Zylfiqari, Faik Mustafa, Zeqirja Rexhepi, Daut Dauti.

Nga viti në vit gazeta "Flaka..." shënonte përparime të dukshme në cilësi, dhe sidomos kur filloi të kultivohet një plejadë e madhe e gazetarëve dhe shkrimtarëve shqiptarë të shkolluar, të cilët do të lënë gjurmë të pashlyeshme në historinë e shtypit shqiptar në Maqedoni dhe më gjerë. Në këtë mes, përpos të lartpërmendurve, bënin pjesë edhe Ali Aliu, Luan Starova, Ramiz Kelmendi, Naxhi Ndoci, Halit Basha, Masar Kodra, e më vonë Teki Dervishi, Jusuf Gërvalla, Resul Shabani, Halil Zendeli, Xhabir Ahmeti, Shkëlzen Halimi, e deri te shumë emra të gazetarëve e redaktorëve tjerë të brezit të ri.

Gazeta "Flaka..." në gjithë vitet e funksionimit të saj të gjatë, u përball me probleme nga më të ndryshme, dhe në këto parametra të mundësive që i krijonte koha, fitoi edhe shumë beteja. Disa vjet para pluralizmit politik, në kohën e egër të nacionalizmit milloshevigian në Jugosllavi, njëra nga eksperimentet qëllimkëqia që u synua të bëhet në këtë gazetë, është çështja e ndryshimit të toponimeve shqipe. Ky synim i politikës komuniste të kohës, i vitit 1987, nuk mundi të zbatohej falë këmbëngulësisë së udhëheqësisë së atëhershme të gazetës "Flaka...", me kryeredaktor Rexhep Zllatkun, i cili me argumente të arsyeshme shkencore, kishte arritur të mbrohet nga ky sulm i drejtpërdrejtë ndaj identitetit shqiptar në Maqedoni. Kështu, edhe në atë kohë, "Flaka..." vazhdoi ta quajë Shkupin – Shkup e jo Skopje, Dibrën – Dibër e jo Debar, Manastirin – Manastir e jo Bitolla, etj., derisa një gjë e tillë ishte krejt

ndryshe në redaksitë shqipe të radios dhe televizionit të Maqedonisë.

Të nderuar të pranishëm.

Të rralla pra, janë institucionet e një shteti, që për nga rëndësia, e tejkalojnë qëllimin për të cilin janë formuar. Të rralla janë përpjekjet sistematike të njerëzve që të krijojnë diçka që do të mbetet me vite, dekada dhe shekuj, e pashlyer në memorien kolektive të një populli.

Duke parë parasysh spektrin e gjerë të impakteve pozitive në shoqëri, lirisht mund të themi se, në kohën kur është botuar, kjo gazetë ka shërbyer më shumë se shkollë, universitet apo akademi. "Flaka e vllaznimit" ishte vatra ku u farkëtuan intelektualët dhe kuadrot më të mirë arsimor dhe kulturor të popullit shqiptar në Maqedoni dhe më gjerë, pavarësisht faktit që fryma e egër ideologjike komuniste, shumë shpesh e shuante zjarrin e saj përparimtar.

Jorastësisht, në një rast tjetër, gazetën "Flaka e vëllazërimit" dhe revistat e saj "Gëzimi", "Fatosi" e "Jehona", i kemi vlerësuar si pjesë e trashëgimisë kulturore e historike të shqiptarëve të Maqedonisë. Derisa po shënojmë 70 vjetorin e saj, është e udhës që të mendojmë më seriozisht për mundësinë e ruajtjes së asaj që ka mbetur pa u zhdukur deri tani.

Konsiderojmë se një punë shumë e rëndësishme dhe e mundur të realizohet, është digjitalizimi i plotë i gazetës, për ta parandaluar shkatërrimin e plotë të arkivit të saj që në gjendje jo shumë të mirë, gjendet në Bibliotekën Kombëtare dhe

Universitare “Shën Klimenti i Ohrit” në Shkup. Ky projekt kërkon mbështetje serioze nga institucionet shtetërore, e në radhë të parë nga Ministria e Kulturës.

Çështja e rikthimit në jetë të emrit të “Flakës”, gjithashtu është një impenjim serioz, që kërkon njerëz të fortë dhe të vendosur për të ruajtur vlerat tona.

Ju faleminderit...

*ISMET OSMANI*
*Katedra e Gjuhës dhe e Letërsisë Shqiptare, Shkup*

# PUBLICISTI, PEDAGOGU DHE STUDIUESI PETRO JANURA (1911–1983)

Petro Janura (1911), pedagog i njohur shumëvjeçar i cili dha kontribut të denjë për afirmimin e arsimit shqip dhe kulturës kombëtare shqiptare në Maqedoni. Veprimtaria pedagogjike dhe akademike e Petro Janurës në shërbim të arsimit shqiptar dëshmon për një intelektual që, falë punës së tij plotë pasion, profilizon portretin e tij shkencor në fushën e gjuhës dhe të letërsisë shqiptare të viteve '50 – '80 të shekullit të 20 – të.

Petro Janura, u lind në Fier, ku kreu dhe shkollën fillore. Shkollën e mesme e kreu në Rumani, ku shkonin shumë shqiptarë për t'u shkolluar. Në këtë kohë, Bukureshti jep një ndihmesë shumë të madhe për arsimimin e shqiptarëve, duke e shndërruar në qendër të kulturës shqiptare, të rilindësve kombëtar shqiptar, prej nga doli himni kombëtar, abetarja e parë, gazetat e para shqipe, është vatër e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, veprat e të cilëve frymëzuan gjenerata të tëra. Në vitin 1940, diplomohet jurist në Universitetin e Pizes në Itali dhe një vit më vonë (1841) u caktua gjykatës në Gostivar, ku punoi për tre vjet rresht.

Pas Luftës së Dytë Botërore mbetet në Maqedoni dhe, gjithë jetën u angazhua për emancipimin e shqiptarëve të kësaj pjese të trungut shqiptar, duke zhvilluar dhe afirmuar veprimtarinë

publicistike, pedagogjike arsimore dhe intelektuale shkencore 35 vjet me radhë si i pari mësues e profesor i gjuhës dhe le–tërsisë shqiptare. Veprimtaria e tij e gjithanshme dhe e pasur do të jetë një nxitje e emancipimit njerëzor, e edukimit dhe përparimit njerëzor.

Prof. Janura shquhet për kontributin e tij në ruajtjen dhe kul–tivimin e kulturës, gjuhës së traditës kombëtare të shqiptarëve në Maqedoni. Petro Janura shquhet edhe për zhvillimin e gazetarisë dhe të publicistikës në gjuhën shqipe dhe është njëri ndër themeluesit e gazetës "Flaka e vëllazërimit", të cilën e drejtoi dhe e redaktoi që nga numri i saj i parë i cili doli më 4 prill të vitit 1945, e deri kah fundi i vitit 1946. Përveç kësaj, ai shquhet edhe për kontributin e tij të madh në konsolidimin e revistës për letërsi, art, shkencë e kulturë "Jehona", e cila filloi të botohej në vitin 1962. Përveçse si menaxhues, nëpër këto organe të shtypit shqip, Janura botoi me emrin e tij një numër të konsiderueshëm të artikujve publicistik, pedagogjik, letrar e shkencor.

Emrin e Petro Janurës si pedagog e studiues të gjuhës dhe letërsisë shqiptare e gjejmë qysh në fillimin e viteve '50. Për–veç mësimdhënies, ku ka mbuluar disa lëndë të gjuhës dhe letërsisë shqiptare, Petro Janura është ndër profesorët e parë në paralelet e Shkollës Normale "Nikolla Karev", mandej "Liria" dhe QSHMO "Zef Lush Marku" të Shkupit. Kontri–buti i tij i madh për arsimin shqip në këto pjesë të trungut shqiptar shquhet edhe në hapjen e Katedrës së Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe në Fakultetin e Filologjisë në Shkup, e cila në

fillim punoi si lektorat (1952 – 1966), e seminar (1966 – 1971), mandej katedër (1971); më vonë do të angazhohet edhe si pedagog në Grupin e Gjuhës dhe të Letërsisë Shqip–tare në Akademinë e Lartë Pedagogjike të Shkupit.

Fryt i punës së tij të palodhshme janë një varg botimesh, mo–nografi e tekste mësimore universitare, për shkollën fillore dhe të mesme, *Libër leximi për klasën e V dhe të VI të shkollave tetëvjeçare* dhe *për klasën e I dhe të II të gjimnazeve*, *Leximi letrar për klasën e II–të të shkollave të mesme*, si dhe artikuj gjuhësorë e letrar në shtypin shkencor dhe në shtypin e për–ditshëm. Në artikujt që i botonte në shtypin e asaj kohe, por jo në Shqipëri e Maqedoni, por në Konstanca me pseudonimin "Mefistofeles", trajtonte fusha të ndryshme të jetës se përdi–tshme. Dashurinë e tij për atdheun, ai e shpreh në botimet e tij për: Dora d'Distria, Zef Seremben, Nolin, Ali Asllanin, Migje–nin, Mark Gurakuqin, Naim Frasherin, Mjedën, Asdrenin (me të cilin kishte pasur miqësi që në Bukuresht). Në artikul–lin *"Mbi frymën mediterane në Ballkan" (Shqipëria e Re*, 1937), bën fjalë mbi autonominë e popujve të siujdhesës.

Synimet shkencore të prof. Petro Janurës kanë rrokur me kompetencë shkencore shumë çështje të ndryshme në gjuhën shqipe, në kohën kur shumë pak njerëz shkruanin për gjuhen shqipe, që rrihnin problemet e gjuhës sonë. Ndër artikujt shkencërisht të qëndrueshëm mbesin studimet për doku–mentet e para të shkrimit të shqipes, veçmas për "*Perikopenë ungjillore*", të cilën e nxjerr në kontekst të jehonës së Princi–patës së Arbëri (fundi i shekullit XII) dhe fillimeve të Huma–

nizmit Evropian (fillimshekulli XIII), si vazhdimësi e veprimtarisë iluministe të shqiptarëve të Dubrovnikut, ku më 1284, për herë të parë përmendet gjuha shqipe, si lingua albanesca.

Fusha e hulumtimeve dhe e studimeve të Petro Janurës është e gjerë, sepse interesimi i tij është i shumanshëm. Nga problemet e trajtuara shkencore, shihet qartë se Janura mbetet iniciator i fushës së gjuhësisë dhe është ndër pjesëmarrësit e drejtpërdrejtë në Kongresin e Drejtshkrimit (1972) me temë *"Disa mendime margjinale rreth ortografisë së shqipes"*, me ç'rast do të theksojë se gjuhës shqipe i nevojitet një ortografi sa më e përcaktuar dhe e ngulitur, sepse me stabilitetin e ortografisë ruhet edhe stabiliteti i gjuhës letrare të njësuar; pastaj fushës së letërsisë, po ashtu edhe i atyre me karakter historiko–letrar krahasimtar dhe sociologjik.

Si kurorëzim i veprimtarisë kërkimore shkencore të Petro Janurës mbesin dy studimet e gjata monografike: *"Për historinë e alfabetit shqip"* (1969) dhe *"Migjeni"* (1982), të dyja këto të botuara në Shkup. Historia e alfabetit përgjithësisht është ndër të parat studime monografike për diakroninë e alfabetit të shqipes.

Petro Janura është një personalitet poliedrik shkencor dhe arsimor, i cili tërë jetën e vet ia kushtoi emancipimit arsimor e kulturor dhe avancimit shkencor të shqiptarëve të Maqedonisë. Figura e tij pedagogjike dhe shkencore ndrit në krye të figurave markante të kulturës shqiptare në Maqedoni dhe me gjerë.

*Literatura e shfrytëzuar:*


1. Asllan Hamiti, Ismet Osmani, Ajten Qamili, *Delegatët e Kongresit të Drejtshkrimit nga Maqedonia*, kumtesë e le–xuar në Korçë, 2012;
2. Baki Ymeri, *Shqiptarët e Maqedonisë në veri të Danubit dhe atdhetarizmi i tyre (Pjesa I),* Bukuresht, 2007;
3. Sevdail Demiri, *Nga historiku i filleve të gazetës 'Flaka…',* "Studime albanologjike" – 8, ITSHKSH, 2013, Shkup;
4. Thoma Binjaku, *Fra ia/Vëllazëria*, Nr. 11–12 (nëntor–dhjetor), 2014;
5. Zeqirja Neziri, *Gjithnjë në shërbim të njeriut*, "Flaka e vëllazërimit", 3 shtator 1993.

*FEJZI BOJKU*
*Ish–kryeredaktor i gazetës "Flaka e Vëllazërimit"*

# FLETË NGA DITARI...

Deri në fillim të dekadës së nëntë të shekullit të kaluar, përpos të gjitha aksioneve dhe fushatave kundër shqiptarëve dhe çdo gjëje shqipe, përpos asaj se gjithmonë gazeta ka qenë e diri–gjuar, e kontrolluar nga persona "të besueshëm", Flaka e vlla–znimit ka dalë rregullisht, por më shumë si një informator, si një tellall i Pushtetit dhe Partisë, si një mashë e nevojave të ditës për veprim politik dhe propagandistik. Kjo mund të thuhet, deri diku, jo vetëm për gazetat dhe mjetet tjera të informimit në gjuhën shqipe.

Gazeta "Flaka e vllaznimit" më pas "Flaka e vëllazërimit" – vazhdonte të dalë sa për të treguar se ne shqiptarët kishim shtypin tonë në gjuhën amtare… Edhe pse mbi 13 vjet dy herë në muaj; mbi 12 vjet një herë në javë, kurse mbi 23 vjet 3 herë në javë – një dalje kjo e habitshme dhe fazë e stërzgja–tur përgatitore për të dalë si e përditshme… gazeta dilte rre–gullisht, në 12–16 faqe kurse numrat festivë dhe jubilarë me numër të trefishuar e katërfishuar faqesh, me kolor, përplot shifra e shembuj zhvillimi e përparimi, përplot kumtesa ko–mitetesh, personalitetesh politike e shoqërore…

Një gazetë e tillë shpeshherë ishte e zbetë, bajate dhe jo tër–heqëse për lexuesin, për mësuesin dhe intelektualin i cili mund të lexonte gazetat në gjuhën tjetër. Numri i lexuesve

ishte në rënie të vazhdueshme, sillej nga 300 deri në 1500 lexues, si bilten i ndonjë fabrike apo kooperative bujqësore.

**Nga ditari për vitet 1981/82**

*TË LODHUR DHE ME PSIKOZË TË RËNDUAR*

*4 mars 1981, e mërkurë*
U nisëm në ora 9h me R. për Strugë, me autobus. Thotë se ndihet i lodhur, pak i sëmurë dhe me psikozë të rënduar. Ka marrë pushim nja 4 ditë, që të pushoj në Hotel Drim.
E nevrikos pritja e autobusit, vonesa e madhe.
Në Strugë karshi hotelit Drini ndërtohet një ndërtesë e në katin e pestë e nën kulm të saj ai ka paguar një banesë afro 50 m. katrorë për të cilën është shumë i interesuar ta shohë si bëhet. Mbase me këtë i ndërlidh ardhjet e tij të shpeshta në Strugë.
Qëllimisht i largohem bisedës për problemet e punës, të Fla–kës, stilit të udhëheqjes së tij. Mos i prishim edhe këto 4 ditë pushim, për të cilin kemi nevojë të dy. Mjaft që edhe koha na ka qëlluar me shi dhe erë të ftohtë.
U vendosëm në hotel Drin dhe morëm nga 3 pansione. …

*5 mars 1981, e enjte*
Paradite shkova te baba, në spitalin e eshtrave, në Ohër. Bi–sedova me Dr. Geren, shefin apo drejtorin e këtij Institucioni të njohur në Jugosllavi. Gere më tha se kishin dashur ta ope–ronin të shtunën e kaluar, porse kishte ngritur temperaturë. Kishte edhe aritmi të zemrës. Është bashkuar pleqëria me së–mundjen…

*6 mars 1981, e premte*

Në mbrëmje në hotel erdhën shokët arsimtarë Nexhat Mustafa dhe Remzi Qoku. Erdhi edhe Zejnel Lufi, bashkëpunëtor i Flakës, nga Struga… Vijnë se jemi me drejtorin e Flakës... Me R. bisedojmë për çështje ekonomike dhe gjëra pa lidhje me punën… Më tha se nuk e do gazetarinë… Kur ai thotë diç të tillë dihet se nuk e ka lehtë, siç mendojmë ndonjëherë.

Në "Rilindje" akademik Ali Hadri në dy faqe shkruan për vazhdimet e Nijazi Limanovskit për origjinën e myslimanëve maqedonas… Kryeredaktori thotë se Vanço Apostollski, drejtori i "Nova Makedonisë", nuk ka ditur gjë për shkrimet e Limanovskit! Vallë është e mundur. Unë kam bindje se bashkëpunojnë.

Duke shëtitur buzë liqenit i ngatërruam fjalët për Maqedonasit e Egjeut, për fatin dhe rrugën e tyre jetësore. R. me fanatizëm dhe këmbëngulje do të më bindë se ata janë maqedonasit më të munduar dhe më të mirë dhe se Maqedonija bashkë me ne atyre duhet t'u sigurojë truall e kulm ku të dëshirojnë në Maqedoni. Derisa unë shpreh habinë time për privilegjet që u bëhen, për atë se të atillëve u ndërtojnë shtëpia e banesa, komplekse banesash edhe në Dibër e Tetovë. Më kritikoi ashpër për bindjet e mia duke parë këtu diç jo parimore, të dyshimtë.

Shkova edhe njëherë te baba.

U kthyem në Shkup me autobusin e orës 16. Pas kafevizitës te Nexhati dhe Zejneli.

Nuk di se pse nuk më hiqej nga koka një fjali e ditës: Bota sillen rreth parave dhe…grave.

*10 mars 1981, e martë*

Ditët e fundit kam dhembje në lukth – punon gastriti apo ndonjë thartirë. Problemet dhe lodhja bëjnë të vetën. Do të jetë kjo ndonjë dhembje lukthi në baza nervore. Kjo më shqe–tëson dhe më prish rendin e punës këto dy muajt e fundit.

*16 mars 1981, e hënë*

Po përgatis materialet e Gëzimit të majit. Na kanë sugjeruar që numrat të jenë në frymën e njëvjetorit të vdekjes së shokut Tito.

Këtë thuaj e kuptojmë se shpesh na kërkojnë raporte si e keni shënuar këtë ose atë përvjetor, luftën NÇL, këtë apo atë be–tejë, festë etj, Ose kërkojnë program vjetor apo për 6 muaj si do ta shënojmë rolin e Partisë dhe të Titos gjatë dhe para Revolucionit e të ngjashme .

Kur kjo kërkohet nga ne të revistave për fëmijë, mund të merret me mend se çfarë kërkohet nga "Flaka e vëllazëri–mit"…

## *NË VAZHDËN E DIFERENCIMEVE, DËNIMEVE...*

*12 janar 1982, e martë*

Ishte në redaksinë tonë Agim Pollozhani, mjeku i ri nga Struga..

Punoi dy vjet në Strugë, ku u dallua për sjellje dhe qëndrim shembullor. Tani është pa punë: nuk paska pasur qëndrim

aktiv në dënimin e ngjarjeve të mars – majit 1981 në Koso–vë... Njërit i paska dhënë pushim mjekësor e ai paska shkuar në vizitë në RPSh, e të ngjashme...
I kanë përjashtuar nga puna edhe Simin (Mersim Pollozhanin) dhe të vëllanë Shpëtimin, me të shoqen, motrën, dhëndrin Arif Vincën, i cili u dënua me 3 vjet burg.

*13 janar 1982, e mërkurë*
Nga Shoqata e Shkrimtarëve të Maqedonisë kërkuan që unë e Resuli të propozojmë për anëtar Asllan Selmanin, gazetar dhe profesor prej Kumanove.
Kështu, çdo dy vjet zgjerojnë Shoqatën edhe me një ose dy shqiptarë.
Kanë konkurruar më parë e s'janë pranuar ende: Nexhat Pu–stina, Nexhat Mustafa, Alush Kamberi, Ibrahim Veliu, Nijazi Saliu, Ramadan Zejneli, Mustafa Laçi, Mustafa Spahiu etj. Nuk është paraqitur me lutje, Xhabirr Ahmeti!
Anëtarë të SHSHM–së jemi: Adem Gajtani, Murat Isaku, Abdylazis Islami, Luan Starova, Resul Shabani... Mehmedali Hoxha (kuptohet – ishte para burgosjes), Myrteza Peza (vdiq më 30 dhjetor 1980), Lutfi Rusi (vdiq 1981), Ali Aliu (u transferua në Prishtinë), Muharrem Shahiqi (u pranua në të njëjtën kohë me mua, është transferuar në Gjilan ku është drejtor i Teatrit amator).
Në fakt, nga gjithsejtë nja 200 anëtarë të SHSHM–së, shqip–tarë jemi vetëm 6 (gjashtë)!

*17 janar 1982, e diel*

Në "Spektrin" TV kënduan disa shpresa, do këngë lajlelule buzëkuqe, që shqirren e vajtojnë, klithin për dashurinë… Folklori ynë me buzë të kuqe dhe faqe… të zezë. Sukses i punës së shokëve tanë në TV. Ose pasojë e presionit politik.

*19 janar 1982, e martë*

"Rilindja" shkruan për vrasjen e vëllezërve Jusuf e Bardhosh Gërvalla dhe një shoku të tyre, Kadri Zeka, në Shtudgard të Gjermanisë.

Hej, çfarë ironie, pështjellimi… Agjencitë botërore këtë e vlerësojnë si vepër e policisë sekrete jugosllave, ndërsa Sigurimi jugosllav do ta tregojë si grindje midis bandave shqiptare për hesape të tjera. Dihet, ndërkaq, vepra e kulluar atdhetare e Jusufit…

Jusufi punoi dhe u dallua si njeri dhe redaktor gjuhësor dhe përkthyes te ne, në "Flakën e vëllazërimit".

⋆ ⋆ ⋆

Në Tiranë vazhdojnë ngjarjet misterioze tragjike: "vetëvrasja" e Mehmet Shehut, përjashtimi i nipit të tij nga motra, Fekorit dhe Kadri Hazbiut, emrimi i Adil Çarçanit… janë temë e shpeshtë e TV, gazetave e revistave tona. Në mënyrë historike e me hollësi shkruhet për pastrimet e Enver Hoxhës.

*VALIXHET E RËNDA SI PLUMBI*

*18 mars 1982, e enjte, ora 5,50h*

Mbrëmë rashë të flejë me merak – nesër në ora 5,20 duhet ta përcjell vëllanë për Amerikë.
Rashë më ora 23, por mendimet në temën – jeta dhe kurbeti nuk më largoheshin kurrsesi…
E mora orën me zile dhe e bëra për 4,20h. Mendimet – zin–xhir i gjatë i pakëputur. Si ka ardhur koha, jeta! Më doli gju–mi më 3,50. Të gjithë flenë. Edhe Luli fle… Ai së paku mos jetë i shqetësuar nga udhët e kurbeteve.
…E mori Hilmiu valixhen në dorë dhe… rrugën e largët.
Bisedojmë në veturë: fati i njeriut tanë – as në shtëpi, as larg. Shumica pa shkollë e pa zanat. Pa punë ose me punë të vogël, rrogëz… Plot njerëz vite me radhë rropaten larg fëmijëve, gruas, nënës e babës, larg vendlindjes, në vrap për nevojat e jetës.
Më dalin para syve shkuarjet e ardhjet, pritje përcjelljet e pa–numërta të Axhës. Plot 30 vjet kurbetçi në kënde të ndryshme të Jugosllavisë…Lotët e bijave të tij: Teres, Ditës…
Valixhja e rëndë si plumbi helm e hidhur, shok i pandarë në shpresë, dëshirë e brengë, në rrugë të mallkuar.
Dhe përsëri më kujtohen: Rami Lufi, Fejzi Vinca, Teki Der–vishi, Mensur Nura… Qindra të tjerë që i njoh. Nga 10 – 15 – 25 vjet larg familjes, shtëpisë, më të dashurve… Çfarë për–jetojnë këta njerëz? Çfarë zemre kanë!
Dhe përpiqem të ngushëllohem: kështu ka ardhur koha. Sot udhëtojnë të gjithë: tregtarë, diplomatë, politikanë, profesorë, dijetarë…për detyra e qëllime të ndryshme. Por, jo si tanët, në kurbet dhe si shërbëtorë të zotërinjve…Dhe vjen edhe

pyetja tjetër: ç'do të kishim bërë sikur mos ishte kurbeti: A–merika, Gjermania, Zvicra, Austria, Suedia, Australia…

⋆ ⋆ ⋆

…Mbrëmë me koment plot shifra dhe argumente lajmëruan se rryma së shpejti do të shtrenjtohet mbi 25%…
Shkupi po bëhet qytet i shtrenjtë. Edhe tani nuk gjendet lehtë mielli, vaji, mishi, kafeja, detergjentet.
Nuk ka as portokaj, limona e banane, por pa to bëhet. Radioja, televizioni dhe gazetat çdo ditë përsëritin fjalët: stabilizim, sta–bilizim ekonomik, kursim, stabilizim politik, produktivitet. Vetëm fjalët, se rrallëkush mendon të punojë si duhet.

*SA MBAN VELESHTARI*

I çuditshëm dhe tepër i fortë është njeriu ynë, veleshtari.
Mban veten dhe familjen me fëmijët dhe pleqtë; mban mbi kurriz llojlloj taksash e tatimesh për tokën, kalin, qerren, lo–pën, qenin, shtëpinë, bagëtinë;
i duron tëra shtrenjtimet dhe u qëndron përballë kërkesave të çoroditura të grave, femrave, adeteve dhe peshqesheve të rënda për të mirë e për të keq si: synet, fejesa, martesa, tretënata e tretëdita, shkuarje dhe ardhje ushtarë, blerje e shitje, spitale, kryeshëndosha e kryesëmura dhe çfarë nuk tjetër.
Dhe i përballojnë veleshtarët të gjitha dhe kanë ndërtuar shtëpi të reja, kanë blerë tokë nga Vevçani, Vranishti, Belica, Llozhani… gjithandej.

Veleshta, e cila pas çlirimit kishte nja 1900 banorë e nja 250 – 300 shtëpi me plita e dhoma me dhe, të shtruara me hasra, tani ka mbi 6.500 banorë dhe mbi 600 shtëpi. Disa nga ata që punojnë në Gjermani, Austri, Zvicër e Suedi…kanë ngritur nga 2–3 shtëpi, pra edhe për pasardhësit sot ende foshnjë dhe mbase fëmijët e fëmijëve.

⋆ ⋆ ⋆

Të dielën (24 korrik) me Lulin e Fitin shkuam në Llabunisht e Vevçan për të ftuar dasmorë.

Nuk kisha qenë atje me vite dhe kisha dëgjuar se këto dy fshatra kishin përparuar shumë: ishin zgjeruar dhe ishin mbu–shur me shtëpi të bukura, si në shtetet e Perëndimit.

Llabunishtin, më thanë, nuk do ta njohësh, s'është ajo që di ti. Ata janë mjeshtër, muratorë të njohur në vend dhe jashtë, njerëz që punojnë e fitojnë shumë. Janë fqinj të mirë me Ve–leshtën, kanë edhe dhënemarrje, miqësi. Janë myslimanë, të fesë sonë. Disa flasin tjetër gjuhë, por emrat i kanë si ne, ma–dje ka plot Besima, Agrona, Flamura, Ilira, Lirie, Dashurie… Në dasma këndojnë dhe vallëzojnë shqip…

Një Nijazi Limanovski (ndonjëherë Liman, dikur Limani, Limanov…), i cili ka ndërruar mbiemrin e vet disa herë, sipas nevojës, interesit, frikës së ditës, për ne shumë i njohur si al–banofob, çka nuk bën që të tregojë se ata janë maqedonas, se duhet të rrinë larg nesh… Por kjo është një histori, një mesele tjetër. Llabunishti vërtetë ishte zgjeruar dhe rregulluar shumë.

Për Vevçanin e dija edhe më parë, sepse ky fshat është i njo–hur për njerëz të dalluar të LNÇ–s dhe pas çlirimit i ke në postet më të larta të Partisë dhe pushtetit në Shkup dhe Beo–grad. Ata janë maqedonas kryesisht me anim nga bullgarët, të dëshmuar dhe këtë nuk e fshehin…

Nuk kisha qenë në këto dy fshatra afër 20 vjet dhe kudo shi–heshin shtëpi të reja, moderne, rrugë të asfaltuara… Vevçani ka edhe gjimnaz, edhe spital që konkurron atë të Strugës, fir–ma të njohura ndërtimore si Ilindeni, Drimkolli etj. Kurse Llabunishti kishte edhe xhami të re të bukur, por ende nuk kishte shkollë të qenë.

Besimi dhe qirallarët, dajallarët e fëmijëve të mi, ja, kanë ndonjë të njohur apo mik edhe në Vevçan e Llabunisht, ndonjë tjetër mbase në Llozhan e kund tjetër, sepse po s'pate ndonjë të njohur apo mik, herë do kurdo do ta paguash shtrenjtë.

Pa ryshfet apo mit, si i thonë këta, ose pa të njohur, askund nuk ta çelin derën. Mbetesh jashtë për sehir të dynjasë, nuk sos asnjë punë… Kjo është jeta e shqiptarit dhe veleshtarit; ndoshta Zoti na e ka shkruar të jemi... ngushëllohen ndonjë–herë disa nga soji jonë.

⋆ ⋆ ⋆

Kuptohet lehtë: nuk më pëlqejnë dasmat e këtilla… Atë mish e kishim ngrënë 3 vjet. Pastaj kush e duron atë hordhi fëmi–jësh, grash nga të cilat disa janë mjaft noprane… Sidomos kur

dasmat te ne bëhen në vjeshtë ose në dimër. Harxhime të panevojshme – një kazan mish ngeli, ndoshta për qentë…

***Ja se çfarë kam shënuar në ditarin e atyre 20 muajve (14 prill 1991 – 30 dhjetor 1992), derisa isha në postin e kryeredakto–rit të "Flakës…", lidhur me rolin e ri të gazetarisë:***

*KOHË KTHESASH E TRANSFORMIMESH*

Ishte fillim i tranzicionit dhe pluralizmit, i formimit të partive të reja politike me prefikse e sufikse demokratike e prosperitet dhe tani më njeriu, deri dje shurdhmemec, e çeli gojën dhe nisi të flasë mbarë e prapë, çfarë t'i kujtohet dhe të dojë…
Shteti, që ishte para pyetjes të jetë a mos jetë, dridhej nga pro–blemet, kurse kujdesi dhe kontrolli ndaj medieve nisi të dobë–sohet. U pakësua deri në ndërprerje edhe buxheti apo ndihma materiale. Rrogat fare të vogla nuk paguheshin në kohë.
Gazetarët ishin të pakënaqur, por puna shkonte përpara sepse aso kohe serbosllavët e mbyllën "Rilindjen", në Prishtinë, kurse Shqipëria me agoninë e tranzicionit luftonte me vetve–ten dhe u ndërprenë të gjitha gazetat dhe masmediat. Në Fla–kë u tubuan disa pena nga më të mirat të gazetarisë shqiptare nga gjithë territori ku flitet shqip. Gazetarët filluan të shkrua–jnë lirisht dhe të marrë hov mendimi, shprehja e lirë.
Gazeta, deri dje e zbehtë dhe pa gjak, nisi të ngjallet, zbuku–rohet dhe të bëhet e kërkuar. Sepse gazetën e bëjnë ata që shkruajnë. Në këtë kohë e intensifikuan bashkëpunimin do emra të njohur si: Luan Starova, Blerim Reka, Ferit Muhiq,

Iso Rusi, pastaj Zekeria Cana, Ramiz Kelmendi, Ismail Bajra, etj. Edhe disa emra prej Shqipërie…

⋆ ⋆ ⋆

Pak statistikë për të punësuarit në NJ.P. ”Flaka e vëllazërimit” në maj të vitit 1992:

–Nga 48 të punësuarit, 11 janë femra; me fakultet janë 25; me shkollë të lartë janë 9; me të mesme 7, dhe me fillore janë 5.

–Përvoja e punës: nën 5 vjet punë janë 6 vetë. Prej 5–10 vjet janë 10, prej 10–15 janë 3 vetë, prej 15–20 vjet janë 9 vetë, prej 20–35 vjet janë 19 vetë;

–Krijues letrarë janë 10 vetë;

–Kemi 5 korrespodentë;

–Udhëtojnë për në Tetovë, Kumanovë, Kaçanik, Prishtinë gjithsej 9 vetë;

–Me probleme shëndetësore janë 5 vetë. Të aftë, por fare pak angazhim 7 vetë;

–Problematikë specifike – mungesat dhe angazhimi i pakët i 16 të punësuarve;

–Mirë e në vend të vetë si duhet janë 27 vetë.

*15 prill 1991*

Fillova punën e re në një kohë kthesash dhe transformimesh të mëdha të shoqërisë dhe vendit, rendit socialist në ish bllo–kun Lindor. Pranova të jem para detyrave të pazgjidhura dhe problemeve të grumbulluara me dekada në OBPB “Flaka e

vëllazërimit". Duheshe që edhe unë të futem njëherë në këto dallgë…
Sot kjo ditë ka edhe një simbolikë tjetër: është ditë e arifesë së Bajramit të Ramazanit! Gëzuar pra, me shëndet dhe me Zotin përpara!
Pranova në bisedë anëtarin e Sekretariatit për informata të KEF (Këshillit Ekzekutiv Federativ), z. Ahmet Bakiu. Kër–konte përkrahjen tonë programit të Ante Markoviqit.
E lidhëm, më në fund, Telefaksin.
Pranova urime nga shumë shokë e bashkëpunëtorë.
Rexhepi, prej tani ishkryeredaktor, m'i dorëzoi çelësat…Me sekretarin, Durron dhe me Naxhiun shkuam në kafe.

*16 prill 1991*
Analizën e gazetës e referoi Zekerija Bajra.
Propozova që në të ardhme të bënim edhe analiza tematike. P.Sh. si janë prezantuar ngjarjet kryesore, aspekti stilistik, as–pekti gjuhësor, niveli teknik estetik, një rubrikë për një javë ose muaj etj…
U theksua çështja e mospagimit të honorarëve me muaj. Mënyrat e zgjidhjes së problemit…

*18 prill 1991*
Drejtori gjeneral, Kolemishevski, më kishte thirr në orën 13,30. Më tregoi për reagimin e VMRO DPMNE–es lidhur me do shkrime kritike të Nefail Spahiut, korrespodent nga Dibra.

/Lajmi nga Ministria për marrëdhënie me jashtë lidhur me ardhjen e shkrimtarit Neshat Tozaj nga Shqipëria, të cilit i kishim botuar romanin "Thikat"./

*23 prill, e martë, 1991*

Më 10h– Këshilli afarist; më 12h– Analiza e gazetës; më 13 h Kolegjiumi i zgjeruar...

Informim dhe konsultim me drejtorin dhe ministrin Grozda–nov lidhur me ardhjen dhe qëndrimin e N. Tozajt. Orari i vizitave: Katedra e gjuhës dhe letërsisë shqipe te Remzi Ne–simi, emisionet në Radio dhe Televizion; bisedë në FV[4] dhe për Flakën, në Veçer, NM[5], në SHSHM[6]; shëtitje në Vodno, Kale, Saraj; qëndrim në Ohër, Strugë... Nga e marta deri të dielën.

Në mbledhjen e Këshillit afarist u paraqit raporti për punën materialo – financiare. U vendos që të ardhurat personale të rriten për 20%. Rritet edhe pagesa për ushqim dhe shujtat.

Në mbledhjen e Kolegjiumit të zgjeruar:

Neset Emini tregon se gjendja financiare e "Jehonës" nuk është negative. Kërkon zyrë dhe telefon.

Naxhi Osmani përkrah politikën redaktuese.

Halil Zendeli tregon se ende magazina e librave është e mbyllur dhe kërkon që t'i marrim librat nga "Nova Makedo–nija".

---

[4] Është fjala për "Flaka e vëllazërimit";

[5] Është fjala për "Nova Mekedonija";

[6] Është fjala për Shoqatën e Shkrimtarëve të Maqedonisë.

Fola: për besimin reciprok, gjendjen profesionale, për një konkurs për katër vende më shpejtë: redaktor teknik, lektor, bashkëpunëtor i "Gëzimit" dhe "Fatosit", një gazetar…
Për disiplinën dhe angazhimin kreativ në punë, për një gjendje si të thuash mobile deri më 20 gusht. I njoftova për gjendjen me 5 titujt të cilët duhet të botohen si këmbim me Detska radost. Dhe planin e qëndrimit të N. Tozajt te ne.
Nesër në kufi në Qafë Thanë Tozajn ta presin Rexhepi me shoferin Shemsedinin. Bashkë me shkrimtarin Tozaj vjen edhe Remzi Lani, kryeredaktor i "Zërit të Rinisë" në Tiranë… Shkova i takova në orën 19 në hotel "Grand".

*25 prill 1991*
9h. Takim në Këshillin Ekzekutiv me kryetarin Dr. Nikola Klusev dhe zëvendësin e tij, ministrin Beqir Zhuta. Informim për demokratizimin e mjeteve të informimit…
Ministri Dr. Bllazhe Ristovski tha se kishte një grumbull materiale akuzë ndaj "Flakës së Vëllazërimit" lidhur me : Bojkotimin e regjistrimit të popullsisë, formimin e kuvendeve komunale në Tetovë e Gostivar, për evidencën pedagogjike shqip etj.
Dr. Klusevi na mbajti një ligjëratë akademike…Ligjërata e tij mund të mblidhet dhe parafrazohet si më poshtë:
Jemi në fazën kalimtare në të gjitha sferat, përballë ndryshimeve të mëdha dhe kontributi i mjeteve informative është i pazëvendësueshëm. Po ndahemi nga sistemi i njëmendësisë

dhe qëndrojmë përballë një platforme të gjerë, para fushatës parazgjedhore.
Janë çelur shumë tema tabu të djeshme, nuk ka më kult personi dhe censurë të dikurshme. Shfaqen emra dhe pikëpamje të reja; shmangen misteret. Kritere objektive; nuk ka komisarë politikë dhe lista të zeza. As paraqitje të maskuara, biseda me ata që mbanin shkopin e dirigjentit në dorë. Me fakte dhe argumente...Fjalë dhe premtime joshëse, – mendova në vete.
U pa se çfarë solli totalitarizmi në Serbi, Kroaci, Kosovë. Të dëgjohen mendime të ndryshme me tolerancë. Niveli i informimit është i shkallëve të ndryshme. Ekzistojnë ende kuzhina, klane, lobe, grupe...Dhe ndarje në të përshtatshëm e të papërshtatshëm.
Të çlirohemi apo të zhveshim rrobën e palarë. Para së gjithash: objektivitet dhe argumentim profesional. Çlirim nga recidivet e së kaluarës. Ka njerëz që mbrojnë monopolin dhe janë kundër rirreshtimeve...Do të paraqiten lloje tjera mjetesh informative, private, alternative, partiake dhe do të kërkojnë vend dhe lexues... Le të thyhen prangat e monopolit në tregun e mediumeve publike... I pavarur do të jetë ai që do të punojë me mjetet dhe paratë e veta...Shteti u ka ngritur ndërtesa monumentale si NM dhe TV. Edhe ato ngadalë do të ndërrojnë pronarin...Do të kemi norma të reja etike dhe kodeks profesional...Vjen kohë e gazetarit opozitë e qeverisë...
*12h*: në "Nova Makedonija" bisedë me Stojan Andovin, kryetar i Parlamentit, tre nënkryetarët dhe njëri prej tyre Dr.

Xheladin Murati. Përfaqsues të tri partive politike të koalicio–nit. Fola për mospasjen e kushteve për demokratizimin e "Flakës së Vëllazërimit".
/Pasdite në Grand te N.Tozaj me Nejazi Muhamedin dhe Durron./
Më 26 prill Neshatin dhe Kimin i kisha në shtëpi, për drekë.

## *NË VERI KISH FILLUAR LUFTA QYTETARE*

*3 maj 1991, e premte*
Në Jutel pash luftimet midis policisë kroate dhe serbe në ra–jonet e Kninit – 15 policë të vrarë. Sa e sa të plagosur. Lufta qytetare para syve tanë...

*5 maj 1991, e diel*
Gazetat, TV dhe aktuale – lufta qytetare midis serbëve dhe kroatëve te Borovo Selo, Knin, Plitvice, Pokrac...13 milicë kroat të vrarë. Si edhe 3 ose 30 qytetarë të vrarë. Shumë të plagosur. Triumf i marrëzisë së Millosheviqit dhe Tugjmanit.

⋆ ⋆ ⋆

Në mbrëmje erdhi Beqiri me znj.Turqane. U zbrazë lidhur me atë se si ndihet si njëri nga tre nënkryetarët e qeverisë së Klusevit. Relacioni: Ai – qeveria – Prosperiteti... Dhe Blla–zhe Ristovski si skifter, lidhur me tre problemet tona: bojko–timi i regjistrimit, kuvendet komunale në Maqedoninë Pe–rëndimore dhe evidenca pedagogjike në gjuhën shqipe.

Dje, e shtunë, afër 5000 maqedonas të Prespës së Shqipërisë e kaluan ditën në fshatrat maqedonase këndej kufirit, pa pasa–porte e dokumente! Mirëpo…

*6 maj 1991, e hënë*

Në ora 9,30 erdhën tre gazetarët e Hostenit të Tiranës: Niko Nikolla, kryeredaktori, Dhimitër Ligori dhe…organizojnë ekspozitë karikature në fund të muajit.

Ishte kënaqësi të bisedoje me ta.

*7 e 8 maj, 1991*

Skicë për fjalën time në Kolegjium dhe para kolektivit:

– Koha dhe gazetaria për ne shqiptarët në Maqedoni dhe më gjerë. Kosova dhe Serbia – kthesat e mëdha në të gjitha sferat. Kriza e theksuar ekonomike dhe refleksi i saj në marrëdhëniet ndërnacionale.

– Gjendja e kuadrit. Kush dhe sa na financon. Gjendja e ta–nishme kaotike dhe shkalla e lartë e vartësisë sonë…Na mun–gojnë 6 vetë. Të mobilizuar deri më 20 gusht, që të përballo–jmë vështirësitë…

– Fizionomia e gazetës dhe mënyra e keqe e daljes. Gazetaria e lirë dhe e pavarur si synim. Shteti, partitë, politika, ekono–mia…

a. Partia e Prosperitetit Demokratik; b. revistat: Dita, Dija dhe të alternativës së Kosovës; c. gazetarët e Flakës ku e marrin rrogën, ku miellin, ku krundet; d. problemet e kohës: bojko–

timi i regjistrimit, kuvendet komunale, evidenca pedagogjike, shkollat e mesme…

– Materialet nga zyra, të përgjithësuara, përshkruese, negative, konstatuese, pa zgjidhje…Të dihet se artikujt e FV i zgjedhin dhe i përkthejnë, i analizojnë ata që vendosin për mjetet tona.

– Tirazhi si detyrë e çdonjërit prej nesh. Si ta ruajmë, rritim këtë që sillet prej 3500 deri në 5800? – "Gëzimi" dhe "Fatosi" në nivel rentabiliteti. Çfarë librash të botojë edicioni. Si ta reklamojmë gazetën, revistat, librat në radio, TV, te ne…

– Qëndrimi ndaj punës, detyrës, profesionit dhe disiplina në punë…Vallë ende nuk e kemi të qartë se ku jemi dhe çfarë na pret, çfarë mund të na ndodhë? Vijmë e shkojmë kur të na teket…

– Relacioni: redaktor – gazetar dhe detyrat. Vetiniciativa. Shpërblime dhe dënime. Vlera dhe pavlera. Cilët kërkojnë rrogë më të madhe? Jo vetëm sa por edhe si… Normat…të gjitha punët janë tonat. Nuk ka kohë për dremitje, gjumë, konformizëm, përtaci.

## *TË KUJT DO TË JENË MASMEDIAT*

*15 maj 1991, e mërkurë*

Ndryshimet në sistemin shoqëror po reflektohen edhe në "Nova Makedonija".

Shtrohet pyetja të kujt do të jemi në të ardhmen. Kush do ta financojë dhe drejtojë këtë organizatë pune me interes të posaçëm shtetëror apo shoqëror.

Sidoqoftë, gjendja edhe tani nuk është e mirë dhe po shkojmë kah negativa e madhe financiare. Sot Mimi, shefica e konta–bilitetit, erdhi e na tregoi se për periudhën janar – mars "Flaka…" ka shënuar humbje prej 1.067.694 dinarë.

Kështu si punojmë, me plot mangësi materiale, kuadri, të mjeteve të punës kjo negativë me siguri do të rritet dhe ne vazhdimisht do të veprojmë e punojmë nën presionin e mungesës së parave, rrogave, mospagimit të bashkë–punëtorëve, honorarëve etj.

Ne jemi tani gjithsej 42 vetë në listën e punës, por kemi qenë dhe patjetër duhet të bëhemi 48. Vallë do të na lejojnë të pu–nësojmë edhe 6 të tjerë për të plotësuar vendet e lira? Këshilli Ekzekutiv apo Kryesia e Lidhjes Socialiste po i vonon dona–cionet, edhe ashtu të pamjaftueshme…

Sot në "Nova Makedonija", në ora 12h, erdhën kryeministri Nikolla Klusev dhe nënkryetari Blazhe Ristovski, ministri i Informatave Treneski, i Financave Toshevski, dhe ministri i Arsimit.

Pasi dëgjuan referimin e gjatë të drejtorit Kolemishevski për gjendjen e NM ata diskutuan për çështjen e transformimit të pronës, për mënyrën e ardhme të ekzistimit, për një shtëpi të këtillë shtetërore apo private, pra për alternativa të mundshme të privatizimit…

Shihet se fillon koha e bisedave dhe diskutimeve të gjata dhe kjo shtëpi grafike botuese do të ballafaqohet me probleme të shumta të politikës redaktuese dhe gjendjes financiare.

*17 maj 1991*

Më 11h, u hap Panairi i III i Librit…

Si rëndomë, nuk lexoi asnjë poet shqiptar. Ndonjëherë lexon ndonjë sa për biber…

S'ka gjë se jemi në krizë të thellë dhe në gjendje paralufte.

## *VAZHDOJNË PËRPJEKJET PËR GAZETË TË PËRDITSHME*

*30 shtator 1991, e hënë*

Me përfaqësuesit e Forumit për Liritë dhe të Drejtat e Njeriut – Gostivar: z. Milaim Fejzi, z. Shehat Marku dhe z. Qenan Pasholli dhe kryetarin e Unionit të Intelegjencies shqiptare – Shkup z. Xhevat Gegën shkuam në takim dhe bisedë te drejtori i NGBG: "Nova Makedonija" Pande Kolemishevski lidhur me kërkesën me shkrim që ia kisha dorëzuar para do kohe për "Flakën e vëllazërimit" si të përditshme.

Xh. Gega foli për historikun e zhvillimit të FV nga v. 1971, kur filluam me tri herë në javë. Ai tha se mendohej që kjo mënyrë daljeje do të ishte si fazë e shkurtër përgatitore dhe kalimtare për të përditshme, por kjo zgjati shumë dhe s' ka shembull të këtillë gazete në botë. Ka pasur arsyetime se nuk ishte e përgatitur shtypshkronja, por tani niveli tekniko– teknologjik është i lakmueshëm.

M. Fejzi tha se gjithnjë kemi qenë të gatshëm të ulemi të bisedojmë. Shprehim gatishmërinë e kolektivit të FV të ballafaqohet me këtë detyrë. Roli i mjeteve të informimit tani është më i madh se më parë, kurse informimi në gjuhën am–

tare është e drejtë fundamentale. Mënyra e tanishme e daljes është bajate dhe e tejkaluar.
Sh. Marku tha se dalja e përditshme e FV është nevojë dhe dëshirë e shqiptarëve të Maqedonisë. Forumi e ka shqyrtuar shpesh çështjen e FV të përditshme se kjo do të bënte që më mirë të njihemi dhe të duhemi. E përditshmja do të kishte efekte politike dhe humane, për jetesë të përbashkët në paqe dhe barazi.
Q. Pasholli tha se çdo informatë e vonuar ishte e dështuar. Si e përditshme gazeta do të rris tirazhin dhe besimin te lexuesi.
Drejtori Kolemishevski tha se kjo kërkesë është shtruar disa herë nga kryeredaktori i tanishëm dhe nga paraardhësi i tij, se jemi afër me mendime, se është bërë përparim kohën e fundit si në nivelin e gazetës ashtu dhe në tirazh, në transformimin e politikës redaktuese, hap historik në politikën redaktuese dhe pavarësim.
Besoj tha se e përditshmja do të kishte tirazh të dyfishtë. Prandaj pajtohem absolutisht me kërkesat tuaja, se kjo do të ishte dobi e madhe drejt barazisë, se FV nuk do të ishte më organ i ndonjë partie politike, por gazetë e pavarur e shqiptarëve të Maqedonisë.
Sugjeroi në fund që Forumi dhe Unioni ta vazhdonin kërkesën dhe të vizitonin funksionarët politikë, tre kryetarët e Maqedonisë, se NM do t'i afrojë mundësitë teknike teknologjike, redaktorialë dhe profesionale.
P.S. Edhe një takim dhe bisedë e mirë, por nuk di sa herë kështu jemi takuar, kemi biseduar dhe jemi pajtuar dhe në

fund, vitet kalojnë dhe ne vendnumërojmë apo fjalët e bukura, por strajca e zbrazët.

*1 tetor 1991, e martë*

18 h. Takimi i kryetarëve: Gligorov, Klusev dhe Andov me drejtorin gjeneral dhe 3 drejtorët tjerë të NGBG "Nova Makedonija" si dhe kryeredaktorët e të gjitha gazetave dhe botimeve të shtëpisë sonë.

Gligorov foli për gazetarin dje dhe sot, në republikat tjera dhe te ne. Tha se janë bërë hapa të mëdhenj përpara drejt gazetarisë së lirë, të pavarur dhe profesionale. Se kemi fat që nuk fitoi vetëm një parti. Jetojmë, tha ai, në kohë të pasigurt, nuk dimë çfarë do të ndodhë nesër, jetojmë në nervozë dhe frikë nga e nesërmja. Ndryshimet revolucionare kanë çmim të lartë, sidomos kalimi nga shoqëria me pronë shoqërore në ate me pronë private.

*8 tetor 1991, e martë*

Me disa anëtarë të Kolegjiumit dhe gazetarë po veprojmë sipas planit për verifikimin dhe rritjen e tirazhit të gazetës dhe revistave.

Vizitojmë shkollat, institucionet, individët dhe bashkëpunëtorët tanë nëpër komuna në aksion për rritjen e tirazhit.

Të ndarë në disa ekipe, prej para fillimit të shtatorit dhe vitit shkollor kemi kaluar një pjesë të terrenit, por ende duhet të punojmë e të jemi në lidhje e bashkëpunim të pandërprerë sepse tirazhi i vendosur sot duhet të bëjë vend për më gjatë…

Krahas asaj se nuk kemi ende gazeta dhe revista siç i dëshirojmë, nuk kemi po ashtu lexues me shprehi, intelektualë të vërtetë që leximin e gazetës e ndjejnë si nevojë për informim dhe ushqim shpirtëror.

Sot me zëvendësin tim, Ramadanin, vizituam qoshqet nëpër Shkup e rrethinë ku shitet "Flaka". Në disa qoshqe, pa na konsultuar, e kanë zbritur tirazhin në minimum. Me gjasë, atyre të Sektorit për tirazh të NM nuk u ha palla sa lexues do të kenë botimet tona. Ata as nuk dinë ku ka mundësi të rritet tirazhi; shohin të sigurojnë të holla nga shitja e cigareve dhe sendeve të tjera.

Ka po ashtu shumë shqiptarë që blejnë "Veçerin" ose "Nova Makedoninë", gazetën tonë e mendojnë se është ajo e kohës së monizmit. Në shumë vise vendosëm ta rritim tirazhin prej 30–50%. Kështu do të veprojmë në 20 qoshqe.

Abdylnaseri nga Gostivari më lajmëroi se në 6–7 qoshqe shiten vetëm 100 copë dhe se në qoshkun në qendër kanë ngelur pa shitur 6 copë. Një shembull se sa pak lexojnë njerëzit tanë.

Në analizë Bajra theksoi se kohëve të fundit po shtohet numri i materialeve, artikujve origjinal të shkruar nga emra të njohur si Iso Rusi, Mersel Bilalli, Kim Mehmeti, etj.

*9 tetor 91, e mërkurë*

Në rend dite – aksioni për tirazh.

Nefaili prej Dibre na lajmëroi se në 5 qoshqe shiten 80 copë. Mund të shtohet numri.

Enveri prej Tetove na lajmëron se para 2 muajsh janë shitur 800 copë, kurse tani shiten 520 copë. Në qoshkun afër gjyqit dërgohen 90 numra, por disa ngelin pa shitur. Thotë se ndihet nevojë të dërgohet gazeta në qoshqet e reja private si te rruga Braqa Milladinovi, afër Xhamisë së Pashës në rrugën Ilinden–ska afër sallonit të mobilieve "Shipad", në ndërtesën e resto–rantit "Gurra", etj. Të dërgohet gazeta në fshatrat: Bogovinë, Pirok, Tearcë, Çellopek, Zhelinë.

## *PRANVERA SI FIGURË STILISTIKE*

*14 mars, e shtunë 1998*

Me të ulur që të vazhdojë shënimet e tij në kompjuter, autorit iu kujtua kuptimi i jashtëzakonshëm i pranverës si figurë arti–stike dhe sidomos ndërlidhja e shumëfishtë dhe tejet e rëndë–sishme e shumë ngjarjeve që kanë të bëjnë me fatin dhe fa–tkeqësinë e shqiptarit dhe fatin e tij personal, ngjarje këto që kanë ndodhur gjatë muajit mars.

Këtë mendim ia imponoi në radhë të parë situata aktuale dhe tepër e vështirë lidhur me luftën e ndyrë policore – ushtarake serbe ndaj popullatës së pafajshme dhe të paarmatosur në rre–thinën e Drenicës së Kosovës sonë gjithmonë heroike, pa–triotike, legjendare dhe njëkohësisht martire.

Gjatë këtyre dy javëve të para të këtij marsi, kur okupatori serb, si shtypës barbar, nën pretekstin se në atë kështjellë të qëndresës shqiptare po gjurmon dhe vret të ashtuquajturit nga ana e tij terroristët dhe separatistët shqiptarë, vrau mbi njëqind banorë të fshatrave të rrethinës së Drenicës nga të cilët, siç u

pranua nga mbarë opinioni botëror – edhe mbi pesëmbë–dhjetë fëmijë dhe më shumë se aq gra, nga të cilat disa shta–tzëna…

Asgjë më nuk është e çuditshme, asgjë më nuk është e pa–mundshme!

Shekuj me radhë vojvodët, knjazat, kralët dhe carët, tani edhe komandarët, të ndihmuar dhe të inkurajuar nga njerëz të njo–hur si dijetarë, shkencëtarë, akademikë…madje edhe krijues e poetë e shkrimtarë serbë, kanë bërë çmos që të bindin vetve–ten dhe botën se Kosova na qenkësh tokë serbe… se aty na qenkan rrënjët dhe e kaluara e lavdishme historike e Serbisë, feja dhe shpirti i saj?!... Dhe se shqiptarët aty na paskan ardhur e vendosur më vonë dhe janë shtuar për ta vërshuar pastaj tokën e huaj, duke e ngushtuar dhe duke e padrejtësuar tani pakicën serbe, e cila jetuaka në shtetin e vet dhe në tokat e veta të shenjta…

Të shkruash këtu për shtypjen, terrorin, masakrat, plaçkitjet, dhunimet e një pushtuesi dinak dhe barbar, të cilin e njeh tani më fare mirë mbarë bota, është detyrë e të tjerëve dhe e hi–storisë, të cilën rëndomë e ka shkruar i forti dhe i padrejti, bashkë me ata që ia kanë pasur frikën ose që kanë pasur ndonjë interes prej tij.

Është kjo një politikë e njohur e të përdalës që e bën kopilin dhe ta lë para derës, një politikë që kur ia do interesi vetë i vret edhe fëmijët e vet që ta fajësoj tjetrin para syve të botës si vrasës dhe terrorist që, më vonë t'i vërsulet atij që s'është fa–jtor i vërtetë dhe ta djegë, dhunojë e masakrojë ashtu siç dinë

barbarët dhe ata që s'njohin asgjë tjetër përveç logjikës së for–cës dhe interesit…

Është kjo tani po ashtu një arritje e madhe se mbarë opinioni botëror kësaj radhe më mirë e më drejtë se kurdoherë më parë e pa dhe u bind më se çfarë është dhe ç'dëshiron populli shqiptar i Kosoves që me mbi 92 për qind jeton në truallin e vet mijëra vite para se të shkelnin hordhitë e Karpateve në këto anë…

Se nuk bëhet fjalë këtu për popull që shqetëson e torturon ata pak serbë të vendit, nuk bëhet fjalë për kurrfarë terroristësh, por për njerëz që brez pas brezi kanë vuajtur nën çizmen e xhandarit, policit e vojnikut të pamëshirshëm, që e ka mbajtur nën thundër apo nën terror një popull të tërë të vuajtur por liridashës, i cili është i detyruar të ngrejë armën për të mbro–jtur jetën dhe nderin aty në pragun dhe vatrën e shtëpisë stër–gjyshore…

Kjo po ndodh sot dhe këtu, në Kosovën e pamposhtur, në Ballkanin sinonim i absurdeve dhe luftërave ndëretnike. Kjo po ndodh në Evropën plakë në fillim të shekullit njëzet e një!

Kjo po ndodh dhe jo vetëm sot dhe jo vetëm këtu, në botën që asnjëherë nuk ka qenë as e drejtë dhe as e qetë. Po ndodh ashtu si me Palestinezët me dekada të shfarosur e të vrarë … Ashtu si me mbi dhjeta milionë kurdë të shtypur e të ndjekur në vendin e tyre; ashtu si me irakianët …

Kjo po ndodh edhe me popuj të tjerë që pranohen e s'pranohen si pakica dhe që u epen e merren të drejtat ele–

mentare njerëzore dhe kombëtare ashtu si ua do interesi po–pujve shumicë dhe shpesh atyre shteteve dhe popujve që e heqin veten si luftëtarë për liri dhe të drejta të barabarta midis njerëzve, popujve dhe shteteve.

Kjo po ndodh në ndërkohën kur disa organizata, shoqata dhe asociacione ndërkombëtare si OKB, OSBE, KE, FNDLNJ… dhe plot të tjerë sa janë e nuk janë, diplomatë që kalojnë jetën nëpër aeroplanë dhe konferenca të rëndësishme, luajnë lojën e misionarëve të paqes, të engjëjve që kujdesen dhe s'i zë gjumi për liritë dhe të drejtat e njeriut dhe të kombeve…

…Në fillim të pranverës dhe pikërisht në mars e prill të vitit tani të largët 1981 ndodhën demonstratat historike të studen–tëve të Universitetit të Prishtinës, të cilat pastaj u përkrahën nga mbarë populli dhe sidomos nga minatorët e Trepçës. Demonstratat të cilat u paguan me viktima, me shumë të plagosur dhe me mijëra të munduar, të terrorizuar dhe të burgosur.

Po në marsin e para një viti filloi lufta e armatosur dhe vëlla–vrasëse ku ndodhën ngjarje tronditëse dhe rrëqethëse që asnjë shqiptar nuk kishte mundur t'i paramendojë dhe imagjinojë ndonjëherë! Në mars, po ashtu filluan lëvizjet masive për rrë–zimin e pushtetit komunist në Shqipëri dhe shumë shkatë–rrime, rrënime dhe kthesa të ashpra që vërshuan si ortekë du–ke përmbysur, rrënuar e përdhosur çdo gjë që gjenin përpa–ra… Në mars...

⋆ ⋆ ⋆

*E martë, 9 shkurt 1999*

Mbrëmë, nga ora 21 h. e deri pas mesnate, në Televizionin Sitel, kryeredaktori Dragan Pavlloviq – Llatas, i njohur dhe tepër i dëshmuar si shovinist dhe sidomos albanofob, në stilin e tij të njohur dhe në emisionin e tij "Profil", me nofullat e tij të forta, aktualizoi dhe intrigoi pamasë dy ngjarjet kryesore të janarit dhe shkurtit të k.v. çështjen e Ligjit të Amnistisë dhe Marrëdhëniet apo lidhjen e Maqedonisë me Tajvanin.

Shikuesi, që sadopak di të shohë dhe të mendojë, do të bindet se Llatas këtu është gjithnjë një rikujtues i asaj që çdo njeri i ndershëm nuk do të rikujtojë, një të kaluar aq të hidhur dhe tronditëse, siç ishin ngjarjet tragjike dhe të përgjakshme të 9 korrikut 1997 në Gostivar e Tetovë, kur policia maqedonase zbatoi urdhrin e pushtetarëve ekstremistë dhe albanofobë, duke angazhuar forca të mëdha policore që të hiqnin flamurin me shqiponjë nga ndërtesa e komunës dhe pastaj ato ditë të lanin me gjakun e njerëzve fare të pafajshëm rrugët, oborret dhe konakët e shtëpive të Gostivarit, ngjarje këto rrëqethëse në të cilën policia vrau 2–3 njerëz dhe burgosi mbi 200 shqiptarë, kurse numri i të rrahurve dhe të të sakatuarve, numri i shtëpive të bastisura dhe të plaçkitura ende nuk dihet…

Skena: Llatas, me kamerë në krah, si ndonjë xhek kauboj shëtit rrugëve të Gostivarit derisa qytetin e mbulon gazi lotues dhe rafalët e mitralozave ushtojnë në të gjitha anët. Ai bashkëpunon me policinë për të regjistruar në shirit storiet kur çizmet e policëve thyejnë brirët dhe kokat e kalimtarëve të

rastit, madje edhe të pleqve dhe fëmijëve që i kanë shtrirë dhe i rrahin egërsisht në mes të rrugës dhe…
në këtë stil, me shiritin e kamerës, për gjysmë ore do të tregojë e dëshmojë se Rufi Osmani, që u lëshua mbrëmë nga burgu i Idrizovës, nuk na ishte një i burgosur politik, se Ligji për amnisti të cilin koalicioni qeveritar e solli dy herë në parlament dhe të cilin Gligorovi nuk e nënshkroi, na paskësh qenë një skandal dhe një gabim i madh kundër vënies së rendit dhe ligjit në qeveri!!!
Viteve të fundit, shpesh e me bollëk, kemi dëgjuar përralla për gazetarinë e pavarur dhe të lirë; për gazetarinë në shërbim të objektives dhe të së vërtetës në shoqërinë demokratike… Mirëpo, me kalimin e kohës po na forcohet bindja se gjatë monizmit 50 vjeçar kishim vetëm gazetari që i shërbente shtetit, alias Partisë Komuniste, kurse nga viti 1990 kemi mjetet e informacionit të cilat i shërbejnë partisë apo koalicionit në pushtet, dhe ato privatet që u shërbejnë partive apo grupimeve, mbase edhe individëve. Për gazetarinë objektive dhe të pavarur mbetet të shpresojmë për ndonjë kohë të ardhshme, të largët…
Tani që "funksionojnë" dhjetëra televizione dhe qindra radiostacione, kur kemi dhe gazeta e revista private dhe depërtim thuaj të lirë të shtypit nga jashtë, lexuesit i ofrohen turli kuzhinash e gjellësh, gjegjësisht çorba, dhe i bëhet një presion i paparë në kokë dhe në shpirt… Kur dihet profili i lexuesit tanë atëherë vetëkuptohet se çfarë shërbimi mund të bëjnë mjetet informative në këtë kohë të tranzicionit këtu dhe në vendet e ish bllokut socialist…

⋆ ⋆ ⋆

*Mars 2000*

Tani diç tjetër, jashtë meje dhe rrethit tim.

Gjeneralii njohur i NATO–s, Uesli Klark, këto ditë vizitoi Kosovën, Maqedoninë, Bullgarinë dhe Shqipërinë. Dihet an–gazhimi dhe vendosmëria e tij në dënimin e krimit të klikës së Milloshеviqit në Kosovë.

Ajo që më bëri përshtypje të posaçme dhe që këto ditë nuk më hiqet prej mendjeje ishte një fjalë e tij që e tha në Sofje lidhur me bombardimet e NATO–s vitin e kaluar në Serbi e Kosovë.

Gjeneral Klarku, i provokuar për bombardimet e Aleancës kundër Beogradit, tha; "Në takimin tim të fundit me Millo–sheviqin në vitin 1998, para fillimit të bombardimeve tona në Beograd, në pyetjen se kur do të zgjidhej problemi i Kosovës, ai më tha: "Problemi i Kosovës do të zgjidhet kur ta vrasim edhe shqiptarin e fundit në Kosovë!".

Ja këtë ia ka thënë Sllobodan Milloshеviqi gjeneralit Uesli Klark. Dhe Milloshеviqi është gjallë e shëndoshë në Dedinje, në zemrat serbe të cilët tani e duan ende më shumë se para bombardimeve të NATO–s. Natyrisht koka apo rradakja ime, nuk është e aftë të kuptojë lojërat e kësaj kohe, të shekullit njëzet e një, të mileniumit të tretë…

⋆ ⋆ ⋆

Më në fund, pas nëntë vjetësh, erdhi deri te ndërrimi i pritur dhe shumë i përfolur në kreun e PPD–së. Në vend të dashit

me këmborë, Abdurrahman Haliti, babaxhan që u rrethua me shokë që i punonin edhe pas shpinës, erdhi dr. Imer Imeri, i cili tani në fillim, ndryshe nga shumë të tjerë, flet pak, nuk premton dhe shfaqet sikur ka ndërmend ta ringjallë dhe forcojë Partinë e Prosperitet Demokratik, e cila e qafoi tranzicionin në Maqedoni dhe aktualizon kërkesat tona historike.
Siç dihet, PPD–së dy vjetët e fundit i doli boja – PDSH–ja e Arbenit dhe Menduhit ia mori fuqinë dhe anëtarësinë. Por, siç duket, hapi i ne shqiptarëve në Maqedoni qenka i limituar: Arben Xhaferi me PDSH–në fare pak kanë realizuar nga premtimet e mëdha, gjegjësisht e shtuan numrin e shqiptarëve në disa ministri dhe në qeverisjen lokale, emëruan disa drejtorë në sektorë e institucione me rëndësi…
Çështja e UT–së, e gjuhës, flamurit, përfaqësimit në administratë e udhëheqësi, pjesëmarrjes në ushtri, polici dhe në faktorin ekonomik, sillet rreth e rrotull dhe vendnumëron në premtime, zotime, kërcënime boshe…
Frazeologji në parlament, gazeta, qeveri, në politikën e brendshme dhe te ata që vijnë nga Evropa dhe SHBA–at që të ndajnë nasihate dhe të kontrollojnë demokracinë tonë.
Ministri i arsimit, p.sh, Gale Galev, premtoi në TV se: po intensifikohet çështja e arsimit superior të pakicave dhe se brenda dy viteve do të bëhet gati projekti. Pastaj do të jepet në diskutim publik, pastaj do të dale në parlament… do të shihet si qëndron kjo punë në shtetet e Evropës, pastaj do të shihet si është gjendja e pakicës maqedonase në shtetet fqinje si Bullgari, Shqipëri, Greqi etj. Dhe kështu, me një kësi in–

tensifikimi (me nder me thënë) do të zgjidhet edhe çështja e Universitetit të zotëri Fadil Sylejmanit, i cili qe shtatë vjet punon, zgjerohet dhe po nxjerr kuadro, por që diplomat e të cilëve pushteti maqedonas nuk i njeh…

Në ndërkohë, në çdo seancë të parlamentit dhe lidhur me cilëndo pikë, dy partitë relevante shqiptare të Maqedonisë bëjnë paradë me retorika, me kritika dhe replika kundër njëra tjetrës për cilëndo pikë të rendit ditor dhe shpesh nuk dihet cila është pozitë e cila opozitë, edhe pse PDSH–ja dhe pesë ministrat e gjashtë zv–ministrat e nënministrat e saj janë në qeveri, në koalicionin qeveritar me plot kundërthënie dhe të çara, me konfrontime interesash personale, grupore e partiake ndërmjet VMRO–DPMNE–së së kryeministrit Lubço Georgievski – vojvodës, shtyllë kryesore, dhe Alternativës Demokratike (AD) të Vasil Tupurkovskit, e PDSH–së së Arben Xhaferit, shtyllave të forta anësore.

⋆ ⋆ ⋆

*Mars 2000*

Edhe një kthim në Kosovën tonë, e cila për politikanët, diplomatët dhe kryeparët e shteteve të përparuara të botës, është Meka e këtyre viteve. Aty vijnë e shkojnë në rend: Bill Klinton, Medlin Ollbrajt, Toni Bler, Uesli Klark, Xhemi Shej… Zhospeni, Shiraku, Robertsoni, Prodi, Shrederi… madje edhe koni, joni e federi … dhe premtojnë, mburren, lavdërojnë, këshillojnë.

Kosova tani është protektorat i Perëndimit (nuk di i OKB–së, SHBA–ve apo BE–s) dhe atje pas luftës me serbët çdo gjë vlon si në kazan. Natyrisht shqiptarët nuk ia dalin vetë me serbët kriminelë… Mitrovica e ndarë në veri e serbëve dhe në jug e shqiptarëve si dhe Kosova lindore (term shqip) dhe Ser–bia jugore (term serb) për Preshevën, Bujanocin dhe Medve–gjen janë bërë poligone kërcënimi për ardhmërinë e shqipta–rëve në përgjithësi.
Atje arkanët, sheshelët, çetnikët dhe bishat sllave vjedhin, djegin e vrasin kur t'u kujtohet, kurse KFOR–i, UNMIK–u dhe frëngu i autorizuar nga OKB–ja, si dhe persona nga të sipërshënuarit, akuzojnë kosovarët pse nuk punojnë më shu–më për afrimin me serbët, për Kosovën autonomi e lartë multietnike. Dhe kjo kërkohet kaq shpejt kur ende zbulohen varreza masive, kur në burgjet e Serbisë dergjen e treten mbi 6000 kosovarë; kur serbët përgatiten për ndonjë ofensivë më të ashpër dhe eventualisht definitive kundër nesh.
Se tani ka edhe kosovarë që nuk e duan më jetën kjo është fare e kuptueshme, sepse ata që kanë humbur fëmijët, tërë familjen, fisin e sojin nuk kanë pse dhe si të jetojnë dhe ba–shkëjetojnë me ata që ua thernin dhe pritnin fëmijët para syve… Evropa të mos ngutet, t'i çelë sytë pak më mirë…
E gjithë kjo m'u ringjallë një ditë kur zoti Xhems Rubini i nderuar erdhi dhe e vizitoi Prishtinën dhe shqiptarëve u tha të mos jenë agresivë ndaj serbëve, se në atë mënyrë e vënkan në pikëpyetje ndihmën e mëtejshme të SHBA–ve…

Veç një Zot e di se ç'plane ka edhe vetë Amerika e madhe, cili është roli i saj i mbretit dhe mbretëreshës në tabelën e shahut…Ky është një monolog, në vija të trasha dhe natyrisht fare subjektiv, i njeriut pak të informuar.

*31 mars 2000, e premte*

Nesër është 1 prilli, dita e rrenave, dhe kjo që po shënoj këtu do të kisha dashur mos jetë e vërtetë.

Kjo është e para, kurse e dyta është se çfarë u është dashur njerëzve që një prillin, këtë ditë të bukur pranverore, ta shpallin ditë rrenash, derisa të vërtetën e thonë mbase fëmijët, naivët dhe në të rrallë njerëzit e mirë, që mund t'i gjesh gjithnjë më pak…

Nuk do të kishin gabuar, mbase do të ishte diç simpatike, sikur një prillin ta shpallnin ditën e së vërtetës, të kishte pra të paktën një ditë kur njerëzit të ishin fare të sinqertë dhe ta thoshin vetëm të vërtetën.

Të tjerët mbase mund të mendojnë ndryshe; t'u vijë mirë që një ditë të mund të rrejnë pa të drejtë që dikush t'u hidhërohet, të trillojnë rrena nga më të çuditshmet, të rrejnë kah lartësitë e qiellit dhe jo për toke, të mendojnë, trillojnë e shpifin rrena me bisht sa të kënaqen dhe eventualisht të shqepen duke qeshur edhe ata që i trillojnë edhe ata që i dëgjojnë…

*TAHIR ZAJAZI*
*Ish–redaktor dhe bashkëpunëtor i "Flakës së Vëllazërimit"*

# "FLAKA..." E VËSHTRUAR NGA KËNDI PEDAGOGJIK DHE KULTUROLOGJIK

Ne të gjeneratës e kemi të tiposur në kujtesë nocionin "Flaka" që na ofronte informacione të shkruajtura, komente, analiza kritike, kronika të ngjarjeve dhe burime tjera, aq sa i lejohej asaj dhe ashtu siç arrinte të tejkaloj censurën e kohës që, megjithatë, ishin të efektshëm në ngritjen e kulturës dhe arsi–mimit të gjeneratave e më gjërë të intelektualëve të kohës që numëroheshin në gishta. Por jo vetëm kaq. Për më shumë, "Flaka" me edicionet e radhave që botonte luante edhe rolin e teksteve të munguara shkollore; ndihmonte, në veçanti mësues jo të kualifikuar e gjys të kualifikuar të kohës. Madje, mbi të gjitha, ishte një ushtrimore e vetme ku arrinim të belbëzojmë shkrime të para pioniere në fusha që ushtronim. Dhe sipas një ligji, ndjehej avantazhë e shkallëzuar midis "Flakës..." dhe shtresës intelektuale të kohës që e jetuam ne shqiptarët e Maqedonisë.

Duke qenë peng të saj nuk mund të qëndrojmë indiferent dhe të kapërcejmë pa veçuar gjurmë me vlera historike që ajo la pas. Ndërsa ajo që "Flakën..." e bën të veçantë është se, përtej rrethanave të vrazhda politike; e ndjekur dhe përndjekur, madje me imponime në ideologjizimin e gjërave që shpienin në zbatica të radhave por, megjithatë, Redaksia e kohës sot

kur shënon 70 vjetorin e numrit të parë të saj ka lënë hapësirë të qëndroj ballhapur para historisë dhe të krenohet që ishte stoike, e pamposhtur atje ku eskalonte cenimi i interesave vitale të kombit që si rrejedhojë e pësoi një numër gazetarë e intelektual të denjë e dinjitoz, të cilët u dënuan, diferencuan ose u burgosën.

Andaj kthimi me kujtesë në lindjen dhe evoluimin e mundimshëm të "Flakës" është nder, por edhe nevojë shpirtërore ndaj përgjegjësisë morale që ajo na e la peng me kontributin që dha gjatë rrugëtimit historik të saj. Personalisht madje ndjej një borgj ndaj gazetës "Flaka" për hapësirën që më lejoi të ushtroj hapat e para që nga viti 1964 e më tej prej nga shijoja shpresën e rrugëtimit që shpiente në hapa drejt afrimit në derën e madhe të botës së shkencës.

## *1. Rrethanat e kohës së lindjes së "Flakës"*

Sipas burimeve, gjeneza e gazetës "Flaka e vëllazërimit" qëndron në frymën e Proklamatës që doli nga Mbëledhja e Parë e ASNOM –it, gusht 1944 me qëndrimin decid të Federatës Jugosllave që i dedikohet afirmimit të kombit të posa shpallur maqedon, madje ngritjes së vetëdijes kombëtare të tij dhe dekretimin e gjuhës maqedonase për gjuhë zyrtare [7]. Dhe në domenin e realizimit të këtij qëllimi prioritar që ishte, ndodh vërshimi euforik drejt themelimit të institucioneve

[7] Mbledhja e Parë e ASNOM–it, 1944. Dokumenti: AM.f.ASNOM, kutia 2, në gjendje të vitit 1992, dokument i papërpunuar

formale e jo formale për tejkalimin e mbetjeve të pasluftës që, mbi të gjitha, në objektiv ishte tejkalimi i analfabetizmit që përmbyste popullatën maqedonase, e cila në gjendje të shtatorit të vitit 1944 shënonte index afër 75% [8]. Andaj në parim të këtij Dokumenti, nuk mund të anashkalohej gjendja analfabete e pjesëtarëve të pakicave kombëtare, siç thirreshim asaj kohe, ku elementi shqiptar në veçanti nuk u nominua [9]. Megjithatë, sipas të dhënave tjera vlerësohet se indeksi i gjen– gjendjes së gjetur analfabete të shqiptarve të Maqedonisë së pas Luftës shënon index diku 90–95 %.

Në frymë të Prezidiumit të Dytë të ASNOM –it madje, 2–5 shtator 1944 u hartua një Udhëzim i veçantë pune që obligon realizimin e idealit prioritar që posa e theksuam, prej nga rezultoi vërshimi i aktiviteteve për tejkalimimin e gjendjeve të gjetura të popullatës maqedonase. Procesi zhvillohet në dy faza. Faza e parë, 1944–1950 është e natyrës, kryesisht euforike që realizohet mbi baza institucionale por edhe të vullnetit të mirë dhe si rrjedhojë rezulton që, paralel me themelimin e alfabetit çirilik dhe ngritjen e rrjetës së sistemit të shkollimit formal deri në nivel të Universitetit "Shën Kirili e Metodij", 1947 në Shkup, u organizua, gjithashtu, edhe një rrejtë e bujshme e institucioneve të shkollimit të të rriturve që realizohej përmes kurseve për analfabetë, kurse për amvisni, hapjes së bibliotekave me salla leximi, hapjes së universiteteve

---

[8] ... *"Vospitanieto i obrazovanieto vo Makedonija – 1943–1983",* Skopje, Prosvetno dello.

[9] Ibid.

popullore e të punëtorëve, themelimi i shoqërive kulturore artistike, shtëpi të kulturës, sinema, teatro, muzeume; madje edhe veprimtari tjera të pavarura artistike, siç ishin teatrot amatore, grupe diletante, kore, orkestra, grupe folklorike etj. E veçantë e kësaj faze është karakteri stihik i saj, madje i përkohshëm, jo i sistemuar dhe qëllimi jo i përqëndruar.

Në këtë fazë eksplozive të aktiviteteve spontane e të improvi– zuara të kulturës dhe arsimimit jashtashkollor që synonte te– jkalimin e gjendjeve të rënduara analfabete maqedonase, ndo– dhi përfshirja edhe e popullatës shqiptare që imponohej që të ishte e domosdoshme në përfshirje me përmasa të minimizua– ra,simbolike. Këtë e perceptojmë në të dhëna burimore ku gjejmë vlera sasiore dhe të vëna në raport me ato të popullatës maqedonase, konstatojmë se angazhimi i politikës së kohës për tejkalimin e gjendjeve aq të varfura të kësaj populate në kulturë, asnjëherë nuk ka kaluar indexin më shumë se 3%, madje gjithnjë me përfshirje të vonuar, të rrudhur e tinzare, me alibi kinse në mungesë të kuadrit adekuat[10]. Dhe si rrjedhojë rezulton që nga opusi i institucioneve që iu përkushtuan qytetërimit të popullatës maqedonase, ndodhi një çasje e rezervuar ndaj kulturës shqiptare për themelimin e institucineve, të rrudhur ata deri në minimumin e mundshëm prej nga doli themelimi i tri Shoqërive Kulturore Artistike: “Emin Duraku” në Shkup, “Xheladin Zeçiri” në Tetovë dhe “Liman Kaba” në Dibër; madje Teatri i kombësive dhe Bi–

[10] *“Statistiçki godishnik na SR Makedonija”,* Skopje, Republiçki zavod za statistika.

blioteka e kombësive në po atë object që shtrihej me themele pikërisht aty ku ndodhet Teatrit kombëtar shqiptar e turk sot, përball Bit pazarit në Shkup.

Në këtë valë të parë të zhvillimit eksploziv të bërthamave të para të kulturës maqedonase, me kërkesë të Dr. Nexhat Agolli u ngrit Redaksia katër anëtarshe, e kryesuar nga Dr. Petro Janura për themelimin e gazetës shqipe, "Flaka e Vëllazërimit", organ ky i Frontit Nacional Clirimtar për shqiptarët e Maqedonisë dhe më 4 prill 1945 doli numri i parë i saj, fillimisht si gazetë mujore e dy javore dhe më 1958, domethënë pas 13 vite ngritet në gazetë javore. Duhej kaluar madje edhe 13 vite tjera që në vitin 1971 "Flaka" të botohet tri ditë në javë dhe më në fund, në vitet e para të pluralizmit, pas 23 viteve, më 1994 kaloi në botim të përditshëm dhe brenda 10 viteve të egzistimit si e tillë, më në fund u privatizua dhe më 2004 u shua. Domethënë, nga themelimi i gazetës "Flaka", 1945 dhe deri në ngritje të saj në gazetë të përditshme, 1994, shqiptarët e Maqedonisë afër gjys shekulli ose plot 49 vite nuk arritën ë gëzojnë një gazetë të përditshme.

Faza e dytë e zhvillimit të arsimit dhe kulturës në Maqedoni, 1950 e më tej shënon çasje të organizuar dhe të mbështetur në institucione adekuate të kulturës dhe shkollimit formal e jo formal të gjeneratave shkollore e jashtashkollore ku perceptomë mbrapambetje të radhave që ishin ekstreme të

rrudhura në avancimit e arsimit dhe kulturës shqipe që për këtë rast, fusha e arsimit nuk është objekt studimi[11].
Në shënimin e 70 vjetorit të numrit të parë të "Flakës...", qëllimisht ndalemi në gamën e atyre pak institucioneve ku frymon edhe kultura shqiptare e Maqedonisë socialiste prej nga mund të perceptojmë akoma edhe më nga afër rrugëtimin e mundimshëm të "Flakës", ashtu si edhe simotrat e saj.

## *2. Institucionet e kulturës shqiptare në Maqedoni (1944–1994)*

Fillimisht rikujtojmë se në domenin e ngritjes arsimore dhe zgjimit të ndërgjegjës kombëtare të një populli, sistemi i shkollimit formal nuk është i mjaftueshëm. Sepse vlerat e si–stemit të shkollimit ngriten mbi themele të institucioneve jashta shkollore, formale dhe jo formale. Dhe e kundërta me ndikim kthyes, siç është teatri, filmi, televizioni, radio, mu–zeumi, biblioteka, galeria artistike, shoqëritë kulturore–artistike, ansamblet, orkestrina profesionale, simfonia, shtëpia e kulturës, arkivi, libri, broshura, revista, fletushka, gazeta, or–ganizatat për kulturë fizike, qendra e kulturës teknike dhe ngjajshëm. Ky kompleks është substancë që reflektojnë, jo vetëm në dhënie të informacioneve por edhe ngacmues që senzibilizojnë nevoja materiale e shpirtërore të njeriut. Sinteza

---

[11] Tahir Zajazi, *"Evoluimi i elementit shqiptar në Universitetin 'Shën Kirili e Metodi' (fakultetet e profileve pedagogjike)"*, Shkup: "Jehona", nr. 1–2, 1999 & *"Prania e elementit shqiptar në Universitetin 'Kirili e Metodi' 1947–1991"* (fakul–tetet e profileve tjrra, jo pedagogjike), përmbledhja: "*Shqiptarët e Maqedonisë"*, Shkup, Meshihati i BI në RM, 1994.

e dijes dhe kulturës madje janë pjesë e qenies njerëzore. Andaj qerdhet e kulturës që posa i nominuam, u shkallëzuan menjëherë pas vitit 1944, por jo edhe për të gjithë. Për popullatën shqiptare ishin të pjesërishme, gjthnjë të vonuara e të minimizuara. Nga opusi i institucioneve të viteve 1944–1994 të posa theksuara, popullatës shqiptare iu lejua hapësirë në minimumin e domosdoshëm përbrenda disa nga institucionet shtetërore maqedonase (radio & televizioni) dhe ato nacionale (teatri, biblioteka, shoqëritë kulturore artistke dhe gazeta "Flaka" me edicione të saja të radhave).

Pa u ndalur në analizë të detajuar të institucioneve të kulturës në fjalë, demonstrojmë veças tregues sasisor të intervalit 1944–1994 ku mund të perceptojmë se si ndodhi që për tejkalimin e mbetjeve të pas Luftës, shqiptarët e Maqedonisë të përballen me hapësirë të mjerueshme në kulturë. Për rastin demonstrojmë parametra më me peshë të kësaj fushe dhe në raport me ata të palës maqedonase, demonstrojmë përfaqësimin, jo vetëm restriktiv por edhe të vonuar që imponoi politika e kohës.

*Përfaqësimi shqip në valët e radios*

Dhjetori i vitit 1945 shënon fillimin e transmetimit të valëve të radio Shkupit, të mbuluara ato me emisione vokale e instrumentale në gjuhën maqedonase. Ndërsa në gjuhën shqipe radio emisionet u emituan një vit më vonë, më 1946, në hapësirë 15 minuta në ditë për lajme në gjuhën shqipe. Më

vonë të këtij viti u lëshua edhe një emision javor me këngë popullore shqipe 15 minuta. Dhe shumë më vonë, pas 6 viteve, më 1951 lëshohet hapësirë edhe për një emision tjetër javor për fëmijë në 10 minuta; më vonë madje edhe një emision 5 minutësh për gruan. Ndërsa në intervale të disa viteve u lëshua edhe emisioni letrar në 10 minuta. Dhe pas vitit 1960 u zgjëruan emisionet për gruan dhe për fëmijë nga 10 në 20 minuta. Në po këto vite lëshohet edhe një emision për fshat, rini dhe emisioni shkollor.

Hapësirë më e theksuar në valët e radios ndjehet nga viti 1970 kur emisionet e nominuara shqip transmetohen sipas shemës nga 3 orë e 15 minuta në ditë, në intervalin nga ora 9–12,30 në kanalin e dytë, por me frekuencë valësh të dobëta që nuk mbulonin territorin shqip të Maqedonisë. Që kjo të bëhet akoma më e qartë, në Tabelën Nr. 1 demonstrojmë në raport emisione të emituara në bazë të gjuhës dhe të shprehura në orë në intervalin e viteve 1944–1991.

Tabela Nr. 1: VALËT E RADIO SHKUPIT DHE ATO LOKALE TË SHPREHURA NË ORË DHE NË BAZË TË GJUHËS (1944–1991):

| Numri akumulativ i orëve të emitura | Orë të emituara në gjuhën maqedonase | Në % | Orë të emituara në gjuhën shqipe | Në % |
|---|---|---|---|---|
| 65 727 | 59 976 | 91.3 % | 3 814 | 5.8 % |

Në tabelën Nr. 1, vlerat sasiore demonstrojnë përfaqsim të skajshëm të varfër të shqiptarëve në emisione të valëve të radio Shkupit e më gjërë të radio emisioneve lokale në teritorin e Maqedonisë Socialiste. Që kjo të fitojë efekt vizual akoma edhe më të qartë, parametrat sasiore 91.3% dhe ata 3.8% i shprehëm në grafikonin Nr. 1 të këtij vështrimi analitik [12].

Grafikoni Nr.1:

*Përfaqësimi shqip në emisionet TV:*




Pranë redaksisë së Radio Shkupit për herë të parë, më 1964 u ngrit redaksia për emitimin e emisioneve televizive dhe re– zultoi që ky institucion të avancohet në nivel të RTVM (ra– diotelevizioni maqedonas), me programe dhe emisione në

[12] *"Statistiçki godishnik na Republika Makedonija"*, Shkup, 1994

gjuhën maqedonase. Një vit më vonë, më 1965 fillon emitimi edhe në gjuhën shqipe, një ditë në javë në 10 minuta për lajme shqip. Madje avancohet në 2 ditë në javë, po nga 10 minuta. Duhej pritur 15 vite që më 1979 shema e emisioneve shqip të zgjërohet në 5 ditë në javë me zgjatje 20 minuta. Ndërsa prej vitit 1991 u zgjërua në 25 minuta duke përfshi edhe ditën e gjashtë, të shtunën.

Në raport komparativ të emisioneve të emituara dhe të shprehura ata në orë, fitojmë tregues sasior që demonstrojnë se në intervalin e viteve 1964–1994 emisionet televizive që u emituan përmes valëve të RTVM mbulojnë 96,5 % orë në gjuhën maqedonase dhe vetëm 1,6% orë në gjuhën shqipe, index ky që tregon shkallë të përfaqësimit nënçmues të shqiptarëve [13]. Raportin e parametrave midis emisioneve në gjuhën maqedonëse dhe asaj shqipe e demonstruam në Tabelën Nr. 2.

Tabela Nr. 2: EMISIONET TELEVIZIVE TË SHPREHURA NË ORË DHE NË BAZË TË GJUHËS (1964–1991):

| Gjithsej emisione Tv të shprehura në orë | Emisione Tv të emituara në gjuhën maqed. | Në % | Emisione Tv të emituara në gjuhën shqipe | Në % |
|---|---|---|---|---|
| 8 343 | 8 052 | 96.5 % | 136 | 1.6 % |

13 Ibid.

Parametrat e Tabelës Nr. 2 i demonstruam në Grafikonin Nr. 2 në shprehje sasiore 96.5 % ndaj 1.6 % prej nga perceptojmë efekt më të theksuar vizual[14].

Grafikoni Nr.2:




Rikujtojmë, gjithashtu se Redaksia TV publike e Shkupit, nga viti 1992 kaloi në shemë të zgjëruar të programeve edhe në gjuhën shqipe por, në ndërkohë ndodh zgjërimi edhe i shemës së programeve në gjuhën maqedonase, që rezulton se raporti i proporcioneve midis dy gjuhëve është akoma i pandryshuar, ose me ndryshime të vogla statistike jo të rëndësishme.

---

14 *"Statistiçki godisnik na Republika Makedonija",* Shkup, 1994

*Përfaqësimi shqip në artin teatral*

Përfaqësimi i shqiptarëve të Maqedonisë në artin e aktrimit është i ngjajshëm si edhe mediat që posa i nominuam. Sipas të dhënave[15], konstatojmë se në intervalin e viteve 1944–1991 pëbrenda Republikës së Maqedonisë funksionuan gjithsej 10 teatro nga të cilët, 9 maqedonas dhe vetëm 1 (një) shqiptar, ose në shprehje relative 90 % ndaj 1% shqip. Por jo vetëm kaq.

Teatri shqiptar u themelua me vonesë të theksuar. Ngjarja ndodhi më 1950 me Vendim të organeve kompetente. Nismëtarë të parë ishte një grup enthuziast i anëtarëve të SHKA "Emin Duraku" në Shkup. Dhe fillimisht u quajt, "Teatri Kombëtar Shqiptar"; pastaj "Teatri i palicave kombëtare" dhe më pastaj, "Teatri i nacionaliteteve". Rikujtojmë, gjithashtu se në gjendje të vitit 1991 një teatër maqedonas mbulonte afër 240.000 banorë, ndërsa e tërë po–pullata shqiptare e Maqedonisë u mbulua me një teatër të vetëm, me objekt që disponon gjithësej 450 ulëse dhe vetëm një sektor, atë të dramës [16].

Që kjo të fiton efekt edhe vizual, vlerat numerike të gjendjes së vitit 1991 i demonstruam në Tabelën Nr. 3 ku perceptojmë numrin e aktorëve të angazhuar në teatër dhe në bazë të gjuhës.

[15] *"Statistiçki godishnik na Republika Makedonija",* e cit.

[16] Ibid.

Tabela Nr. 3: KUADRI ARTISTIK MAQEDONAS E SHQIPTAR NË GJENDJE TË VITIT 1991:

| Gjithsej trupi i aktorëve maqedonas në 9 teatro | Në % | Trupi i aktorëve shqiptar në një teatër | Në % |
|---|---|---|---|
| 837 | 97 % | 26 | 3 % |

Për qartësimin e efektit vizual të parametrave të Tabelës Nr. 3, shprehjet relative në përqindje i transmetuam në Grafikonin Nr. 3 ku percoptojmë raportin midis shprehjeve sasiore 97 % ndaj 3 % [17].

Grafikoni Nr.3:




[17] *"Statistiçki godisnik na Republika Makedonija"*, e cit.

Rikujtojmë se akoma nga themelimi, në Teatrin shqip që gjindej në themele të teatrit aktual përball Bit pazarit, që nga fillimi dhe akoma edhe aktualisht aty veprojnë dy drama paralele: shqipe dhe ajo turke. Gjithashtu, deri në vitin 1963 kur objekti u rrënua nga tërrmeti katastrofal i Shkupit, përbrenda hapësirave të Teatrit vepronte edhe biblioteka e kombësive me sallë leximi, e vetme kjo e këtij lloji në Maqedoni që paiste rininë shkollore e më gjërë shqiptare  dhe turke me literaturë shkollore e më gjerë.

*3. "Flaka" medium i vetëm i fjalës së shkruar shqip*

Rikujtojmë se themelimi i redaksisë së "Flakës së vëllazërimit" si gazetë jo e përditshme dhe në interval të tejzgjatur afër pesë dekada si e tillë (1945–1994), tingëllon si të ishte një paravan për mbulesë të politikës diskriminuese të kohës ndaj shqiptarëve të Maqedonisë. Sepse, vështruar këtë nga këndi i vlerave të informacioneve në emancipimin e një popullate të robëruar në shekuj, efekti i "Flakës" ashtu e cunguar nuk ishte i mjaftuar. Dhe sa më shumë që kthehemi në vështrim të gjendjeve akoma të pasluftës, aq më qartë na duket se sa shumë është ndjerë mungesa e një "Flake" të përditshme, si mbështetje për tejkalimin e mbetjeve të rënduara që jetoi popullata, afër 95% analfabete, madje me mentalitet të përmbytur në konceptime të imponuara e të ngatërruara dhe me paragjykime primitive agrare.

Gjithashtu, në konsideratë se informacionet janë të përditshme gjykojmë se "Flakën" e pesë dekadave të theksuara e ndoqi gjendje jo e defininuar dhe pa qëndresë në fushën e mediave standarde të fjalës së shkruar.
Dhe, gjykuar nga ky kënd del se shqiptarët jetuan në dritë të pjesërishme të informimit.
Që kjo të perceptohet akoma edhe më qartë, në mungesë të një gazete të përditshme shqipe, në Tabelën Nr. 4 demons–trojmë në raport numrin e gazetave dhe revistave mujore, javore dhe disa ditëshe në javë, ashtu siç ishte "Flaka", të gje–tura sipas gjendjes të vitit 1990.

Tabela Nr. 4: GAZETA DHE REVISTA MUJORE, JAVORE DHE DISADITSHME NË JAVË, /GJENDJE E VITIT 1990/:

| Gjithsej | Maqedonisht | Në % | Shqip | Në % |
|---|---|---|---|---|
| 110 | 108 | 98,2 % | 2 | 1.8 % |

Numri "2" i grafës "shqip" të Tabelës Nr. 4 nënkupton gazetën "Flaka" dhe revistën "Jehona". Efektin vizual të pa–rametrave të po kësaj Tabele e demonstruam akoma edhe më të theksuar në Grafikonin Nr. 4, ku vëmë re raportin midis shprehjeve sasiore 98 % ndaj 1.8 % [18].

[18] *"Statistiçki godisnik na Republika Makedonija",* e cit.

*Grafikoni nr. 4*




Por jo vetëm kjo. “Flaka” ishte në kontrollë kontinuive të organeve të pushtetit. Andaj nuk ishte lehtë të veproje si gazetar i “Flakës”. Sepse, gazetarët dhe intelektualët jo të “disiplinuar” e pësuan me dënime të shkallzara sipas peshës ashtu siç e ngarkonte vullneti i organeve të pushtetit. Dhe vështruar kështu në mënyrë analitike dhe kritike, fitohet përshtypje se objektivi i botimit të gazetës “Flaka” anonte në domenin e propagimit shqip të politikës së pushtetit dhe, gjithashtu, testimin e shqiptarëve jo të “disiplinuar” ndaj regjimit.

Një vlerë e vaçant që mbulon veprimtarinë e “Flakës” është përpjekja dinjitoze e Redaksisë së kohës për botimin e edicioneve të saja të radhëve. Andaj në gjirin e Redaksisë së “Flakës” lindën dy fletushka madhore për fëmijë të ciklit të parë të shkollës fillore, “Gëzimi” më 1950 dhe “Fatosi”, 1955. Kjo fillimisht dhe formalisht ndodhi në ombrellën e Redaksisë “Detska radost” të Shtypshkronjës “Nova Makedonija” në Shkup, e mandej kaloi në Redaksinë e “Flakës”. Si fenomen

që duhet theksuar, është befasia se si ndodhi lindja relativisht e hershme e fletushkave në fjalë. Me gjasa kjo kështu ka ndo– dhur sepse shkollimi fillor, posaçërisht ai katërvjeçar për shqiptarët ishte ishte rreptësisht i obligueshëm dhe në nivel të Federatës Socialiste Jugosllave, përkujdesja ndaj këtij cikli të sistemit të shkollimit u respektua pa tolerancë. Akoma më e veçantë për këtë është ajo se fati i dy fletushkave të theksuara ra në duar të dy mësuesve të mëdhenjë që madje ata u ngritën në shkrimtar për fëmijë, Mehmed Ali Hoxha dhe Fejzi Bojku. Si njohës të denjë të filozofisë së punës mësimore që ishin, por akoma edhe si "miq" të mishëruar me imagjinatën e fëmijës, arritën që fletushkat në fjalë të luajnë rolin e abetares së dytë dhe të librit të leximit, veçanërisht në kohë të mungesës së skajshme të burimeve të fjalës së shkruar. Nxënësit që u rritën me "Gëzimin" dhe "Fatosin" e dy redaktorëve me nam, me admirim i rikujtojnë.

Gjithashtu, me insistim të kuadrit të vyet të "Flakës", nga viti 1962 filloi botimi i revistës së mirënjohur për kulturë, art dhe shkencë "Jehona", të cilën e menaxhoi i madhi Murteza Peza, fillimisht në redaksi të veçantë, e më vonë, nga viti 1972 kaloi në mbulesë të Redaksisë së "Flakës". Roli i kësaj reviste për kohën është i papërsëritshëm, sepse për bashkëpuntorët e saj ishte në rolin e një ure kaluese të kuadrit profesional e shkencor të kohës që ngritej nga "Flaka". Madje, shtojca e saj "Pedagogu", shkallëzonte në nivel të standardeve të "Jehonës", ku selektimin e autorëve përpiqej ta zhvillonte mbi kritere të aparaturës shkencore. Ndërsa, për lexuesit ishte një

dritare e ndritur prej nga ndiqnim zhvillimin e ngjarjeve në kulturë, art dhe shkencë në përmasat përbrenda nacionale, rajonale e ndërkombëtare.
Një edicion tjetër i vyer i "Flakës" ishte "Lektyra shkollore". Ajo botohej në Redaksinë "Detska radost" të Shtëpisë botuese "Nova Makedonija" deri në vitin 1968, kur mandej, në klimë politike më të relaksuar, ky edicioni i botimeve shqipe kaloi në Redaksinë e "Flakës". Dhe në mbulesë të kësaj redaksie u botua një numër i konsiderueshëm i lektyrave me tituj e autor të përzgjedhur me mjeshtri psikopedagogjike që shembëllenin. Gjithashtu u botua edhe një numër i librave cilësor të përzgjedhur nga autor që krijuan emër.

*Përgjithësime*

–Redaksisë së "Flakës", përtej përpjekjeve, bile edhe me sa–krifica që zhvilloi në intervalin e afër pesë dekadave (1945–2004), nuk iu lejua që shqiptarëve të Maqedonisë t'ju ofrojë informim shqip të përditshëm;
–Përfaqësimi i shqiptarëve në kulturë, vështruar në raport me atë maqedonas, shënon indeks nënçmues;
–Shqiptarit nuk i ndalohej të shfrytëzojë intitucione të kulturës maqedonase, por nuk ishte institucionalisht i përfshirë në burime të kulturës së saj;
–Rikujtojmë, gjithashtu se sipas gjendjes së shënuar të vitit 1991, përtej institucioneve të nominuara më lart, në disponim të popullatës maqedonave u shënuan akoma edhe 127 biblio–

teka publike me 65 salla leximi, 21 muze të kulturave të ndryshme, 33 shtëpi të kulturës, 11 arkiva, 6 filharmoni dhe orkestra profesionale, një ansambël të folklorit popullor, 1146 organizata për kulturë fizike, 160 organizata për kulturë te–knike, 33 institute shkencore[19].

[19] Burime të cituara.

*XHELADIN MURATI*
*Ish–redaktor dhe bashkëpunëtor i "Flakës së Vëllazërimit"*

# KONTRIBUTI I "FLAKËS" NË AFIRMIMIN E MENDIMIT PEDAGOGJIK

Në historinë e zhvillimit shoqëror gazetat në të gjitha shoqë–ritë dhe kohët shërbyen dhe shërbejnë për informim të drejt dhe objektiv dhe nxitjen e përparimit të përgjithshëm. Këtë rol dhe funksion e pati edhe "Flaka e vëllazërimit", e cila gjatë viteve të botimit (1945–2004) shërbeu si një burim për kul–tivimin e kulturës dhe vlerave kombëtare.

"Flaka..." ishte nje nga gazetat me dominuese të jetës politike, kulturore dhe arsimore të shqiptarëve të Maqedonisë. Megji–thatë, pass viteve të '90–ta, kur ngriheshin edhe gazeta të tje–ra, ajo provoi të kundërtën,gradualisht hapi rrugën e fshirjes.

"Flaka" është një gazetë që dëshmoi varësinë e saj nga orienti–met e zhvillimit shoqëror të kohës, kryesisht të sistemit monist.

Ndikimi i "Flakës" nuk kufizohet vetëm në informimin poli–tik të qytetarëve, por i kaloi ato e u ushtrua në fusha e sfera të ndryshme të jetës shoqërore siç janë familja, shkolla, feja, so–cialja etj. Ajo në sytë e lexuesve dhe të opinionit u shndërua në një model apo faktor të ndikimit kulturor e arsimor.

Përfshirja e problemeve arsimore, pedagogjike, edukative, shkollore në gazetë ishte një fakt i natyrshëm. E panatyrshme do të ishte po qe se ato do të mungonin.

Duhet thenë se në përgjithësi gazeta e ka marrë formën dhe misionin e saj të plotë pas daljes si gazetë e përditshme, pra pas viteve të '90–ta.

1.

Gazeta "Flaka" veproi që nga nisma (1945) si një nga institucionet informative në gjuhën shqipe në Republikën e Maqedonisë dhe kontribuoi në rindërtimin e shoqërisë, të mendimit dhe të mentalitetit progresiv. Nga kjo rendësi buron edhe domosdoshmëria e orientimit të saj në periudhën e totalitarizmit, por edhe e përdorimit efikas të saj, të ndikimit të saj në proceset shoqërore–politike (1945 – 1990). Të dyja këto funksione ajo i realizoi me sukses. Ishte një burim i rendësishëm për realizimin e jetës politike, informative, kulturore, arsimore, shkencore, fetare, sociale, shëndetësore, bujqësore, sportive e të ngjashme.

"Flaka e vëllazërimit" ishte më shumë se një gazetë. Ajo ishte nje gazetë me qëllime fisnike e me rrezatim të gjerë shoqëror. Synonte për të qenë një burim ku studiues, intelektual, student e nxënës të gjejnë ate që u intereson.

"Flaka..." që nga themelimi ishte nje institucion e cila vihet përballë historisë për të evidentuar edhe ndryshimet që ajo ka bërë në mentalitetin e lexuesit, por edhe ndryshimet që ajo ka sjellë në trajtimin dhe aktualizimin e problemeve pedagogjike dhe dimensionet sociale.

Çështja shtrohet: në ç’masë “Flaka...” ishte produkt i faktorit politik dhe në ç’masë ajo ishte produkt i ndikimeve tjera kul–turore, arsimore, sociale, kombëtare?
Nuk mund të gjejmë ekuilibrim mes këtyre dy çështjeve, por kam bindjen se gazeta mbajti ndezur rolin e politikës në sho–qëri dhe reflektimi i saj në momentet kyçe të zhvillimit të shoqërisë shqiptare. Kjo çështje është e prerë sepse ajo krijon–te opinion politik të politikës zyrtare e cila për shqiptarët ishte permisive, ngulfatëse. Me kalimin e kohës “Flaka...” gradua–lisht përpiqej ta kapërcej pragun politik, fillon potencimi i çështjeve të kulturës, arsimit, një mision dhe funksion i ndryshëm në shoqëri nga politika.
Në këtë këndvështrim mund të bëjmë fjalë për një dallim të madh midis gazetës si institucion informativ, dhe gazetës si institucion që trajtonte sfera të tjera të jetës në veçanti arsimin, edukimin, shkollën. Thjeshtë, ajo i ngjante një enciklopedie që përfshinte të gjitha fushat e jetës, mbase ishte e vetmja ga–zetë në gjuhën shqipe.

2.
Dy veçori globale e karakterizojnë veprimtarinë e “Flakës...”: Së pari, determinizmi politik në veprimtarinë e saj ishte fa–ktori më i rendësishëm në redaktimin e gazetës. Pavarësisht se politika (e egër) binte ndesh me interesin kombëtar, ajo në përpikëri respektohej. Në këtë kontekst kam bindjen se poli–tika shkaktonte konflikt, lëvizje dhe mungesë ekuilibri te disa bartës të funksioneve redaktuese.

Por mekanizmi i kontrollit politik që ushtrohej ndaj politikës redaktuese të gazetës ishte i ndryshëm.

Së dyti, karakteristikë e veprimtarisë së gazetës ishte rritja dhe zgjerimi i sferës së veprimit të saj në të gjitha segmentet e shoqërisë. Nga vitet e '70–ta "Flaka..." u bë faktor dhe institucion i rëndësishëm jo vetëm informativ, por edhe laborator mbi arsimin e edukimin, të inicuara nga nevojat praktike utilitare të shkollës e të arsimtarëve për aktualizimin e qasjeve dhe pikëpamjeve konkrete teorike dhe praktikën e përparuar. Kjo është e rendësishme për kohën kur në shoqëri ndodhin ndryshime të rëndësishme, që përfshijnë të gjitha aspektet dhe dimensionet e shoqërisë në gjerësi e thellësi, në strukturë e organizim, në platformë e përmbajtje.

Është gjithashtu i shpjegueshëm qëndrimi i "Flakës" ndaj politikës. Ajo duhej të luftonte të gjitha elementet që e nxitnin "nacionalizmin shqiptarë dhe iredentizmin", siç e proklamonte politika zyrtare e kohës "rrezik për shoqërinë". Përkrahja e kësaj politike krijoi një atmosferë mbytëse për zhvillimin e mendimit të lirë, dhe penguan, ku de facto e ku de jure afirmimin e lirë të mendimit progresiv shqiptarë e të vlerave të vërteta kombëtare.

Në këtë prizëm është i qartë roli i "Flakës..." në shoqërinë shqiptare në Maqedoni e më gjerë.

3.

Nisur nga rrethanat e reja të krijuara në vendin tonë me kalimin nga shoqëria totalitare në shoqërinë demokratike, edhe

kursi politik informativ, social e kulturor–arsimor filloi të rindërtohet në një orientim të ri. Dinamika e këtij kursi esen–cialisht ndryshoi.

Në rrethanat e zhvillimit të reformave shoqërore dhe refor–mën shkollore, ajo kontribuoi drejtpërdrejti në ristrukturimin e tyre si proces i domosdoshëm i përparimit.

Edhe pse "Flaka..." kishte kushte dhe mundësi të zbulonte ato njerëz që do të ishin bartës të zhvillimit shoqëror, ato stru–ktura që ishin në gjendje të përballen me sfidat e kohës, për arsye të klimës politike nuk arrinte.

Në vitet e '70–ta e 80–ta, te "Flaka..." dhe përgjithësisht te shqiptarët e Maqedonisë, filloi te ndjehej një klimë më e re–hatshme, u krijuan kushte relativisht të favorshme për afirmi–min dhe nxitjen e problemeve arsimore, kulturore e kombë–tare, poashtu edhe ato të politikës. Reflektohej një liri dhe liberalizim i dalluar në qasjet dhe trajtesat e aspekteve arsimo–re. Ky reflektim nuk zgjati me shumë se një dekadë dhe u ngulfat pas '81–shit, kur politika e eger maqedonase bëri çme–ndurina me arsimin, kulturën dhe jetën e shqiptarit. Kjo ç–menduri reflektohej edhe në gazetë.

Imazhi pozitiv filloi të ndryshoj me fillet e pluralizmit, kur u çlirua nga kthetrat e totalitarizmit.

4.

"Flaka" e reflektonte qenësisht ndikimin e saj mbi arsimin, edukimin dhe shkollën në mënyra e forma të ndryshme. Ky intenzitet ishte i ndryshëm në monizëm e pluralizëm. Në

përgjithësi veprimtaria informative e saj realizohej paralel veprimtarisë arsimore në tre forma:

–forma dominuese (me materiale konkrete profesionale, pedagogjike, arsimore, metodike, etj.);

–forma e mbështetjes (përmbajtja e risive nëpërmes qasjeve, punimeve), dhe

–forma selektive (kërkohej përshtatshmëri, cilësi, sistem vlerash).

Në këtë aspekt me rëndësi të veçantë është trajtimi i problematikës që inicohet nga nevoja për përparimin e arsimit. Eshtë i pamohueshëm fakti se "Flaka" ushtroi ndikim mbi arsimin, shkollën, politikën arsimore, mësimin në rrethanat kur arsimi kishte për synim bashkëkohësimin e tij, në kohë kur mungonte literaturë e mirëfilltë shqipe. Ajo ushtroi ndikimin e saj dhe kontribuoi për njohjen e arsimtarëve me risitë, përmbajtjet dhe qasjet pedagogjike ndaj arsimit. Optika më e gjërë e trajtimit të problemeve pedagogjike dallon nga vitet e '70–ta, kur në "Flakë" filloi defilimi i autorëve të shumtë, të cilët, në një mënyrë ose në një tjetër, shtruan qasje teorike e praktike të problemeve pedagogjike. Trajtesat dhe qasjet e tyre aktualizonin problemet e shkollës bashkëkohore, të metodologjisë së mësimdhënies, të planeve dhe programeve mësimore, të reformës së shkollës e të ngjashme.

Në këtë kontekst vlen të theksoj disa nga autorët që elaboruan pikëpamjet pedagogjike siç janë: Gjergj Vlashi, Rexhep Rexhepi, Tahir Zajazi, Xheladin Murati, Nexhat Abazi, Haxhi Fida, Avzi Mustafa, Baki Bakiu, Ahmet Hajdari, Gani Skuka,

Qani Latifi, Nehat Hajrullai, Shaip Bajrami, Luman Cerme–nika, Sejfedin Haruni, Rami Veliu, Gajur Islami, Musa Kraja, Sabaudin Zhuta, Fadil Vehapi–Lushi, Sherif Beqiri, Reshat Ameti e shumë të tjerë, të cilët elaboruan aspekte e dimen–sione pedagogjike, didaktike, metodike ,arsimore, edukative e të ngjashme.

Në "Flakë" nuk munguan edhe trajtesat e mia mbi çështje të vetë pedagogjisë dhe problemeve nga didaktika, metodika, praktika shkollore e të ngjashme si për shembull: Politika ar–simore; Sistemi arsimor në Maqedoni; Reforma e arsimit; Aspektete e refomimit të arsimit; Roli dhe funksionin i shër–bimit pedagogjik; Suksesi dhe mossuksesi i nxënësve; notimi dhe vlerësimi; Metodat dhe parimet mësimore; Orientimi profesional; Planifikimi dhe programimi i punës mësimore; Roli i familjes në edukimin e fëmijës; Roli i pedagogut në përparimin e mësimit; Delikuenca e të miturëve; Përsosja profesionale e arsimtarëve; Krijimtaria pedagogjike; Komuni–kologjia pedagogjike, etj.

Gjithashtu, duke u hedhur një sy më nga afër të trajtesave të botuara, mund të konstatojmë se trajtimi i problemeve të kë–saj natyre e bëri "Flakën" një lloj doracaku për punën peda–gogjike të arsimtarëve. Kjo edhe për arsye se në faqet e saja dominuan trajtesa, probleme e tema aktuale nga praktika ar–simore dhe shumë më pak problem nga tradita.

Gjithsesi janë trajtuar edhe tema nga historia e pedagogjisë dhe e shkollës dhe mendimtar pedagogjik si për shembull: Aspektet edukative të J.A.Komenskit; Botëkuptimet pedago–

gjike të social–utopistëve; Mendimi pedagogjik i Naim Frashërit; Naimi dhe Samiu; Pikëpamjet e Pestalocit, Roli i shkollave normale, e të ngjashme.

Duhet permendur edhe faktin se me trajtesa pedagogjike ka pasur edhe autorë joshqiptar, të përkthyer në shuhën shqipe.

Këto dhe shumë punime të tjera kishin reflektime dhe përparësi sidomos në aspektet e tyre zhvillimore, në përgatitjen profesionale, zhvillimin profesional të arsimtarëve dhe ngritjen e kulturës pedagogjike në familje, në shkollë.

5.

"Flaka" ecte në hap me kohën, u përshtatej rrethanave të reja dhe rregullave të sistemit.

Një provë tjetër që dëshmon për nxitjen dhe afirmimin e çështjeve arsimore, kulturore, shkollore, shkencore, është edhe fakti i orientimit të saj drejt zgjerimit të misionit dhe funksionit në këto fusha.

Gjithnjë veprimtaritë që kryheshin në kuadrin e saj (punimet, trajtesat, qasjet), si dhe veprimtaria botuese (veprat, revistat "Fatosi", "Gëzimi" dhe revista për shkencë dhe art "Jehona") i shërbenin një qëllimi – afirmimin e vlerave kombëtare. Ky qëllim buronte nga misioni që i kishte vënë vetes gazeta. Në varësi të këtyre vendoset e tërë veprimtaria informative–botuese. Thjeshtë, veprimtaritë e jetës së përditshme në "Flakë" ishin rigorozisht të përcaktuara e të planifikuara por të kontrolluara nga pushteti politik

Dimensioni i mendimit pedagogjik, arsimor e shkollor u zgjerua me botimin e shtojcës për çështjet e edukimit dhe arsimit "Pedagogu" që dilte çdo të mërkurë (nga viti 1975 –) me këshill redaktues: Tahir Zajazi, Xheladin Murati, Feim Isai, Haki Selimi, Eshref Aliu.
Ndryshimet në rolin dhe misionin ndaj arsimit e shkollës, sensi i ri i kërkesave profesionale ndodhin domosdoshmërisht me kalimin në sistemin demokratik. Veçanërisht këto ndryshime të trajtimit të problemeve arsimore ndodhën në afirmimin e modeleve të karrierës, në ngritjen profesionale, në largimin e temave ideologjike, në ndryshimin e sjelljes të arsimtarëve ndaj arsimit e shkollës.
"Flaka" nuk kishte forcë të afirmojë të gjitha vlerat e mirëfillta kombëtare. Këto reduktime bëheshin në emër të politikës së LKM–së së atëhershme. Autoriteti i saj ishte absolut, i pa–kontestueshëm. Duke qenë në këtë pozitë, "Flaka" ishte e detyruar që të bindej verbërisht edhe për gjërat më të imta e të paqena. Eshtë vështirë t'i rezistohet kohës, por kjo fatkeqë–sisht u dëshmua te gazeta, për shembull, përdorimi i toponi–meve në gjuhën maqedone në periudhën e caktuar, selektimi i autorëve dhe punimeve.

*Përfundim*

Nga sa thamë më lart del të konkludojmë, se:
(1) Gazeta "Flaka..." dhe problemet e trajtuara në të, luajtën një rol të madh në përgatitjen profesionale e pedagogjike të

arsimtarëve shqiptarë. Duhet thenë se ky rol ka reflektime në familje, shkollë dhe ente social–pedagogjike;
(2) Pavarësisht sa folëm më lart për rolin dhe kontributin e "Flakës" në afirmimin e arsimit, edukimit, shkollës, qëllimet themelore të saj ishin zhvillimet politike dhe ekonomike të shoqërisë e të kombit. Gjithashtu nuk duhet harruar se funksioni i saj shumëdimensional, fusha kryesore e veprimtarisë së saj ishte informimi për një kompleks faktorësh zhvillimor ekonomik, social, fetar, familjar, industrial, politik, urban, rural, bujqësor e të ngjashme;
(3) Në krahasim me këto fusha, arsimi dhe kultura janë për nga përfshirja dhe trajtimi në një positë të priveligjuar. Avantazhi i arsimit dhe kulturës qëndron në faktin se ato veprojnë si agjent të ndryshimit të vetëdijes, vlerave, ndërgjegjes, mentalitetit e të ngjashme;
(4) "Flaka" nuk ishte vetëm burim informacioni, por edhe shkollë ku krijuesit i mprehën dhe provuan shpatat në artin e të shkruarit filozofik, pedagogjik, sociologjik e të ngjashëm.

*Përmbledhje*

Kumtesa është hartuar duke konsultuar artikujt që prekin problematika të ndryshme që lidhen me mendimin pedagogjik që ka shtrirje në sfera të ndryshme si didaktike, metodike, metodologjike, social–pedagogjike, komunikuese, e që kanë qenë me interes për arsimtarët dhe teorinë pedagogjike e praktikën shkollore.

"Flaka" (1945 – 2004) ishte nje nga gazetat më dominante në jetën politike, kulturore e arsimore të shqiptarëve të Maqe–donisë. Megjithatë, pas viteve të '90–ta, kur ngriheshin edhe gazeta të tjera, ajo provoi të kundërtën, ndalesën.

Materialet e botuara me përmbajtje e karakter pedagogjik ka–në qenë eksperienca dhe ndërhyrje për organizimin e procesit arsimor në shkollë dhe ndryshimin e arsimtarit e të shkollës.

Në mënyrë të përmbledhur mendimi pedagogjik i trajtuar në faqet e gazetës mund të shprehet si qëndrim kritik ndaj punës pedagogjike të arsimtarëve, duke theksuar dhe dhënë përpa–rësi analizës të problemeve të realitetit pedagogjik e struktura bashkëkohore të shkollës.

*BERTON SULEJMANI*
*Universiteti Shtetëror i Tetovës*

# KUJDESI NDAJ NORMËS GJUHËSORE PARA DHE PAS 1972–SHËS NË GAZETËN "FLAKA E VËLLAZËRIMIT"

*Në këtë shkrim do të paraqesim një histori të shkurtër dhe një vëzhgim të thellë gjuhësor të gazetës "Flaka e vëllazërimit" e më vonë vetëm "Flaka". Numri i parë i saj doli në vitin më 4 prill 1945 në Shkup. Tri herë në javë filloi të shtypet në vitin 1971. Prej 26 majit 1994 "Flaka" u bë e përditshme. Hulumtimi mbi gjuhën e gazetës e kemi shtrirë në katër dekada të botimit të saj (1970 – 2001).*
*Hulumtimin tonë e kemi shtrirë në shumë fusha të gjuhësisë. Është me interes se pas Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe (1972), kjo gazetë e mori si detyrë kombëtare zbatimin e asaj që u vendos në Tiranë. Madje numrat e viteve 1970 – 1972 mund të themi se luanin një rol kryekreje në pasqyrimin e prirjeve të letrarishtes (shqipes standarde) brenda dy vjetëve para Kongresit të Drejtshkrimit…*

Është për t'u përshëndetur kjo nismë e mbarë e Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve–Shkup, që me rastin e 70 vjetorit të daljes së numrit të parë të gazetës në gjuhën shqipe "Flaka e vëllazërimit", ta përkujtojë me një simpozium shkencor që u mbajt më 04 prill 2015 në

ambientet e insitutit në fjalë. Në këtë simpozium morën pjesë edhe një numër i madh i ish–kryeredaktorëve, ish–redaktorëve e ish–gazetarëve të cilët tregonin përvojat e tyre gjatë periudhave të ndryshme në "Flakë". Te shumica e pjesëmarrësve shihej një pikëllim që në këtë ditë po shënohen dy data. Ajo e daljes së numri të parë, pra 70 vjetori. E dyta, e dhimbshmja, 10 vjetori i mbylljes së kësaj gazete.

Gjuha e shtypit tonë ka qenë, është dhe vazhdimisht do të jetë objekt i vëmendjes së gjuhëtarëve shqiptarë të cilët, shtypin, kryesisht e shikojnë nga këndvështrimi i zbatimit të standardit të shqipes. Objekt i këtij studimi është që të nxjerr në sipërfaqe nivelin e zbatimit të normës letrare të gazetës së përditshme[20](e cila më nuk botohet për arsye të panjohura) "Flaka e vëllazërimit" dy vjet para dhe pas Kongresit të Drjetshkrimit të Gjuhës Shqipe (1972), më saktësisht prej vitit 1970 – 2001. Siç dihet, gjuha e shtypit, sjell disa karakteristika që dalin, para se gjithash, nga funksionet themelore të shtypit si mjet i informimit publik, siç janë: funksioni komunikues, ekspresiv, impresiv, kontaktues e poetik, nga të cilat, tri të parat janë kryesore[21].

Gjuha e shtypit është e llojllojshme. E karakterizojmë si të tillë sepse shprehjet gjuhësore të shtypit paraqesin dallime edhe atë varësisht nga lloji/gjinia i/e gazetarisë. Çdo gjini e gazetarisë shtron kërkesa të ndryshme para gazetarit që më pastaj

[20] Në fillim gazeta ka dalur tri ditë në javë: të dielën, të mërkurën dhe të premten.

[21] Валери Писарек, *Журналистичесто маисторство*, (përkthyer nga polonishtja), Sofje, 1980, fq. 68.

reflektohen edhe në gjuhë. M'u për këtë arsye mund të flitet dhe për stile të veçanta të llojeve të gazetarisë. Por, marrë në përgjithësi në aspektin e gjuhës mund t'i ndajmë në njërën anë llojet e informimit (lajmin dhe raportimin) dhe komentin si gjini analitike (me nënllojet: shënimin, kronikën shoqërore, artikullin dhe recensionin) dhe nga ana tjetër intervsitën dhe reportazhin. Te të gjitha gjinitë e lartpërmendura mbizotëron ndonjë nga funksionet e gazetarisë (te lajmi – funksioni komunikues, te reportazhi – funksioni ekspresiv, e kështu me rradhë), por një element, për të gjitha gjinitë e gazetarisë është i përbashkët: duhet të shkruhen në gjuhën letrare (d.m.th. gjuhën standarde, në kët rast në shqipen standarde) gjegjësisht duhet të shkruhen në përputhje me normën letrare.

Numri i parë i gazetës "Flaka e vëllazërimit" doli më 1 prill 1945 në Shkup. Dalja e një organi si ky, në mjediset gjuhëso–re të Shkupit, Tetovës, Kumanovës, Gostivarit, Kërçovës, Dibrës, Strugës, Ohrit, Manastirit, d.m.th. në këto treva shqiptare të ish–Jugosllavisë (sot Maqedoni) kishte një rendësi të madhe, përveç të tjerave, edhe për përhapjen e ngulitjen e normës së gjuhës së shkruar letrare. Zbatimin e standardit të shqipes në gazetën "Flaka e vëllazërimit" e hasim edhe para Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe (1972). Numrat e viteve 1970 – 1972 mund të themi se luanin një rol kryekreje në pasqyrimin e prirjeve të shqipes standarde brenda dy vjetë–ve para Kongresit të Drejtshkrimit[22]. Gjeografia gjuhësore e shkrimeve kapte jo vetëm qytetet e Maqedonisë, por edhe të

[22] Hulumtimi përfshin periudhën 1970 – 2001.

Kosovës e më gjerë. Që do të thotë se përfshinte të gjitha veçoritë e të folmeve që me punën e kujdesshme të redaktorëve njësoheshin mirë në faqet e gazetës. Nuk mungonin edhe shkrimet e autorëve joshqiptarë (serb, kroatë, maqedonas) që i përkthenin e i redaktonin mirë. Është për t'u vënë në dukje që gazeta u ruajt mjaft mirë nga dialektizmat e krahinorizmat, të papranueshme për stilin publicistik. Që në shkrimet e para të vitit 1970, hasim dukuri fonetike e morfologjike që po bëheshin të mbarë shqipes standarde, si: shkrimi i grupeve të bashkëtingëlloreve (mb, nd, ng). Ja disa shembuj të nxjerrë nga nr. 971, 22 kallnor (janar) 1970: *Këto ditë Këshilli Ekzekutiv i RSM **mb**ajti **mb**ledhje nën kryesinë e nënkryetarit të Këshillit Morie Romano. (fq. 1) ... në periudhën 1971 –1975 do të duhet kryesisht të sigurohet **mb**ajtja e rrugëve, përfu**nd**imi i rregullt modernizimit dhe rikonsrtukcionit (për: rikonstruksionit) të drejtimeve të reja. (fq. 1)*; ***Nd**ërtesa e re shkollore tanimë është e vogël. (nr. 971/3; 22. I. 1970, fq.1);* gjithashtu respektohet rregulli i shumësit të emrave dhe mbiemrave me *–nj*, si: *kallinj, mullinj, të rinj, ullinj* etj.

Fill pas Kongresit të Drejtshkrimit, në gazetën "Flaka e vëllazërimit" u bë një punë e madhe për zbatimin e vendimeve të Kongresit. Kjo u krye në dy mënyra, së pari, me kujdesin që gjuha e shkrimeve të ishte sa më e pasur dhe e përpunuar, sipas normave të përcaktuara, dhe, së dyti, me rubrika të veçanta për njohjen e zbatimin e vendimeve të Kongresit[23], me

[23] Nga Maqedonia morën pjesë tre delegatë: Petro Janura, Sefedin Sulejmani dhe Remzi Nesimi.

shkrime të mirëfillta shkencore, si të Androkli Kostallarit, Remzi Nesimit, Petro Janurës, Sefedin Sulejmanit, Xhevat Lloshit, Gjovalin Shkurtajt, Rexhep Ismajlit, etj.

Megjithëse pas Kongresit të Drejtshkrimit kultura gjuhësore e shkrimeve dhe kërkesat ndaj tyre qenë rritur shumë, prandaj do të vëmë në dukje, pranë arritjeve më të mira, edhe shmangie të normës.

Në fushë të morfologjisë dhe drejtshkrimit. Në të gjitha shkrimet e rubrikave të ndryshme të gazetës (prej vitit 1970 deri para Kongresit të Drejtshkrimit) vërehet një punë shumë e mirë për ruajtjen e *ë*–së, sidomos në trup të fjalës, si p.sh.: *Në pikëpamje ushtarake – të zhdukeshin rrënjët e tradhtisë dhe të paaftësisë.* (FV, nr. 1007, 1 tetor 1970, f. 1); *Në fillim të vitit 1960 Naseri gjithnjë e më shumë paraqitet në plan të parë edhe në politikën botërore. (Po aty, në artikullin me titull "Vdiq Naseri – prijës dhe luftëtar për paqe"); Në para–shikimet e gjertanishme konstatohet se Komuna e Tetovës në periudhën e ardhshme të pesëvjeçarit. Gjatë kësaj periudhe priten të investohen më se 400 milion dinarë, kurse industria të jetë bartëse e aktiviteteve... .* (FV, nr. 1020/21, 31 dhjetor 1070, f. 3); *Shkrirja e lehtë dhe përbërja e barabartë granulo–metrike, mundësojnë ndikim të shpejtë dhe efikas te kulturat bujqësore.* (FV, nr. 1019, 24 dhjetor 1970, f. 1); *Në këtë ditë u kremtua edhe pesëdhjetë vjetori i formimit të Komunës së kuqe.* (FV, nr. 1014, 19 nëntor 1970, f. 2) Në numrat e viteve 1970–1972 është bërë një punë e mirë edhe për mënjanimin e *ë*–së përpara prapashtesës *–shëm.* P.sh.: *Është i mundshëm*

*edhe pastrimi poshtë mobileve. Shumë i përshtat<u>shëm</u> për gratë–nënat* (FV, 17 dhjetor 1970, f. 6); *... zhvillim të mëte–jshëm në bazë barazie të plotë.* (FV, nr. 1014, 19 nëntor 1970, f. 1); *»Darwill« me elegancë të jashtëzakon<u>shme</u>, në modelet LADY 71 KALENDAR* (FV, nr. 1020/21, 31 dhje–tor 1070, f. 8*)*. Mospërdorimi i *ë*–së, sigurisht për arsye te–knike[24], vërehet në të gjitha titujt e artikujve që janë shkruar me shkronja të mëdha. Në tekstet e po të njëjtëve tituj për–doret *ë*–ja, por mungon në titujt. P.sh.: **VASHA DHE NJE PASHA NE FONTANEN E MUZEUMIT TE VATIKA–NIT** (NJE për: NJË; NE për: NË; FONTANEN për: FON–TANËN; TE për: TË) (16 tetor 1970, f. 5); **SEMINAR PER PUNETORET E ARSIMIT** (14 janar 1977); **PREZENTIM I SUKSESSHEM I POEZISE SHQIPE** (Po aty); **SUKSESE TE REJA PUNE** (30 janar 1977, f. 10) **PA VESHTIRESI TE MEDHA NE KOMUNIKACION** (11 janar 1985, f. 1); **DREJT TEJKALIMIT TE VENDOSUR TE DOBESIVE** (24 mars 1985, f. 6).

Dihet që numërori rreshtor, kur shkruhet me shifër romake, përdoret pa prapashtesë dhe pa nyje të përparme[25]: *klasa I, Kongresi V, Mehmeti II* etj. Kjo rregull respektohet në shkrimet e gazetës. Ja disa shembuj: *Në realizimin e transfor–mimit socialist vetëqeverisës në edukim dhe arsim, në frymën e konkluzave* (për: *përfundimeve*) *dhe të Rezolutës së* ***<u>Kon–</u>***

[24] Sepse në numrat e viteve 1980 – 2001 përdoret edhe Ë–ja e madhe. P.sh.: më shkruhet FLALËKRYQ e jo *FJALEKRYQ (shih: në numrin 4885, e martë, 10 janar 1995, fq. 15) etj.

[25] *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*, Tiranë, 1973, fq. 137

***gresit X*** *të LKJ* (duhet: *LKJ–së*)*, janë bërë* ...(14 janar 1977, f. 3). *Libri i parë "Josip Broz Tito* (duhet: *Titos*)*: fjalime dhe artikuj" doli nga shtypi në vitin 1961, kurse* ***libri XV*** *u botua në vitin 1971. (12 janar 1977, fq 4); aktiviteti është zhvilluar në kuadrin e përgatitjeve të* ***Kongresit XI*** *të LKJ* (duhet: *LKJ–së*) *dhe 40–vjetorit të ardhjes së shokut Tito në krye të Partisë* (26 janar 1977, fq. 9)

Në emërtimet e shkurtuara të institucioneve, të zyrave, të ndërmarrjeve, të organizatave etj; viza lidhëse në këtë rast vihet midis tyre dhe nyjës së prapme ose mbaresës[26]: *SMT–ja e Lushnjes, Komiteti Qendror i BRPSH–së, sesioni i 28–të* etj. Mosrespektimi i kësaj norme, në "Flakën e vëllazërimit" vërehet shumë. P.sh: *Kryesia e Kuvendit të RSM,* (duhet: RSM–së) *nën Kryesinë e Bllagoja Taleski* (12 janar 1977, fq 4); *avangardës së saj – PKJ* (duhet: PKJ–së) (28 prill 1970, f. 3); *Po ashtu shtrohet edhe detyra që në aksionin e LKJ* (du–het: LKJ–së) *të fillojë realizimi ... Në mbledhje merrte pjesë edhe sekretari në KE të KKQ të LKJ,* (duhet: sekretari i KE–së të KKQ–së të LKJ–së) *Dr. Aleksandar Gërliçkovi.* (14 ja–nar 1977, fq.3); *... udhëheqës në kuadrin e OPB* (duhet: OPB–së) *ashtu edhe në nivel të komunës.*(26 janar 1977, fq. 9) *MBP* (duhet: MBP–ja) *as që ka bërë dhe as që do të bëjë përgjime të bisedave telefonike* (19 janar 2001, f. 3). Krejt ndryshe, pra në të mirë, qëndron puna me numrat e viteve 1981–2001. Kjo shmangie thuajse nuk vërehet më, edhe pse aty–këtu rrallë e hasim. P.sh.: *Tubim shkencor "Armatat në*

[26] *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*, Tiranë, 1973, fq. 138.

*konceptin strategjik të* ***LNÇ–së*** *dhe revolucionit". Qëndrim treditor i kryetares së* ***KEF–it****, Millka Pllanincit në Francë.* (16 janar 1985, fq. 1); *Po ashtu ë këtë tubim të* ***LMM–së*** *u para–qit nevoja ...* (16 janar 1985, fq. 15); *Si organ i Frontit Na–cionalçlirimtar, përkatësisht i* ***LSPPM–së,*** *u tha me këtë rast "Flaka e vëllazërimit" në periudhën e kaluar 40–vjeçare luajti një rol të rëndësishëm.* (17 shkurt 1985, fq.1); *Delegacioni i* ***PDS–së*** *në Shkup* (18 janar 1995, f. 4) etj.

Vërehen gabime në ndarjen e fjalëve në fund të rreshtit. Dihet se jo vetëm në gjuhën shqipe, por në të gjitha gjuhët e lë–vruara të botës ka rregulla të qarta për ndarjen e fjalëve në fund të rreshtit. Ndër të më kryesoret janë që një shkronjë e vetme nuk mund të mbetet në fund të rreshtit. Nuk ndahen në fund të rreshtit prapashtesa e një numërori rreshtor të shë–nuar me shifra arabe dhe nyja e prapme e mbaresat në ato raste kur shkruhen me vizë lidhëse (Drejtshkrimi ..., fq 164). Po kështu nuk und të ndahet një tog çfarëdo shkronjash në fund të rreshtit, në qoftë se nuk formon rrokje (*sh–qiptar, A–merika, S–hqipëria, të sh–tunën, fëm–ija* etj). Ja disa shembuj të nxjerrë nga gazeta: *Nga përfaqësuesit zyrtar të SHBA–ve, BRSS–së* (*–ve; –së* është ndarë në fund të rreshtit); (27 shkurt 1985, fq 5); *Inkurajon e–dhe rezultati i Napredokut të Kërçovës* (është ndarë lidhëza) (20 mars 1985, f. 15); *edhe parathënien a–nalitike* (duhet: ana–li–ti–ke) *të këtij libri* (28 janar 1977, f. 13);

Një kujdes të veçantë i kushtohet shkrimit të emrave të për–veçëm të huaj, kur dihet që sot kjo normë e shqipes shumë

pak respektohet. Shkrimi i emrave të përveçëm të huaj mbë–shtetet përgjithësisht në shqiptimin e tyre në gjuhët përkatëse, duke iu përshtatur sistemit grafik të shqipes. Por, një çështje tjetër që do vë në dukje si e metë e përsëritur, është edhe përdorimi i tyre pothuaj rregullisht në formë të pashquar në rasën emërore të shembujve të mëposhtëm. P.sh.: *Çka arriti **Margaret Theçer*** (duhet: ***Margaret Theçeri***) (17 mars 1985, f. 5); *U lexua edhe telegrami i kryesuesit të OKB–së **Pol Lusa–ka**, i cili gjendet për vizitë në vendin tonë* (22 mars 1985, f. 1); ***Xhesi Ovensi** fenomenal; djaloshi fenomenal **Karl Luis*** (duhet: ***Karl Luisi***) *i cili në Lojërat Olimpike në **Los Anxhe–los**; do të fluturojë edhe përtej ëndrrave – thotë trajneri i tij **Xho Daniels*** (për: ***Xho Danielsi***) (22 mars 1985, f. 15); *Jemi të bindur – i deklaroi **Li Çiang*** (duhet: ***Li Çiangu***) *Tanjugut* (26 janar 1977, f. 16); ***Manuel Fraga Iribarne**, shpalli progra–min e vet politik* (28 janar 1977, f. 1); *600 përfaqësues diplo–matikë dhe konsullarë* (duhet: konsullorë) *në **Uashington*** (28 janar 1977, f. 7); *Konferencës së **Helsinkit*** (sot në shumë ga–zeta e hasim formën e gabuar, Helsinkut) *dhe të dokumentit përfundimtar* (30 janar 1977, f. 4) etj.  Këtë kujdes e gjejmë edhe te numrat e viteve 1995 – 2001, si, p.sh: *Gjenerali **Xhorxh Xhauvlan** sot në Shkup* (16 janar 1995, f. 3), ***Alen Ajverson** – i pandalshëm* (19 janar 2001, f. 13). Në shumë gazeta të kohës, por edhe në disa media emrat dhe mbiemrat e huaj shkruheshin me alfabete të huaja, si p.sh: Georg për Xhorxh, Ayverson për Ajverson etj.

Një çështje tjetër e veçantë, që ka qenë mjaft drastike deri në fund të viteve nëntëdhjeta (1990), është shkrimi i vendeve (toponimeve) shqiptare me format sllave. Në tekstet shkollore[27] për nxënësit shqiptarë në Maqedoni përdorimi i formave sllave ka qenë i pranishëm[28]. Mirëpo, një gjë e tillë nuk ndodh në numrat e gaztës "Flaka e vëllazërimit" të viteve 1970–2001 të cilat i kemi vëzhguar. Ja disa shembuj të nxjerrë nga numra të ndryshëm: *Në mbledhjen e Kryesisë të Këshillit komunal të Lidhjes së Sindikatave të Kërçovës*[29] (1 prill 1977, f. 9); *Shkup*[30]*, 22shkurt* (23 shkurt 1977, f. 1)); *Qytetarë të Shkupit* (23 korrik 1970, f. 2), *organizatat partiake të Manastirit*[31]*, Prilepit, Velesit dhe Shkupit* (30 korrik 1970, f. 3); *në komunën e Dibrës*[32] *janë organizuar* (09 korrik 1970, f. 2); *për këtë arsye para banorëve të Ohrit*[33] *çfaqet* (duhet: shfaqet) *problemi* (23 korrik 1970, f. 2) etj.

**Brenda normës morfologjike** vlen të përmendet edhe përdorimi i gabuar i emrave të përveçëm, sidomos në bashkëvajtje me mbiemrat përkatës (shih më lart edhe te shkrimi i emrave të përveçëm të huaj). Nga vetë funksioni i tyre, emrat e përveçëm janë të dalluar kuptimisht, andaj përdorimi i tyre në

[27] Shih: Berton Sulejmani: *Përdorimi i toponimeve shqiptare në tekstet shkollore shqipe (1981 – 1989) të botuara në Maqedoni,* konferencë shkenore për toponiminë të organizuar nga ITSHKSH, Shkup, 2013.

[28] Shih:Qemal Murati, *Drejtpërdorimi i shqipes dhe kultura gjuhësore,* SHB Asdreni, Shkup, 1996, f. 95–97.

[29] *Kiçevo* haset në shumë tekste shkollore për shqiptarët.

[30] *Skopje* e gjejmë në tekstet shkollore.

[31] *Bitolla* e gjejmë në tekstet shkollore.

[32] *Debar* e gjejmë në shumë tekste shkollore për shqiptarët.

[33] *Ohrid* në tekstet shkollore.

trajtë të shquar a të pashquar s'ka vlerë kuptimore. Megjithatë, në përputhje me natyrën e shqipes si gjuhë me eptim (lakim dhe zgjedhim), këta emra duhet t'u nënshtrohen gjedheve të saj të lakimit. Në gazetën "Flaka e vëllazërimit", emrat e për–veçëm, sidomos mbiemrat e familjeve të huaj i shohim në trajtë të pashquar, që bie në kundërshtim me natyrën e shqi–pes si gjuhë me lakim të zhvilluar. P.sh.: *Dollanc, Stamboliq dhe Mojsov (*për: **Dollanci, Stamboliqi dhe Mojsovi***) biseduan me Nkomo (*për*:* **Nkomon***)* (26 janar 1977, f. 2); *Me urdhrin e kryetarit të Republikës, Josip Broz Tito (*për: **Josip Broz Titos***), me titullin Qytet Hero u dekoruan...* (26 janar 1977, f. 10); *Tito (*për: *Titoja) i dërgoi urim Zhiskarit; Kadar* (*Janosh Kadar*) *(*për: *Kadari) priti Miniqin (Millosh Miniq)* (2 shkurt 1977, f. 1); *Veselin Gjiranoviq (*për: *Veselin Gjiranoviqi) kandidat për kryetar të KEF–it* (16 shkurt 1977, f. 3); *Abate (*për: *Abatja) (Atenafu Abate) do të vizitojë Jugosllavinë* (23 shkurt 1977, f. 1); *Gligorov (*për: *Gligorovi) priti Makoten* (2 mars 1977, f. 1); *Usmahoxhajev (*për: *Usmahoxhajevi) priti Karajanovin* (18 janar 1985, f. 2); *Zoran Filipoviq* (duhet: *Zoran Filipoviqi*) *shënoi golin e parë për reprezentacionin tonë*; *Partizani avansoi* (për: *avancoi*) *nëpërmes Dragan To–doriq* (duhet: *Dragan Todoriqit*) (09 shkurt 1977, f. 15) etj. Ka raste që i gjejmë të përdorur drejt: *pjesë nga referati i Dr. Timo Vllashkaliqit* (16 shkurt 1977, f. 2); mirëpo *Shon Eliot* (duhet: *Shon Elioti*), 7,7 sekonda para përfundimit të nde–shjes, (18 janar 1995, f. 13); *Tajson* (duhet: *Tajsoni*) pas luftës në të cilën fitoi me nokaut (19 janar 2001, f. 13) etj.

Në fushën e leksikut. Në gazetë është bërë një punë e kujdesshme edhe për pastrimin e fjalëve të huaja e zëvendësimin e tyre me fjalë shqipe. Megjithatë, aty–këtu, sidomos gjatë viteve 1983–1989[34], shfaqen e rishfaqen edhe fjalë të huaja, krejt të zëvendësueshme e të zëvendësuara me fjalë shqipe, si: *Konkluzionet* (mund të zëvendësohet me fjalën shqipe përkatëse: ***përfundimet***) *e LKJ–së për sendërtimin e rolit prijatar dhe për forcimin e unitetit* (mundet: ***bashkimit***) *ideor; Konstatimi* (në këtë rast: ***zbulimi***) (20 mars 1985, f. 6 dhe f. 16); *Duke u nisur nga konkluzionet* (për: ***përfundimet***) *e Mbledhjes së 16–të; Kontribut* (për: ***ndihmesë***) *fitores ndaj fashizmit* (22 mars 1985, f. 1 dhe f. 4); *Bisedimet jugosllavo–algjeriane në nivel të kryetarëve të qeverive do t'i qasen para se gjithash shqyrtimit të marrëdhënieve bilaterale* (mund të mënjanohet me fjalën shqipe: ***dypalëshe***) *dhe bashkëpunimit sipas burimeve të njëjta, iniciativën* (mund të zëvendësohet me fjalën shqipe: ***nismë**, d.m.th.* ***nismën***) *e ka ndërmarrë; në vijim e sipër është sondazhi* (mund të zëvendësohet me fjalët shqipe: ***hetim, vëzhgim, anketë***, në këtë rast: ***vëzhgimi*** *i terrenit të Holandës, e cila* (duhet: i cili) *kah fundi i vitit...* (24 mars 1985, f. 2); *Lenini ishte dhe mbeti inspirator* (për: ***frymëzues***) *i klasës punëtore të popujve të Jugosllavisë dhe avangardës* (për: ***pararojës***) *së saj – PKJ–së; për progres* (për: ***përparim***) *dhe socializëm* (23 prill 1970, f. 3); *për aksion* (për: ***veprim***) *konkret* (13 janar 1985, f. 3); *qarqet diplomatike në Gjenevë janë tejet racionale* (mund të zëvendësohet me fjalën

[34] Nuk mungojnë edhe para vitit 1983.

shqipe: ***të arsyeshme***) *në matjen e mundësive* (06 janar 1985, f. 1); *Shtabet madhore kishin karakter* nacional (për: ***kombë–tar***) (11 shkurt 1977, f. 4) etj.

Mangësitë që bien në sy më shumë në fushën e sintaksës, janë:

– *përdorimi i panevojshëm i frazave të gjata e të ndërlikuara, ku pështjellohet mendimi deri në moskuptim*;

– *përshtatja e gabuara e fjalëve përcaktuese me emrat ma–shkullorë që e formojnë shumësin me* –e *dhe* –ra;

– *vërehet shumë ndikimi i sintaksës së huaj*, sidomos asaj slla–ve[35] (gjegjësisht, asaj serbe, kroate, sidomos asaj maqedonase) dhe *në drejtimin (reksionin) e foljeve në shkrimet e për–kthyera.* Shumë shkrime (artikuj) të rubrikave të ndryshme në "Flakën e vëllazërimit" janë autorë joshqiptarë (serb, kroat, slloven, maqedonas etj), andaj dominon sintaksa e këtyre gju–hëve në gazetë. Përkthyesit e shkrimeve të tilla, kanë bërë punë të nxituar dhe sigurisht nuk e kanë njohur mirë as gju–hën e huaj, as shqipen, si: *i kontribuon zhvillimit të arsimit (*duhet: *kontribuon për zhvillimin e arsimit); dy skuadra që rrezikojnë rënien nga kategoria (*duhet: *rrezikojnë të bien nga kategoria).* Ja disa shembuj të tjerë: *numri i* shikuesve *shumë ndeshje do t'i përcjellin* (krejt e paqartë, duhet: ***një numër (i madh a i vogël) i shikuesve shumë ndeshje do t'i përcjellin (ose: shumë shikues ndeshjet do t'i përcjellin)*** (09 shkurt 1977, f. 15), *U theksua edhe rëndësia e përparimit e mëtejmë* (duhet: ***rëndësia e përparimit të mëtejmë***); *të gjitha këto akti–vitete do të përcillen edhe me programe dhe me plane gje–*

---

[35] Burim kryesor i lajmeve ka qenë TANJUG–u, MIA.

*gjëse* *<u>në lëmën e bujqësisë,</u>* *veçanërisht* *<u>në përparimin e se–ktorit individual</u>* (duhet: *të gjitha këto aktivitete do të përcil–len me programe dhe me plane gjegjëse* ***të lëmit të bujqësisë, për përparimin e sektorit individual*** (11 shkurt 1977, f. 1); *Komisioni mbi çështjet e zgjedhjeve* (duhet: *Komisioni i çë–shtjeve të zgjedhjeve*) (11 shkurt 1977, f. 3, 4); *<u>në botim të "Nasha kniga"</u>* *të Shkupit* (duhet: *të botuara nga "Nasha kni–ga" e Shkupit*); *aktivitet të dukshëm kultural* (duhet: *kultu–ror*); *në botim të shtëpisë botuese "Svjetlost" të Sarajevës* (duhet: *të cilën e botoi SHB "Svjetlost" e Sarajevës*) (13 shkurt 1977, f. 14, 17) etj. Hasim edhe shprehjen *me në krye (një delegacion me në krye sekretarin F.F.)* në vend që të përdorin: *një delegacion ... me sekretarin F.F. në krye* (sepse në gjuhën shqipe parafjala nuk mund të ndahet nga fjala që lidh: *me ministrin*). Për dallim nga ndikimet e huaja në leksik e morfologji, ndikimet sintaksore rrallë mund të hetohen edhe nga gjuhëtaret e ç'mund të presim nga gazetarët e përkthyesit e papërgatitur të cilët as që mund t'i vërejnë. Po e jap një shembull të qartë ku sintaksa e huaj sjell edhe keqkuptime: *Një person i paidentifikuar u gjet i vrarë nga policia zvicerane me një plumb pas koke në një lulishte të Gjenevës;* në gjuhën shqipe shkon më mirë ndërtimi vepror: *Policia zvicerane gjeti një person të vrarë me një plumb ...*

*Përfundim:*

Në mbyllje të këtij punimi shkencor, e rrugës është që dhe një herë të vëmë në pah se, krahas mangësive të cilat i për–

mendëm, gazeta "Flaka e vëllazërimit" gjatë gjithë kohës sa është botuar, veçanërisht gjatë periudhës kohore 1970 – 1989, ishte jo vetëm shumë e nevojshme për kohën, e vetme gjatë këtyre viteve për shqiptarët në Maqedoni, (madje organ i vetëm në të cilin shumë intelektualë të njohur të këtyre trevave i bënë hapat e parë duke botuar shkrimet e tyre që u përkisnin fushave të ndryshme), por ishte edhe rrezatuese e gjuhës së përpunuar letrare shqipe (sot: shqipes standarde). Ajo ka ndikuar te lexuesit për të zotëruar[36] e zbatuar drejt normat e shqipes standarde në të gjitha nivelet e saj.

[36] Pas Kongresit të Drejtshkrimit s'kanë munguar rubrikat e veçanta për drejtshkrimin dhe drejtshqiptimin e shqipes të dala nga Kongresi i Drejtshkrimit të vitit 1972.

*Zeqirja Rexhepi*
*Ish–kryeredaktor i gazetës "Flaka"*

# GAZETA "FLAKA", MEDIUM NË TË CILIN BESOJA

Duke e ditur rëndësinë e botimit të gazetës "Flaka", si një medium me mjaft relevancë për problematikën informuese të shqiptarëve në Maqedoni, e cila tashmë kishte një traditë botimi prej disa dekadash, në vitin 2002 pranova që ta udhëheq këtë medium, i emëruar si kryeredaktor. Megjithëse, qëndrimi im në "Flakë" ishte një periudhë kohore 6 mujore, nga 13 maji – 3 dhjetori 2002, dëshira për ta parë gazetën ndryshe, për t'ia rikthyer imazhin e dikurshëm, më shtyri që ta pranoja detyrën e kryeredaktorit, edhe pse duhej një punë sizifiane për ta arritur sadopak këtë.

Gazeta "Flaka", veçmas pas vitit 2000, e kishte marrë teposhtëzën dhe duhej mjaft punë dhe mbështetje për ta rikthyer imazhin e saj. Shumë miq e intelektualë veç më e konsideronin "Flakën" si medium në shkatërrim e sipër, ndërkaq unë edhe më tej sikur doja të besoja në një lloj renesanse për të, duke planifikuar menaxhim më racional, riorganizim të brendshëm, pajisje me mjete më bashkëkohore, natyrisht gjithmonë duke besuar edhe në potencialin kadrovik që i kishte mbetur besnik "Flakës".

Më duhet të theksoj se "Flaka" ishte mediumi "simbol" i shqiptarëve të Maqedonisë, me revistën "Jehona" dhe dy re–

vistat për fëmijë "Gëzimi" dhe "Fatosi", të cilat plotësonin një hapësirë të gjerë lexuesish të të gjitha moshave. Pra, "Flaka" ishte e dëshirueshme, pritej me padurim dhe lexohej mjaft, duke e përmbushur kështu zbrazëtirën e madhe të mungesës së mediumeve në gjuhën shqipe. Ndonëse, kishte filluar të botohej që nga 4 prill 1945, ajo në vitet e '70 dhe '80 u bë simbol i fjalës së shkruar shqipe. Nganjëherë, në kohë të tra–zuara, historia e saj bëhej po aq e dhimbshme sa vetë historia e popullit shqiptar. Gjatë disa dekadash botim, kjo gazetë ka përjetuar ngritje–rëniet e saj, ngjashëm si fati i popullit shqip–tar, duke u censuruar shpesh fjala dhe mendimi i lirë. Mirëpo, përderisa populli shqiptar mbijetoi edhe në periudhën e de–mokracisë parlamentare, "Flaka" nuk arriti ta mbijetojë sfidën e demokracisë.

*Si e gjeta Flakën?*

Ishte viti 2002, pra kohë akoma e brishtë pas Konfliktit të 2001–it në Republikën e Maqedonisë. Atëbotë, vendi kishte hyrë në një etapë të re historike, pra ishte firmosur Marrëve–shja Kornizë e Ohrit dhe e njëjta ishte inkorporuar në Ku–shtetutë. Elita e re politike që do të dilte nga zgjedhjet e vitit 2002 do të duhej të implementonte Marrëveshjen Kornizë të Ohrit. Mund të paramendohet se çfar përgjegjësie dhe roli mund të luajnë mediumet në rrethana të këtilla. Me fjalë të tjera do të duhej që edhe "Flaka", si një nga mediumet që financohej nga buxheti i shtetit, të jepte kontributin e saj. Për

të realizuar me sukses veprimtarinë e saj informative, "Flaka" do të duhej të jepte përtej vetes...
Me pranimin e detyrës së kryeredaktorit, "Flakën" e gjeta në gjendje të mjerueshme:
Në aspektin material, dominonte gjendje alarmante. Të pu–nësuarit në redaksinë e "Flakës", përpos aktiviteteve rutinore të ditës nuk tregonin ndonjë interes të veçantë për shkrime cilësore apo përcjellje të informatave hulumtuese deri te le–xuesi, të cilat do të mund ta rrisnin interesimin informues nga ky medium. Kjo gjendje ishte rrjedhojë e pagave shumë të ulta, gjë që sikur nuk mjaftonte, por edhe ato jepeshin me vonesë prej 5 – 6 muash;
Në aspektin teknik, natyrisht si pasojë e një sërë pengesash "Flaka" kishte mbetur shumë prapa risive teknologjike që i shfrytëzonin mediumet tjera informative. Rrjeti kompjuterik ishte tejet i vjetër, jo praktik dhe pothuajse i papërdorshëm;
Në aspektin organizativ – profesional, "Flaka" me stafin e gazetarëve që disponnamed mund të mbulonte një hapësirë shumë të vogël, andaj pjesën tjetër duhej ta mbulonte përmes korrespondentëve dhe Agjencive Informative të ndryshme. Në kushte të sistemit të ekonomisë së tregut, gazeta nuk mund ta përballonte as njërën, as tjetrën, pra as mundej t'i paguante korrespondentët dhe as të lidhte kontrata me A–gjencitë Informative për marrjen e lajmeve burimore jashtë Maqedonisë.
Në aspektin financiar "Flaka" gjithnjë ishte e "lidhur" me ndërmarrjen e përbashkët "Nova Makedonija", pra e përdi–

tshmja në gjuhën shqipe nuk posedonte xhirollogari të veç–antë, prej nga do të mund ta planifikonte ngritjen e saj, që nënkuptonte se ndodhej në varësi totale. Përpjekjet për më–vetësimin e "Flakës" gjithnjë kishin përfunduar pa sukses!?
Redaksia e "Flakës", në saje të të cilës botoheshin edhe revista kulturoro–letrare "Jehona" dhe revistat për fëmijë "Gëzimi" dhe "Fatosi", sikurse sektori për botim mbështetej në një nu–mër të vogël të punësuarish.
Stafi i redaksisë, në periudhën e lartpërmendur, ishte si vijon:

| **Stafi drejtues i redaksisë** | | |
|---|---|---|
| 1 | Zeqirja Rexhepi | Kryeredaktor |
| 2 | Halil Zendeli | Zëvendëskryeredaktor dhe redaktor i revistës "Jehona" |
| 3 | Abdurahman Kurtishi | Sekretar i redaksisë |
| 4 | Filiz Ndoci | Sekretare e redaksisë |
| 5 | Ramadan Beqiri | Redaktor i politikës |
| 6 | Saubi Demiri | Ndihmës redaktor i politikës |
| 7 | Haki Selimi | Redaktor i deskut |
| 8 | Shaip Emërllahu | Redaktor i kulturës |
| 9 | Abdylhadi Zylfiqari | Redaktor i fejtonit |
| 10 | Arben Ajdini | Redaktor i sportit |
| 11 | Hajri Shaqiri | Redaktor i revistës "Fatosi" |
| 12 | Resul Shabani | Redaktor i botimeve |
| 13 | Islam Saliu | Redaktor i revistës "Gëzimi" |
| 14 | Xhemail Fuga | Kontabilist |

| | | |
|---|---|---|
| | **Stafi teknik i redaksisë** | |
| 15 | Bekim Ndoci | Fotoreporter |
| 16 | Adrijan Gavazi | Teknik |
| 17 | Mustafa Gavazi | Teknik |
| 18 | Eroll Ramadani | Teknik |
| 19 | Aziz Etemi | Korrektor |
| 20 | Lumnije Hajdari | Lektor – përkthyes |
| 21 | Arlinda Beqiri | Lektor – përkthyes |
| 22 | Florije Haskaj | Lektor – përkthyes |
| 23 | Sabedin Bushi | Daktilograf |
| 24 | Zimijeta Curri | Daktilografe |
| 25 | Nevreze Saliu | Daktilografe |
| 26 | Shpresa Osmani | Daktilografe |
| 27 | Gjylten Islami | Daktilografe |
| 28 | Barije Berisha | Korrektore |
| | **Stafi i gazetarëve të redaksisë** | |
| 29 | Daut Dauti | |
| 30 | Selvije Qoku | |
| 31 | Naxhije Kryeziu | |
| 32 | Semia Saliu | |
| 33 | Lumturije Zajazi | |
| 34 | Qerim Bajrami | |
| 35 | Safet Ademi | |
| 36 | Ahmet Selmani | |
| 37 | Luljeta Jusufi | |
| 38 | Fisnik Pasholli | |
| 39 | Arben Ibrahimi | |

| Gazetarë të angazhuar në qytete të ndryshme | | |
|---|---|---|
| 40 | Agron Misimi | Tetovë |
| 41 | Artan Asllani | Tetovë |
| 42 | Ekrem Ajruli | Tetovë |
| 43 | Memet Selmani | Tetovë |
| 44 | Enver Shala | Tetovë |
| 45 | Selajdin Shabani | Kumanovë |
| 46 | Ismail Asllani | Tetovë |
| 47 | Baki Ymeri | Rumani |
| 48 | Mixhait Pollozhani | Strugë |
| 49 | Halit Nasufi | ?[37] |
| 50 | Nefail Spahiu | ? |
| 51 | Qenan Hasani | Manastir |
| 52 | Elmir Sejfullai | Tetovë |

Gjithashtu, për të qenë korrekt me opinionin, më duhet të theksoj se me angazhime të jashtëzakonshme të pjesës dër–muese të të punësuarve, "Flaka" bëri përpjekje për rikthimin e imazhit, si një e përditshme më e vjetër dhe me traditë, në gjuhën shqipe. U ndërmorën hapa konkretë në riorganizimin e Redaksisë në rrethana ekzistuese dhe përmirësimin e mjete–ve teknike të nevojshme për veprimtarinë e përditshme. Për–pjekjet që bënte "Flaka" i dhanë rezultatet e para, të cilat u dukën me rritjen e tirazhit.

[37] *Sqarim*: Gazetarët, respektivisht korrespodentët e lënë me pikëpyetje, në pasqyrën tabelare, nuk arrita asnjëherë që t'i takoja, madje asnjë shkrim i tyre nuk arriti në redaksi gjatë periudhës së lartpërmendur gjashtëmujore.

Se si ka lëvizur tirazhi i "Flakës" gjatë vitit 2002,[38] mund të shihet nga tabela e mëposhtme, duke filluar nga janar – shtator, 2002[39]:

| | TIRAZHI I PËRGJITHSHËM SIPAS MUAJVE | | | | Tirazhi mesatar ditor | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Muaji | Shtypur | Shitje | Remitenda | % | Shtypur | Shitje |
| 1 | 30.831 | 17.220 | 13.611 | 44.15 | 1.401 | 783 |
| 2 | 33.935 | 18.009 | 15.926 | 46.93 | 1.414 | 750 |
| 3 | 36.303 | 20.539 | 15.764 | 43.42 | 1.396 | 790 |
| 4 | 37.949 | 20.988 | 16.961 | 44.69 | 1.518 | 840 |
| 5 | 30.996 | 16.860 | 14.136 | 45.61 | 1.348 | 733 |
| 6 | 35.606 | 22.496 | 13.110 | 36.82 | 1.424 | 900 |
| 7 | 53.876 | 37.255 | 16.621 | 30.85 | 1.995 | 1.380 |
| 8 | 54.668 | 40.467 | 14.201 | 25.98 | 2.187 | 1.619 |
| 9 | 55.317 | 39.917 | 15.400 | 27.84 | 2.305 | 1.663 |
| 10 | – | – | – | – | – | – |
| 11 | – | – | – | – | – | – |
| 12 | – | – | – | – | – | – |

Nga të dhënat, në tabelën e mësipërme, mund të vërehet se të përditshmen më të vjetër në gjuhën shqipe, gazetën "Flaka", në pesë muajt e parë të vitit 2002 e merrnin vetëm midis 783–733. Ndërkaq, në katër muajt vijues, tirazhi shitës u dyfishua, nga 900 gazeta në qershor për t'u rritur në 1.663 në muajin shtator. Pra, "Flaka" vërtet e përjetonte renesansën e saj për një kohë tejet të shkurtër, me çka jepte shpresë se, jo

[38] Të dhënat në tabelën e mësipërme e përfshijnë periudhën janar–shtator të v. 2002. Këto të dhëna janë marrë nga shërbimi i Ndërmarrjes "Nova Makedonija".
[39] Të dhënat për tre muajt e fundit kanë mundur të jepen më vonë.

vetëm që do të mbijetojë, por do të mund të konkurojë me mediumet tjera të shkruara.

Mirëpo, për epilogun dhe fatin e mbrapshtë të “Flakës” opi–nioni është i njohur...

*DAUT DAUTI*
*Ish–kryeredaktor i gazetës "Flaka"*

# NJË BETEJË MADHORE E FITUAR NË MONIZËM DHE DËSHTIMI NË PLURALIZËM

*(Thekse të shkurtëra nga ky tekst u thanë në diskutimin e lirë në tribunën kushtuar 70–vjetorit të "Flakës së vëllazërimit")*

Përshëndetje të gjithë pjesëmarrësve dhe mysafirëve, iniciatorëve për organizimin e kësaj tribune, dhe ish gazetarëve dhe të punësuarve të gazetës sonë të parë të përditshme në gjuhën shqipe në Maqedoni...

Nuk e di nga t'ia filloj dhe cilin aspekt ta kapë në këtë diskutim. Këtu iu nda mirënjohje postmortum njërit nga themeluesit të "Flakës së vëllazërimit", Prof. Dr. Petro Janurës, dhe sipas kësaj analogjie, unë do ta "meritoja" një mirënjohje për mbylljen e "Flakës", sepse unë isha kryeredaktori i saj i parë dhe i fundit pas privatizimit, kur për fat të keq, pronarët e rinj, stafi menaxhues si dhe subjekti politik që supozohej se i qëndronte prapa, nuk arritën të sigurojnë ekzistencën e "Flakës" në kushte të pastra tregu, edhe pse, pikërisht në atë periudhë, pra, maj–nëntor 2004, "Flaka" shënoi ngritje të lakmueshme si në cilësi, ashtu dhe në tirazh.

Nëse kjo fjalë e imja do të kishte ndonjë titull, ai do të kishte qenë i lidhur për rrethanat e reja shoqërore e politike, me

theks të veçantë në ato të ligjeve të tregut, prej nga "Flaka" doli si viktimë e mosgjeturisë për t'u rreshtuar në to. Por para se të them diç më tepër për ato rrethana, mendoj se për opi–nionit të gjerë publik ka nevojë t'i kthehemi një situate të ndërlikuar, por me peshë të madhe historike, që si meritë dhe vlerë, padyshim, i përshkruhet redaksisë së gazetës "Flaka e vëllazërimit", për çka ka nevojë të elaborohet më gjerësisht. E kam fjalë për rezistencën e madhe të redaksisë së "Flakës..." ndaj imponimit të toponimeve jo shqipe në gazetë dhe boti–met tjera të saj në vitet 80–të të shekullit të kaluar.

*BETEJA PËR TOPONIMET*

Kushdo që do të përmendte periudhën e viteve 80–të, asaj periudhe pas demonstratave studentore e gjithpopullore në Kosovë në pranverë të vitit 1981, një nga më të vështirat për shqiptarët në Jugosllavinë që rezultoi me shumë turbulenca pas vdekjes së udhëheqësit të saj të pakontestueshëm, Titos, kur hegjemonizmi serb mori krah dhe ushtroi ndikim të madh jo vetëm në Serbi dhe krahinën "e saj", Kosovën, por, që reflektoi për të keq edhe në republikat tjera ku jetonin shqip–tarë, sidomos në Maqedoni. Në ato vite, u zhvillua fushata e pakompromis kundër "nacionalizmit, irredentizmit dhe sepa–ratizmit shqiptar", që kërkohej në çdo subjekt, në çdo forum, prej shkollave e fakulteteve, e gjer te njësitë punuese. Në atë betejë që dirigjohej nga KQ i LKJ–së, e që operacionalizohej në nivelet më poshtë, në KQ–të e republikave dhe krahinave, e gjer te komitet komunale dhe ato të organizatave punuese,

por dhe në organet ekzekutive. Është paradoksale të konsta–tohet, por, një nga republikat më të zellshme që e zhvillonte këtë fushatë antishqiptare, ishte pikërisht RS e Maqedonisë, ku bile shkohej ndonjë hap më tutje se sa vetë komunistët serbë (ndoshta tutorët e tyre të Beogradit ua luanin "syrin" që të zbatonin ndonjë politikë më specifike, ndoshta dhe si e–ksperiment që do të shërbente për moduse tjera veprimi!), prandaj këtu kemi pasur veprime që ndoshta as që janë disku–tuar në Beograd. Vetëm të kujtojmë se në Maqedoni aso ko–he, u kufizua e drejta e lindjes, u ndaluan rrethojat e shtëpive dhe oborreve, u ndaluan toponimet në media dhe libra shkollorë, ndërkaq "gjuajtja e shtrigave" i përfshiu si kudo tjetër, ata që ishin "më të gjallë" në pikëpamje intelektuale, kush duke fituar burgun, e kush duke u diferencuar e mbetur pa punë.

Në shënjestër të këtillë u gjet edhe redaksia e gazetës "Flaka e vëllazërimit", prej së cilës kërkohej të jetë në ballë të luftës kundër dukurive nacionaliste në radhët e shqiptarëve, por dhe në radhët e veta. Se nuk ka qenë lehtë fushëveprimi i gazetës, këtë e determinon të qenit "organ i Lidhjes Socialiste të Po–pullit Punues të Maqedonisë", dhe këtë e dëshmojnë edhe faqet e saj kur s'kish mundur të ikë nga roli që ia kishte dhënë shoqëria nga themelimi i saj. Lufta kundër dukurive negative, kuptohet është një mision i çdo gazete e medie tjetër, por kur kjo kërkohet nga Partia, e cila në monizëm si dukuri negative ka apostrofuar edhe ato që nuk kanë qenë të tilla, atëherë "detyra shtëpiake" bëhet shumë e vështirë, aq më tepër kur

bërthamën e gazetës e kanë përbërë ajka intelektuale shqiptare që nuk është pajtuar me direktivat, përkundër kompromiseve dhe përkuljes së kohëpaskohshme. Nuk ka mundur të ikë nga këto beteja, e viteve 80–të, as nga turbulencat e brendshme, si rezultat e kompromiseve "të domosdoshme". Mirëpo, "Fla–ka", e vrojtuar vazhdimisht nga "sytë kujdestarë" të Partisë dhe të shërbimeve sekrete të kohës, ka ditur dhe të rezistojë dhe të fitojë ndonjë betejë jo të vogël. Në këtë drejtim, nga treshja mediave të asaj kohe, "Flakës së vëllazërimit", Radio Shkupit dhe Televizionit të Shkupit, vetëm, "Flaka..." arriti ta fitojë betejën kundër imponimit të dhunshëm të toponimeve jo shqipe.

Shumëkush, si atëherë, ashtu dhe sot, shpreh habinë si arriti një fitore kaq të madhe kundrejt fushatës së egër ideologjike. Gjurmët dhe përgjigjet se si u ruajt toponimia shqipe në ga–zetë dhe botimet tjera të saj, mund të gjenden edhe në doku–mentet e ruajtura në Arkivin e Maqedonisë. Është e pabesue–shme, por "Flaka" ia doli në një situatë të fushatës së vrazhdë që zhvillohej në emër të luftës kundër nacionalizmit dhe se–paratizmit shqiptar, ku në shënjestër ishin institucionet dhe intelektualët shqiptarë. Çështja e imponimit të toponimisë në kundërshtim me normat linguistike të gjuhës shqipe, në këtë kontekst edhe të asaj turke, ka një histori të gjatë dhe ka të bëjë me Konkluzionet e KQ të LKJ–së dhe Programin ope–rativ të KQ të LKM–së, për të luftuar dukuritë e nacionali–zmit dhe separatizmit shqiptar, që më vonë do të operaciona–lizohen në Konkluzat e Kuvendit të RSM–së (1984). Megji–

thëse nuk kam pasur në dorë këto konkluzione, vë në dyshim ekzistimin e ndonjë pike konkrete që i përket përdorimit të toponimeve, mirëpo nga korpusi i gjerë i veprimeve, problemi i toponimeve do të shpiket nga Komiteti Republikan i Arsimit dhe i Kulturës Fizike, që ua imponoi shkollave dhe mjeteve të informimit publik si dhe në librat shkollorë e më vonë me vendim, urdhër apo ngjashëm. Toponimia jo shqipe kishte depërtuar në librat shkollorë dhe në programet e radiove dhe TV Shkupit të atëhershëm (për të mos zbatuar toponimet në variantin e maqedonishtes, kryeredaktori i atëhershëm në TV Shkup– Redaksia në gjuhën shqipe, Menduh Ajdini, kishte dhënë dorëheqje, dhe ai që do ta zbatojë atë vendim do të jetë Hisen Shaqiri, ndërkaq në Radio Shkup, Muhamer Vishko), mirëpo, për habinë e bartësve të fushatës antishqiptare, në "Flakë..." kjo nuk ndodhi, falë këmbëngulësisë së udhëheqësisë së atëhershme të redaksisë së "Flakës së vëllazërimit", e sidomos të kryeredaktorit Rexhep Zllatku, që kjo çështje të zgjidhet duke u bazuar në argumentet shkencore. Në një dokument që mund të gjendet në dosjen e kryeredaktorit të atëhershëm, Rexhep Zllatku, nga diskutimi në një mbledhje të KK të LKM–së të Tetovës, është shënuar: "...në këtë shtëpi (botuse–vër.e aut.) poashtu botohen edhe revista për fëmijë në gjuhën shqipe të cilat shpërndahen nëpër shkolla, ku ende nuk mund të hasen fjalët Skopje, Bitola, Kiçevo, Debar, etj. Nxënësit ballafaqohen me një dualizëm, kështu psh. thuhet BITOLATEK nga Manastiri në vend se nga Bitolla, Skopjanka nga Shkupi, etj." Kjo mënyrë e të menduarit,

është pjesë e një "argumentimi" tipik nga debatet e asaj fushate të rreptë, dhe fare i parëndësishëm është emri i diskutantit, në këtë rast, Rashid Abazovskit, por që në vazhdim po nga goja e njëjtë mund të citohet edhe ky vlerësim karakteristik për mënyrën se si trajtohej problemi i toponimisë: "Komunistët dhe kryeredaktori në këtë shtëpi nuk veprojnë sipas ligjit, heshtazi nuk kanë zbatuar asnjë konkluzë për diferencim ideopolitik të të punësuarve. Akoma paraqet burim indoktrinomi, ndërkaq shoqëria jonë investon miliarda dinarë në këtë shtëpi" (Arkivi i Maqedonisë, dosja nr. 22689, kutia arkivore 685/9, por që nuk mban datë). Të njëjtat qëndrime, në cilësinë e delegatit, ky person i ka theksuar edhe më 31.03.1987 në Dhomën e Komunave të Kuvendit të RS të Maqedonisë. (sipas dokumentit që mban datën 9.04.1987, në të njëjtën dosje).

Siç mund të vërehet, përdoret formulimi nuk veprohet "sipas ligjit". Në rastin e toponimeve, konkluzionet e forumeve partiake trajtohen si imperativ ligjor, gjë që në rastin konkret megjithatë, nuk mund ta kishin, qoftë dhe të bëhet fjalë për regjim komunist. Sepse, ligji për ndryshim të toponimeve në tekstet në gjuhët jo maqedonase nuk u soll asnjëherë dhe mbeti vetëm "në tentativë", i humbur në korridoret kuvendore dhe i shkelur nga koha e pluralizmit që do të vijë pas disa vjetësh. Por, ky fakt, nuk ka qenë pengesë që dikush të thirret "në obligimin për të zbatuar ligjin", sepse në atë zhurmëri beteje ideologjike kundër "nacionalizmit shqiptar", ka qenë e parëndësishme nëse ka ose jo ligj! Mirëpo, në anën tjetër,

mungesa e ligjit ka qenë ai argument i fortë për redaksinë e "Flakës së vëllazërimit", që të këmbëngulë për të mbrojtur toponiminë "gjersa kjo materie të mos rregullohet me ligj".
Është poashtu për t'u veçuar që një qëndrim i tillë atëherë është përkrahur edhe nga udhëheqësia e NGB "Nova Make–donija", më saktë nga drejtori i përgjithshëm. Kështu, në një dokument të Shërbimit të Sigurimit Shtetëror të atëhershëm, shihet se si drejtori i NGB "Nova Makedonija", Rade O–gnjanovski, flet se rreth kësaj çështjeje ka pasur shumë konta–kte me shumë udhëheqës partiakë dhe të forumeve të ndryshme si dhe për përpjekjet që kjo çështje të diskutohet në Komisionin për Marrëdhënie Ndëretnike në KR të LSPPM–së në bazë të një materiali të shkruar, por i cili, "për shkak të lëshimit teknik" ende nuk është vënë në rend dite për disku–tim. Por ajo që është me rëndësi të veçohet, është se në mbledhje (pra, të Komisionit për Marrëdhënie Ndërnaciona–le), është rënë dakord për "përdorimin e mëtutjeshëm të to–ponimeve" (pra, në formën e pandryshuar), por "të bëhen konsultime me institucione shkencore–hulumtuese" për të marrë "qëndrim definitiv". Mirëpo, është interesante se Rade Ognjanovski e vë në dukje rolin që ka pasur aso kohe Nijazi Limanovski, ndihmëskryetar i Komitetit Republikan të Arsi–mit, kur e kritikon për vlerësimet tejet negative ndaj redaksisë së "Flakës së vëllazërimit" dhe kryeredaktorit të saj: "Disku–timi i këtillë i Limanovskit, lë hapësirë për komente të cilat mund të jenë të dëmshme dhe ta destabilizojnë redaksinë "Flaka e vëllazërimit". Personalisht mendoj se Limanovski jep

vlerësime paushalle dhe tendencioze i shtyrë nga motive lide–riste, të cilat janë të kontraproduktive dhe mund ta dëmtojnë politikën energjike ndaj nacionalizmit dhe separatizmit shqip–tar". (Dokumenti mban datën 08.04.1987, po nga e njëjta dosje).

Interes për "mosunifikimin e toponimeve" (siç ishte formuli–mi zyrtar), nuk kanë pasur vetëm forumet partiake, por dhe vetë Shërbimi i Sigurimit të Brendshëm, dhe kjo në rastin e "Flakës..." ka qenë "detyrë shtëpiake". Se pse në botimet e "Flakës..." nuk ka filluar zbatimi i toponimeve në gjuhën maqedonase, kryeredaktori i "Flakës...", Rexhep Zllatku, mbron qëndrimin se nuk është marrë një hap i tillë "nga shkaku se çështja nuk është shqyrtuar nga ana e institucioneve përkatëse shkencore ose organeve shoqërore të republikës, se nuk ka përgjigje unike për të gjitha subjektet, porse zgjidhja u është lënë individualisht të veprojnë faktorë të ndryshëm". Në këtë bisedë informative, për të forcuar qëndrimin e "Fla–kës...", kryeredaktori jep edhe sqarime linguistike për specifi–kat gjuhësore të shqipes dhe gjuhëve në përgjithësi. Ndërkaq sa i përket Nijazi Limanovskit, Rexhep Zllatku nuk heziton që atë ta quajë diletant sa i përket kësaj fushe (të gjuhësisë). Mirëpo, qëndrimet e këtilla nuk merren me dashamirësi nga shërbimi dhe kjo shihet në komentin që ka dhënë punëtori operativ: "Mungesa e qëndrimit konstruktiv në sqarimin e thelbit të kësaj çështjeje, mendoj se është akt i qëllimshëm, me qëllim që aktiviteti i ndërmarrë dhe përpjekja për të tej–kaluar jo unifikimi në përdorimin e toponimeve, të paraqitet

si e pabazë, gjegjësisht si gjoja akt ndaj të drejtave kushtetuese të shqiptarëve". (Dokumenti mban datën 9.04.1987, po nga e njëjta dosje).

Ndërkaq kur është hapur debati i vërtetë në forume, përveç zërit të "Flakës...", është dëgjuar edhe zëri i shumë përfaqë–suesve të tjerë që kanë folur në emër të shkencës. Beteja kryesore, me gjasë, është fituar më 21 prill 1987, në Komi–sionin për Marrëdhënie Ndërnacionale të Kuvendit të RSM–së, ku ligji që nuk ka ekzistuar më parë për ta rregulluar çë–shtjen e përdorimit (unifikimit) të toponimeve sipas variantit në gjuhën maqedonase, ishte vënë në diskutim. Propozimi për nxjerrjen e Ligjit të Emrave të Vendbanimeve, më në fund nuk vinte nga organet partiake, por nga vetë qeveria e atë–hershme, pra, ishte propozuar nga Këshilli Ekzekutiv i RSM–së, mirëpo, ai duhej të merrte së pari mendimin nga punëtorët shkencorë dhe përfaqësues të medias dhe të kombësive. Duket paradoksale, por është fakt se edhe në aso atmosfere që ishte krijuar, shkenca arriti ta mposhtë diktatin politik, falë argu–menteve të veta kundrejt floskulave bosh të disa bajraktarëve të urrejtjes siç ishte i përmenduri Nijazi Limanovski. (Historia e këtij antishqiptari paraqet një rrëfim në vete, dhe paraqet një fenomen të çuditshëm të asaj kohe, dhe në rastin e tij ngër–thehen sa diktati politik që ai mund të zbatonte, sa profili so–ciopsikologjik, i mbarsur me një urrejtje të çuditshme patolo–gjike që ai e shprehte në çdo forum kundër shqiptarëve. Si një dëshmitar i asaj kohe, mund të them se veprimi i tij duket të ketë qenë pjesë e një strategjie: ka gëzuar mbështetje institu–

cionale, por shpesh dhe i lënë si një gjuetar i lirë shtrigash. Nëse ndikimi i përfaqësuesve shqiptarë do të kishin ngritur zërin më fortë, atëherë Nijazi Limanovski do të mbetej pa mbështetjen e duhur dhe jo rastësisht janë toleruar kritika ndaj tij nëse ka ardhur nga ndonjë zë i fortë, siç dhe shihet në këto shembuj që i sjell në këtë tekst). Ndoshta dhe këtu është shkaku i dështimit përfundimtar të tij kundrejt "Flakës...", që në momentet vendimtare ta lënë si individ! Në stenogramet e Kuvendit dhe në shtypin e asaj kohe ka zënë shumë vend kjo mbledhje e Komisionit për Marrëdhënie Ndërnacionale, sepse në të u nxorën argumente shkencore të papritura jo vetëm nga profesorë e gazetarë shqiptarë, por dhe nga vetë linguistë maqedonas, por dhe intelektualë e politikanë turq, që arritën të ndërrojnë një nen të rëndësishëm të propozimit të ligjit, i cili më vonë asnjëherë nuk do të sillet! Duke mos pasur mundësi për një hulumtim më të gjithanshëm rreth asaj mbledhjeje, në këtë rast përsëri do t'i referohem një dokumenti nga dosja e Rexhep Zllatkut (i cili, për shkak të këmbënguljes në ruajtjen e frymës dhe formës shqipe të toponimisë ka qenë edhe i përgjuar), ku gjithë debati trajtohet si një akt me paramendim që i ka shkuar përshtati nacionalizmit shqiptar! Në këtë dokument (që mban datën 22.04.1987), thuhet se në mbledhje ishin ftuar anëtarë të katedrave të gjuhës shqipe dhe asaj turke, gazetarë të redaksive në gjuhën shqipe dhe turke të Radios dhe Televizionit të Shkupit, "Flakës së vëllazërimit", "Birilkut" (gazetë në gjuhën turke) dhe gazetarë maqedonas të Radios dhe TV Shkupit dhe një gaze–

tar i “Osllobogjenjes”(!). Këtu, veçanërisht i jepet rëndësi folësit të parë në debat, prof. Xhevat Gegës, i cili kishte kërkuar që kjo çështje “të zgjidhet në nivel federativ, sepse RS e Maqedonisë nuk mund ta zgjidhë vetë”, porse poashtu diskutime të argumentuara kishin pasur edhe kryeredaktori i “Flakës”, Rexhep Zllatku, prof. Haki Imeri, gazetari i TV Shkupit, Nijazi Muhamedi, drejtori i NGB “Nova Makedonija” (për të cilin thuhet se ka qenë me qëndrim që në shtëpinë e tij botuese gjendja të mbetet siç ka qenë). Përkrahje përdorimit të lirë të toponimeve në frymën e çdo gjuhe, i ka dhënë edhe kryetari i këtij komisioni, Emin Salih (i kombësisë turke), sipas të cilit duhet që “kjo materie të rregullohet me ligj, por të mos ketë implikime politike”. Po në këtë frymë ka diskutuar edhe Arif Ago. Sipas këtij dokumenti, të bazuar në informatat e një bashkëpunëtori të sigurimit shtetëror (pseudonimin “Lim”) e që ka qenë i pranishëm në mbledhje, “rol vendimtar” në formulimin e konkluzioneve ka pasur profesori i pensionuar, Trajko Stamatovski për të cilin mendon se në këtë mbledhje, me qëllim të caktuar, e ka ftuar kryetari i Kuvendit, Vullnet Starova. Me insistimin e Stamatovski, është ndërmarr alineja 2 e nenit 10 të tekstit ligjor ku në vend të formulimit “harmonizimit fonetik”, është propozuar “harmonizim fonetik dhe morfologjik” të toponimisë sipas gjuhëve përkatëse. Duhet thënë se në mbështetje të argumenteve shkencore ka qenë edhe profesori i njohur maqedonas Evgenij Dimitrov.

Kjo ngjarje është vetëm 2–3 vjet para rënies së komunizmit. Ishte periudhë e vështirë e ekspansionit të hegjemonizmit serb pas paraqitjes së Sllobodan Millosheviqit në skenën politike kur kishte shumë servilizëm nga ana e udhëheqësisë partiake të Maqedonisë, por dhe kohë kur tashmë më me guxim debatohej, prandaj dhe çështja e toponimeve, falë rezistencës së "Flakës..." çoi deri te një debat produktiv, ku politika e diktatit humbi betejën me shkencën. Ligji që ishte propozuar me gjasë nuk u soll asnjëherë, mirëpo, redaksitë tjera në gjuhën shqipe duhej të prisnin edhe ndonjë vit që t'i kthenin toponimet në gjuhën shqipe, ndërkaq në librat shkollorë që i botonte "Prosvetno dello", toponimet në trajtën gjuhësore të maqedonishtes në librat shkollorë në shqip, kanë vazhduar edhe më vonë në vitet e pluralizmit! Kushedi a do të kishte pasur atmosferë politike për ta ndërruar edhe në pluralizëm, po të ishte sjellë ligji siç ishte propozuar më 1987–tën. Prandaj, rëndësia e rezistencës së "Flakës..." është e një karakteri largpamës, me fjalë tjera, vizionar.

Që të mos e zgjas më shumë për këtë çështje, meqë nuk flasim për një "Flakë" që del edhe sot, pasi ajo është shuar, por për historinë e saj, çështja e toponimeve është ndër ato procese ku ka qenë e përfshirë dhe ka dalë faqebardhë, në një periudhë tepër të ndërlikuar të fushatës së egër antishqiptare, në një kohë dhe moment politik kur ka qenë tepër e vështirë të mbrohesh nga diferencimet ideopolitike, të cilat frynin fortë nga Beogradi serb, e provoheshin së pari nga komunistët servilë të Maqedonisë.

*BETEJA E HUMBUR NË KUSHTET E PLURALIZMIT!*

Por, t'i kthehemi çështjes tjetër të karakterit historik, ajo e shuarjes së "Flakës". Si ndodhi që në rrethana të reja, ato të pluralizmit politik, pa presionet e vazhdueshme të kohës së monizmit, kur madje arriti të bëhet gazetë e përditshme, "Flaka" të shuhet me të gjitha botimet e veta, revistat për fëmijë "Gëzimi" dhe "Fatosi" dhe revistën letrare shkencore, "Jehona".

Nëse ka ndonjë rast të ngjashëm në hapësirën mediale shqip–tare në Ballkan, atëherë fati i keq i "Flakës" është i ngjashhëm me atë të gazetës "Rilindja" të Prishtinës. Që të dyja këto gazeta pothuajse kanë lindur njëkohësisht, janë zhvilluar para–lelisht, me rol, mision, status, por dhe strukturë organizative të ngjashme, sepse përveç gazetës, në gjiun e tyre kanë pasë edicionin botues, revista për fëmijë, revista letrare në kohën e ish–sistemit dhe rregullimit shoqëror. Ngjashmëria e tyre pa–staj, duke e kërcyer këtu vetëm fazën që "Rilindja" pati pas vitit 1989 kur u vu nën masa të dhunshme, lidhet me plurali–zmin dhe ekonominë e tregut, ku u paraqit fenomeni i daljes së shumë gazetave e magazineve e botimeve të tjera, radiove e televizioneve private, disa prej të cilave mund të merren si raste suksesi, ndërkaq dy gazetat më të vjetra, "Rilindja" dhe "Flaka", nuk arritën të mbijetojnë, duke rënë viktimë e ç'orientimit të përgjithshëm të këtyre organizmave mediatikë, interesave e ambicieve idealiste dhe rrethanave të pafavor–shme, kur më lehtë ishte të nxirrje një gazetë të re me një staf e kuadër mobil, se të ruaje gjithë ata të punësuar. Një gazetë e

re shumë më lehtë do të vinte te fondet që u hapën nga shumë burime ndërkombëtare, sepse gazetat si "Flaka" e "Rilindja", ishin "e të gjithëve" dhe "e askujt".

Të përqëndrohemi pra te "Flaka", si pjesë e grupacionit mediatik të quajtur NGB "Nova Makedonija", e cila me demokratizimin e shoqërisë në fillim të viteve 90–të, në kushtet e pluralizmit politik, u gjet në një "ofsajd", të shprehem kështu me zhargonin sportiv, sepse erdhi deri te një rirreshtim ku gazetat e humbën ombrellën e tyre, Lidhjen Socialiste të Popullit Punues të Maqedonisë, organ të së cilës ishin me dekada, e me këtë edhe sigurinë financiare që buronte nga ky status. Megjithëkëtë, përderisa nuk kishte një koncept të qartë të transformimit, botimet e ndërmarrjes "Nova Makedonija" vazhduan të kenë një monopol duke u përkrahur nga Qeveria 7–8 vitet e ardhshme derisa nuk u paraqitën gazetat private, gjersa nuk filloi transformimi i tyre në shoqëri aksionare. Para fillimit të transformimit, gjegjësisht privatizimit, pati një bredhje "pa kompas" dhe humbje kohe të çmueshme për mungesë vizioni e koncepti se si të shkohet më tutje. Pati me të drejtë shumë pretendime nga redaksia "Flaka" për një ndarje me një pjesë të ndërtesës nga NGB "Nova Makedonija", por për këtë duhej të kishte përkrahjen e subjekteve politike shqiptare që merrnin pjesë në qeveri, por dhe nga vetë udhëheqësia e "Nova Makedonija–s". Bëhet fjalë jo vetëm për mungesë koncepti e vizioni dhe një konfuzioni për ardhmërinë, por dhe për mungesë vullneti. Privatizimi i mirëfilltë filloi duke ruajtur tërësinë e sistemit, me modelin më të dre–

jtë, por nga ana tjetër, më joefikas, me atë të blerjes së aksio–neve nga ana e të punësuarve. Procesi i blerjes, edhe pse të punësuarit tashmë kishin filluar të paguajnë këstet e para, qe ndërprerë në vitin 1998, me ndërrimin e pushtetit, kur Qe–veria e re dhe udhëheqësia e re e NGB "Nova Makedonija" zgjodhën rrugën e shitjes pjesë – pjesë të ndërmarrjes, duke filluar me shtypshkronjën, që pastaj të sjellin një firmë sllo–vene për t'ia shitur pjesën e gazetave dhe ndërtesës së re, por që statusi i së cilës, sot e kësaj dite ka mbetur i paqartë në ishte firmë fiktive e partisë kryesore në pushtet (VMRO–DPMNE), apo vërtet firmë sllovene e cila pati për qëllim ta mëkëmbë ndërmarrjen dhe të bëjë biznes, siç bie fjala bëri më vonë firma gjermane VAZ me disa gazeta private. Sido që të ketë qenë, në ndërmarrje u shfaq dyshimi dhe me presion të të punësuarve, e pastaj dhe me ndryshimin e sërishëm të pu–shtetit, u dëbuan pronarët sllovenë, me çka u hap procesi i falimentimit dhe nga gjithë ajo që pretendonin se u takon redaksive dhe njësive tjera punuese, u mbeti vetëm emri! Di–ku në vitin 2003 praktikisht u nxorën në shitje emrat (mo–dernçe: brendet) e gazetave, dhe ato u shitën për një grusht të vogël eurosh. "Flaka", bie fjala, u shit në përpjekjen e dytë, me dallim nga gazetat "Veçer" dhe "Nova Makedonija".

Pra, në përpjekjen e dytë, diku kah fillimi i vitit 2004, për më pak se 3000 euro u shit edhe brendi "Flaka". Vetë fakti se me çfarë çmimi u shit brendi, flet se në rrethana të reja, kur të gji–tha redaksitë humbën pronën e pretenduar, ato nuk e kishim më vlerën e tregut për të tërhequr investitorë. Por, megjithatë,

pronari formal, firma “Ital ice” dhe menaxhuesit e rinj, ndër–tuan një koncept për mëkëmbjen e “Flakës”, për herë të parë si gazetë private, për herë të parë pa kurrëfarë mbështetje nga shteti dhe në sprovën më serioze të mbijetesës në tregun e lirë, ku tashme kishte edhe një gazetë konkurrente. Meqë në këtë periudhë të re më ra hise të jem kryeredaktor i saj, mund të them se rikthimi i “Flakës” ishte shumë i suksesshëm, dhe sipas informatave të menaxhmentit, për gjashtë muaj sa doli nga maji deri në nëntor, pati një tirazh diku rreth 4000–6500 copësh, që ishte dhe ka mbetur mjaft respektabil krahasuar me të gjitha tirazhet që ka pasur “Flaka” më parë por dhe gazetat tjera në gjuhën shqipe, si dhe shumica e atyre në gjuhën maqedonase. Mirëpo, ajo që i mungoi ato gjashtë muaj gazetës, ishte një mbështetje financiare të cilën me gjasë as pronari i ri e as su–bjekti politik i cili në atë kohë i qëndronte mbrapa, nuk qenë në gjendje, apo nuk ditën ta sigurojnë. Nga këndvështrimi i sotëm, duket qesharake të mbyllet një gazetë që ishte në rritje të vazhdueshme, për një borxh jo shumë më të madh se 10 mijë eurosh (sipas pohimeve të Vait Ajros, menaxher), sa i ki–shte “Flaka” shtypshkronjës, duke pasur parasysh shumat mi–lionëshe që qeveria e sotme ndan për shumë media. Problemi kyç si duket qe realizimi i të hyrave, sepse gjersa “Flaka” i ki–shte borxh shtypshkronjës aq sa i kishte, por në të njëjtën kohë “Flaka” kishte trefish më shumë kërkesa nga subjekte të ndryshme. Ja të dhënat me të cilat disponon menaxheri i “Fla–kës”, Vait Ajro, për funksionimin e gazetës “Flaka” gjatë pe–riudhës maj–nëntor 2004:

"Gazeta Flaka u transformua me shitje të brendit në muajin shkurt të vitit 2004. Përgatitjet për riorganizimin e "Flakës" kanë filluar menjëherë pas ditës së blerjes dhe privatizimit të gazetës. Koha e nevojshme në dispozicion për riorganizim të gazetës nuk ishte e mjaftueshme për një biznes të kësaj natyre, megjithatë muaji në muajin maj 2004 doli numri i radhës dhe gazeta kishte ndryshuar në disa drejtime dhe atë:

−Logoja me disenj  të ri;

−Formati dhe numri i faqeve i ndryshuar tërësisht;

−Tirazhi fillestar i shtypur dhe i shpërndarë deri në 10.000 copë;

−Shitja e konsiderueshme e gazetës, me tirazh mesatar për periudhën e muajit maj−nëntor prej 5.400 copë në ditë;

−Hapësirat e redaksisë me një format të ri;

−Shpenzimet ditore për një tirazh mesatar në periudhën e gjashtë muajve arriti deri ne 3.000 euro;

−Të hyrat nga shitja me një ritëm të ngadalësuar në fillim dhe gjatë muajve në vijim kishte përmirësim dhe arrinte deri në 35 % të shitjes;

−Stafi redaktorial, gazetarët dhe të punësuarit e tjerë kanë qenë të angazhuar me kontratë në vepër. Pagat mujore kapnin vlerën mesatare prej 7.500 eurosh në muaj;

−Shpenzimet mesatare të shtypshkronjës për një ditë arrinin vlerën prej 1.500 euro;

Rezultati financiar për periudhën maj−nëntor 2004 për nga efikasiteti i qarkullimit financiar ka rezultuar me humbje prej 12.000 eurosh, por sipas Projekt−Planit të biznesit i cili u

hartua nga një organizatë e huaj me seli në Shkup, rezultonte se fundin e vitit të tretë dhe fillimi i vitit të katërt gazeta do kishte përmirësime në punën financiare me fitim prej 15.000 euro në muaj. Megjithatë gazeta dhe veprimtaria e marketingut arriti të sigurojë qëndrueshmëri financiare gjatë kësaj periudhe të shkurtër gjashtëmujore, duke pasur parasysh investimin që duhej të bëhej me sëpaku 20.000 eurosh në muaj. Sipas dinamikës së investimeve kishte nevojë për mbështetje financiare vjetore prej 150.000 deri 200.000 eurosh për periudhën e ardhshme. Institucionet publike dhe kompanitë që kanë reklamuar dhe kanë shpallur njoftime në gazetë gjatë periudhës sa ajo doli në treg kanë ngelur pa i paguar shërbimin e gazetës me vlerë prej 30.000 euro. Kurse gazeta ka pasur një borxh prej 12.000 euro në shtypshkronjën e atëhershme të "Nova Makedonija–s". Pra bilanci financiar me mjetet e parealizuara rezulton me një fitim minimal. Megjithatë joefikasiteti financiar i gazetës detyroi stafin menaxhues të ndërpresë botimin me të vetmen arsye të mungesës finaciare për ta tejkaluar periudhën e rimëkëmbjes gjatë vitit të parë dhe vitit të dytë".

Siç shihet nga kjo pasqyrë e shkurtër nga Vait Ajro, duket se pati një mosgjeturi në rrethana të reja edhe për vetë subjektin politik që hynte në qeveri për herë të parë, ndoshta dhe një moskoordinim midis stafit menaxhues, por dhe një shpërputhje të ambicieve se për një kohë të shkurtër mund të kthehej investimi.

Ajo që i shkon si përgjegjësi e pafalshme partisë shqiptare në pushtet (BDI–së) është mos shfrytëzimi i një pike të Marrë–

veshjes Kornizë të Ohrit (2001), në të cilën parashikohej mbështetje financiare për mediat në gjuhën shqipe. Të kishte qenë kjo parti më këmbëngulëse në këtë drejtim, "Flaka" do të ishte sot e kësaj dite një gazetë për shembull, sepse ndërtoi një fizionomi tërheqëse, udhëhiqte një politikë të hapur redaktuese, kishte një koncept të larmishëm rubrikash, kishte ambicie që t'i mbulojë ngjarjet dhe zhvillimet aktuale nga të gjitha trevat shqiptare në Ballkan. Për fat të keq, ajo nuk e pati sigurinë financiare për të paktën një vit gjersa të konsolidohej e gjithë shema e hyrje–daljeve, shitjes dhe shpërndarjes së tirazhit, të hyrat e reklamave dhe sponsorimeve.

## *A KA GJASA PËR RINGJALLJE?*

Është një dështim i dhimbëshëm, sepse për një shumë qesharake borxhi, u ndërpre, iu ndal hovi një ngritjeje solide të gazetës, e cila mund të vinte në gjendje që nga tirazhi dhe të hyrat e marketingut të mbijetonte pa problem. Shumë lexues me kompetencë, madje dhe gazetarë të mediave konkurrente sot e kësaj dite vënë në dukje se koncepti që pati gazeta në këtë periudhë, me një laryshi përmbajtësore për shijen e çdo le lexuesi, me qasjen e guximshme të temave, me informimin objektiv, por dhe qasjen kritike ndaj fenomeneve të ndryshme, ishte një koncept që lexuesit e kishin pritur kaherë. Por dhe duhet thënë se imazhi i një gazete të pavarur bashkë me traditën e ndritur që kishte pas vete, e bënin atë gazetë në nivel të lakmueshëm profesional.

Këtu diku dhe është përgjigja për atë që organizatorët e shë–nimit të këtij përvjetori e kanë lënë si pikë të fundit. A mund të ringjallet "Flaka"? – "Flaka" nuk mund të ringjallet vetëm me entuziazëm! Nuk përmenda këtu, se para se të shitej brendi i "Flakës", të nxitur nga entuaziazmi, me disa kolegë të tjerë, pa asnjë denarë investim, deshëm ta ngjallim. Mirë që nuk na ra në dorë neve, se me entuziazëm do ta kishim nxjerrë vetëm një numër me veresi! Pra, "Flakën" mund ta ngjallë ndonjë grup entuziastësh vetëm me mbështetje të fortë financiare të ndonjë firme të suksesshme që ka vizion për bi–znes. Sigurisht se ka dhjetëra firma të suksesshme shqiptare që do t'u levërdiste përmes "Flakës" jo vetëm të shtojnë reputa–cionin e tyre, por dhe të kenë levërdi biznesi.
Për periudhën që bëra fjalë më lartë u pa se lexuesit nuk e harrojnë faktin që "Flaka" ka qenë dhe ka mbetur sinonim i emancipimit kombëtar, ka qenë dritare për informimin e gje–neratave, ka qene prodhuesja më e madhe e librave, tubuese e ajkës intelektuale dhe për këtë gëzon respekt, dhe digë ndaj presioneve që i ka pasë vazhdimisht. Një "Flakë" të tillë ia vlen ta ringjallësh, edhe pse dhjetë vjet pas shuarjes, shumëçka ka ndryshuar në fushën e zhvillimeve tekniko–teknologjike, ku gazetat ngapak janë të rrezikuara nga shpërthimi masiv i faqeve elektronike, ku profesionale e ku gjysmë profesionale.

*(Autori ka qenë ushtrues detyre i kryeredaktorit, e pastaj zëvendës–kryeredaktor i "Flakës së vëllazërimit" në periudhën 1993–1998, dhe kryeredaktor në periudhën e "Flakës" së privatizuar maj–nëntor 2004)*

*Mixhait Pollozhani*
*Ish–korrespondent nga Struga*

# *– NGA NOTESI I NJË KORRESPONDENTI –* KRONIKË STRUGANE DHE GJURMË KOHËSH

Të jesh gazetar në provincë nuk është fare punë e lehtë. Atje të gjithë të njohin dhe është e vështirë që të ndërtosh relacione profesionale me lexuesin. Pra, të jesh korrespondent do të thotë se, njëkohësisht je edhe gazetar edhe redaktor. Pjesën më të madhe të temave i zgjedh vetë. Por varet se çka.

Megjithatë, puna e gazetarisë është një përvojë shumë interesante. Përjeton ngjarje dhe takon njerëz me fate të ndryshëm. Sigurisht që ata lënë gjurmë të cilat të përcjellin gjatë tërë jetës. Por duhet theksuar se puna ime në gazetën "Flaka e vëllazërimit", dhe pastaj "Flaka", lidhet me dy momente shumë domethënëse. Njëra me faktin që unë fillova punën në të në kushte të pluralizmit demokratik. Dhe tjetra, që vetëm pas tre vitesh që kisha filluar, ajo u bë gazetë e përditshme.

Ka edhe shumë gjera tjera që vlejnë të përmendën. Atë ditë të qershorit kur unë mora vendimin e punësimit në gazetën "Flaka" ndodhi "rrethimi i Ladorishtit" nga forcat policore maqedonase. Me rëndësi të madhe për mua është edhe prania ime si gazetar në Konferencën Paqësore me karakter ndërkombëtar e cila u mbajt në vitin 1992 në Ohër, atyre ditëve kur edhe ndodhën ngjarjet e përgjakshme të Bit Pazarit. Si

korrespondent po ashtu pata rastin që t'i përcjellë bisedimet që përfunduan me nënshkrimin e Marrëveshjes së Ohrit dhe ndërprerjen e luftimeve ndërmjet Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare dhe Forcave të Armatosura të Maqedonisë.

Gjithashtu, pata rastin që të jem pjesëmarrës dhe për të shkruar për vendimin e themelimit të Festivalit "Këngë Jeho" të Strugës. Ta njoh, të bashkëbisedoj dhe të shkruaj për njeriun (Remzi Qokun), i cili i kishte lexuar të gjithë numrat e "Flakës", pra, që nga numri i parë dhe deri sa ishte i gjallë. Shkrova për njeriun (nga fshati Bogovicë) që kishte shërbyer si bari (në fshatin Jabllanicë), i cili, ndonëse vetëm pesë – gjashtë kilometra në vijë ajrore largësi, megjithatë, për më shumë se 60 vjet nuk kishte shkelur në vendlindjen e tij. E paharruar më ka mbetur vizita në shtëpinë "ku mbretëronte heshtja", për çka edhe botova reportazhin kushtuar çiftit familjar nga fshati Tatesh i Poshtëm, e cila nga pesë fëmijët, katër prej tyre kishin probleme me dëgjimin dhe të folurin. Shënimi për zhdukjen e dy vajzave nga Ladorishti të cilat nuk u gjetën kurrë, vrasjen enigmatike të veprimtarit të shquar, Naser Hani (nga Veleshta) në qendër të Strugës që ende nuk është zbuluar.

Ka edhe shumë gjera më kanë mbetur në kujtesë nga përvoja ime pothuajse 15 vjeçare e korrespondentit të "Flakës" nga Struga. Por, unë do të veçoja edhe dy përjetime, të cilat sigurisht që kanë domethënie për mua si gazetar, por edhe për të pasqyruar pozitën dhe rolin e të vetmes gazetë në gjuhën shqipe që asokohe dilte në Maqedoni.

Njëra ka të bëjë me lajmin tim të parë të botuar në gazetën "Flaka", për të cilin mendoja se askush tjetër nuk di të shkruajë më mirë se unë. Kuptohet, që ajo ishte hipokrizia ime më e marrë, që vinte si rezultat i mosdijes dhe mungesës së modestisë. Pastaj, tjetra ka të bëjë me një batutë (e cila u bë pjesë e një shënimi të atëhershëm në gazetë), e cila kishte simbolikën e saj. Sa herë që unë shkruaja për qytetin apo vendbanimet tjera, veleshtarët (kuptohet jo të gjithë) reagonin menjëherë pse nuk shkruaja për Veleshtën. Kur një ditë një lexues i rregullt më bënte vërejtje pse nuk kisha shkruar për diçka që kishte të bëjë pikërisht me Veleshtën, një shoqëruesi i tij në mënyrë sarkastike ia priti: "Gazetari nuk ka shkruar sepse i është thyer maja e bukës së lapsit!".

Dhe sot nga kjo distancë kohore, unë mendoj se ai lexues (të cilin e kam dhe të afërm dhe rri me të), ka pasur plotësisht të drejtë me atë thumbimin e tij. Sigurisht, që nuk është i vogël numri shkrimeve të mija, por ama duhet pranuar se, sa e sa tema që thuajse kalonin para syve të mi, unë nuk i shikoja dhe nuk i shkruaja dot. Por, ndonjërën besoj se edhe ia qëlloja. Të themi siç është jetëshkrimi në vijim kushtuar Strugës, qytetit me bukurinë më përrallore që ia ka falur Zoti, por që struga–nët këtë nuk dinë ta çmojnë!

⋆ ⋆ ⋆

*"Që kur se këtu ka filluar jeta, që atëherë e këndej, si ka ra ndërmend kujt se ky qytet do të zhvillohet si nevojë e përdi–*

*tshmërisë së zakonshme, kurse jeta në të do të sjellë edhe mjaft të papritura tjera".*

Nëse ndonjëherë të bije ndërmend Struga, ose po të shkruash për të, gjithmonë para syve të dalin: liqeni, lumi, plazhi, hotelet, trofta, ngjala, mbrëmjet e poezisë, festivali i këngës shqipe, kurbetçinjtë. Këto janë atributet të cilat e bëjnë të pakapërcyeshëm imazhin e qytetit të bukur dhe piktoresk. Të qytetit i cili laget nga brigjet e Liqenit të Ohrit dhe shtrihet gjerë e gjatë buzë brigjeve të Drinit të Zi, ku jeta vazhdoi të rrjedh këtu e pesë mijë vjet me radhë. Dhe cilit do që njëherë i ka rastisur të ketë qëndruar, ose të ketë kaluar këtu, nuk ka se si të mos i ketë ngelur një mbresë në kujtesën e tij. Prandaj do të ishte i drejtë vlerësimi modest se, gërshetimi i dhuntive natyrore dhe specifikave tjera e bëjnë të veçantë qytetin.

Ndërkohë që një vlerësim tjetër do të ndikonte pak sa më paradoksal. Në këtë mjedis të përkatësive të ndryshme nacionale, fetare dhe kulturore, nuk u përkasin të gjithëve një lloj dhuntitë dhe të mirat tjera natyrore. Diçka sikur nuk shkon! Uji i kthjelltë, ajri i pastër dhe hapësira e gjerë sikur nuk mjaftojnë për të gjithë. Mbase janë pasojë e defekteve të "mekanizmit të natyrës" ose po defekte të "mekanizmit shoqëror". Ndoshta po janë pasojë e paaftësisë për të bashkëjetuar me të tjerët si nevojë dhe detyrim i "fateve historike".

⋆ ⋆ ⋆

Dihet se edhe Struga ka të kaluarën e saj sa të njohur aq edhe misterioze. Nga një vendbanim i dikurshëm i vogël i rrethuar

me moçale, sot ka marrë pamjen e një qyteti të njëmendtë. Me rregullim urbanistik dhe infrastrukturë të kënaqshme, të nevojshme dhe të pranueshme për një qytet turistik. Përja–shtim bëjnë vetëm disa lagje, kryesisht ato ku me shumicë janë shqiptarët. Një nga atë është "Tingërr–mahalla", e cila të përkujton pamjen e viteve dyzeta.

Pra, kthimi kah e kaluara të detyron ti kërkosh gjurmët. Gjurmët nëpër kohë që shënjuan lindjen, mbijetesën dhe lu–lëzimin e kulturave të atyre që jetuan në këtë nën–qiell. Atë të kaluar që është shndërruar në legjendë. Njëra ndër legjen–dat më interesante është ajo e "Kadmit dhe Harmonisë", të cilëve banorët e hershëm të këtij vendbanimi i kanë kushtuar edhe një vend kulti, mu aty ku Drini del nga liqeni. Fjala ë–shtë për kishën e vogël "...". Legjenda thotë se "Kadmi dhe Harmonia" pasi u vendosën në këto toka lindën një djalë të cilin e quajtën Ilir. Nga Iliri pastaj lindi Enkelue dhe Dasara. Pra nga Enkeljtë lindën Dasaretët.

E kaluara ruhet sa nën thellësitë e tokës po aq edhe mbi te. Vendbanimi i dikurshëm i tipit "palafit" sot është zëvendësuar me shumë objekte të reja. Arkitektura tradicionale me vlera monumentale e ka humb pamjen autentike. Punëtoritë e di–kurshme të zejtarëve përgjatë rrugës kryesore, e popullarizuar dekadave të fundit si "korzo" e qytetit janë zëvendësuar me dyqane të reja tregtie. Aty këtu edhe mund të ruhet ndonjë "relikt" që të përkujton kohën e dikurshme. Nga e kaluara më e afërt diçka më shumë ruhet në kujtesën e më të mo–shuarve. Dëshmitarët e gjallë kujtojnë se te sheshi i qytetit, aty

ku sot ndodhet “Monumenti i Revolucionit” kah vitet e dyzeta, qëndronte lapidari me shqiponjën dykrenore ku kanë qen të shkruar emrat e të rënëve në Betejën e Petrinjës në vitin 1913, që ka ndodhur në kuadër të Kryengritjes Shqiptare të Shatorit.

Këtu edhe e ka zanafillën paradoksi i kohës sonë, që vështirë ia gjen dot shpjegimin. Pasi që, kur nuk pranohet ballafaqimi i fakteve të një realiteti, krijon shqetësime. Shqetësime që ngacmojnë ndërgjegjen e kërkimit të vetvetes.

Në këtë “kasaba” sado e vogël që ka qenë, udhëpërshkruesi Evlia Çelebiu dhe shënimet e defterëve të kadastrave, na mësojnë se gjithmonë me shumicë kanë jetuar shqiptarët. Aty ka jetuar dhe sunduar familja e njohur Gropaj. Por sot ndryshon gjendja demografike. Nga rreth 63 mijë banorë të komunës (Struga me gjithë rrethinë) sipas të dhënave të fundit zyrtare rreth 18 mijë banorë jetojnë në qytet. Ndërkaq, shqiptarët që përbëjnë afro gjysmën e numrit të përgjithshëm të popullatës së Komunës së Strugës, mbi 80 % e tyre jetojnë në fshat. Këto të dhëna flasin më së miri për politikën restriktive dhe diskriminuese demografike ndaj shqiptarëve.

Për punësimin e shqiptarëve, qoftë në administratën komunale apo edhe në atë shtetërore as që mund të bëhet fjalë. Ky numër është tejet simbolik. Të shtyrë nga papunësia, shqiptarët moti janë detyruar të marrin rrugën e kurbetit. Kështu për dekada me radhë vazhdon në pafundësi “odiseada” e fatit të tyre. Askush nuk e dinë saktësisht se sa janë shpërngulur për ekzistencë në dhe të huaj. Por me siguri që është tejet i madh

ky numër. Dhe refreni shumë i përsëritur na është bërë për–ditshmëri: "...e lëshuam vendin", pas të cilat pastaj pason për–gjigja: "s'ke çka i bënë, të detyron nevoja!!!???".

⋆ ⋆ ⋆

Jeta edhe pse e këtillë, megjithatë, ajo vazhdon. Ndonëse qyteti poezisë, jeta këtu nuk tingëllon edhe aq poetike! Ndo–nëse, më shumë se tridhjetë vite këtu tubohen poetë nga gji–thë bota, me gjuhë dhe kultura të ndryshme, kuptohen dhe gjejnë mirëkuptim midis tyre. Ndërkohë që shqipja, për të mos thënë fare, shumë pak përfillet. Pos ndonjë mbishkrimi në gjuhën shqipe nëpër dyqane, të shkruara me vetë dëshirën e pronarëve të tyre, nëpër institucionet e komunës nuk e gjen dot një gjë të këtillë. Arsyetim i është se kjo nuk është rre–gulluar me ligj.

Nevoja për ekzistencë, viteve të fundit qytetin e ka kthyer në një qendër të kaosit tregtar. Edhe pse me disa qendra tregtare, siç janë "Bezistani", "Tregu i Qytetit", dyqanet e rinj, kafe–teritë dhe restorantet mbijnë si kërpudhat. Dikur paguhej e–dhe deri në tre ose katër mijë marka gjermane për metër ka–trorë të një dyqani, dhe shumë vështirë mund ta gjeje. Kohë të fundit gjendja sikur po ndryshon, sepse njerëzit filluan të mësohen. U pa se sa është kapaciteti i aftësive tregtare në Strugë. Me një fjalë ligjet dhe logjika e përgjithshme e tregtisë po depërton edhe në mentalitetin e tregtarëve. Tregu është përplot, mallrat vijnë prej kah mos. Por, kuptohet, se domi–

nojnë mallrat nga Turqia, "mallra të mirë dhe të lirë" siç do të thonin tregtarët.
Megjithatë, kriza ekonomike e bënë të veten. Dita ditës është më i madh numri i shtresës që e ka të rrezikuar ekzistencën minimale. Për katandisje në këtë gjendje, më shpesh fajësohet politika, sidomos udhëheqësit politik. Por, sidoqoftë, në këto kohë të trazuara politike, shumica e struganëve me padurim e presin stinën e verës. Turizmi, me gjasë është segmenti mjaft i rëndësishëm për ekonominë së Strugës. Presin me shpresë që të fitojnë diçka gjatë këtij sezoni. Mirëpo e keqja është se sezoni turistik zgjat shumë shkurt, vetëm dy muaj dhe ata jo të plotë. Sidoqoftë, shpresohet për më mirë!

★ ★ ★

Përditshmëria strugane, në këto kohë të pakohë, siç do ta quante shumëkush, ka edhe anën tjetër të monedhës. Atë që në emër të nevojës për të mbijetuar e që fshihen prapa perdes, gjë që për çdo ditë është më e pranishme në mjedisin tonë. I kushtëzuar nga misteri dhe stihia e kohës, po merr hov formësimi i një pseudo–botëkuptimi që për kriter vlerësimi ka moralin e rrejshëm. Bota për këta kuptohet vetëm si "përputhje interesash për përfitime personale". Të këtillët nuk zgjedhin mënyra dhe mjete për t'i shfrytëzuar situatat e krijuara. Ka të dhëna se shitblerja e drogës bëhet me të madhe, kurse numri i atyre që e konsumojnë atë, sidomos te moshat e reja, fatkeqësisht është në rritje e sipër. Kuptohet që edhe shqiptarët janë viktima të këtij fenomeni morbid. Por, fatkeqësisht,

për këtë "murtajë" bashkëkohore askush nuk kujdeset dhe as që merren masa.
Ndërkaq, qytetari i rëndomtë, i pafuqishëm të ndryshojë diç–ka, mbetet vetëm dëshmitar i kohës. Në këto të ashtuquajtura "mendje kohësh" nuk ka se kah t'ia mbajë, është gjetur në hall, këndej–lartë, andej–poshtë. Të vështirë e ka që t'u për–ballojë atyre që shtirën se pretendojnë për një botë më të mirë dhe më të drejtë, por në fakt sillen krejt ndryshe.

⋆ ⋆ ⋆

Sigurisht, që ka edhe këndvështrime tjera për t'iu qasur të ka–luarës dhe të sotmes së Strugës. Megjithatë, gjurmët të rilexuara si fakte, janë ato që shërbejnë për të shkruar edhe një kronikë të këtillë. Kronikë kjo që vjen me rastin e jubileut të madh të "Flakës". Jubile me të cilin jetojnë edhe struganët, që për pe–sëdhjetë vjet me radhë përjetuan shumëçka të përbashkët.
Përndryshe, Strugën e presin edhe përkujtime tjera nga e ka–luara. Në prag janë dy përvjetorët, të lindjes dhe vdekjes së veprimtarit të shquar Ibrahim Temo, i cili edhe pse i lindur në këtë qytet, jetoi, veproi dhe vdiq larg vendlindjes. Është koha që kësaj figure, që së paku në mënyrë simbolike, t'i bëhet rikthimi në vendlindje.

⋆ ⋆ ⋆

Dhe si përfundim, do të përkujtoja edhe atë se pse është e vështirë të jesh korrespondent në qytet të vogël? Është e vë–shtirë sepse një ditë të hidhërohet gjysma e qyteti, ditën tjetër

gjysma tjetër, të tretën nuk të flet askush, dhe tek ditën e katërt i ke punët mirë me të gjithë. Prandaj ua qaj hallin gazetarëve, sidomos, korrespondentëve.

Mbase rastësisht, por megjithatë i bije sikur unë e zbatova thënien e famshme të Winston Çerçil, që, *"Gazetaria është një profesion shumë i mirë, por duhet lëshuar me kohë".* Megjithatë, edhe përkrah kësaj thënie, dhe atyre vështirësive që përjetova, të them të drejtën, më mungon gazetaria!

# PAMJE
# NGA TRIBUNA DHE EKSPOZITA




Pamje nga zhvillimi i punimeve të debatit



Këshilli organizativ – *nga e djathta*: Sefer Tahiri, Skender Asani, Naser Selmani dhe Sevdail Demiri




Abdylhadi Zylfiqari, Faik Mustafa, Enver Shala, Abdurrahman Kurtishi…




*Nga e djathta:* Zeqirja Rexhepi, Tahir Zajazi...



*Nga e djathta:* Petro Janura (i riu), Xoxi Janura, Haki Selimi dhe të tjerë



*Nga e majta:* Azam Dauti, Avzi Mustafa, Mixhait Pollozhani, Halil Zendeli, Fadil Curri, Rexhep Bajrami

Gazeta "FLAKA e Vëllazërimit" - 70 vjetori

1.464.1.167/386

„Flaka e Vllaznimit"
ETORE E PËRJAVËSHME SHQIPE
№ 26
19-Juni-1945
SHKUP

ДРЖАВЕН АРХИВ НА РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА СКОПЈЕ

Do

GLAVNIOT ODBOR NA E.N.O.F. NA MAKEDONIJA

T u k a

Vi saopštavame da našiot vesnik "FLAKA E VLLAZNIMIT",ne izleguva redovno,eden pat nedelno, kako što e rešeno,za krivicata na štamparijata, koja, i ako ima vozmožnost da gi stavi vo rabota četiri rabotnici,kolko sa i potrebni,za redovno izleguenje na našiot vesnik,taja upotrebuje samo dve rabotnici.

Četvrti broj na vesnikot izleze na 25-Maj, Materjalot na petija broj go ispratimve vo štamparija na 8 - Juni - 1945 god.; so se toa ovaj broj ošte ne izlegov.

Molime da se intervenira, pri štamparijata " Goce Delcev " za da pobrzat rabotite na štampanjeto,po nezi moralno se oštetujemo,kogaj Albanskata čitalna masa čeka bes sterpenije izlezuenjeto na vesnikot.-

SMRT NA FAŠIZAMOT - SLOBODA NA NARODOT !

D i r e k t o r i j a

„FLAKA E VLLAZNIMIT" Direktoria SHKUP

P. Janura

• Ankesë e drejtorit P.Janura, për vonesën e shtypit të Flakës. Dokument i Arkivit të RM-së •

Gazeta "FLAKA e Vëllazërimit" - 70 vjetori



„Flaka e Vllaznimit"
FLETORE E PËRJAVËSHME SHQIPE
№ Sluzbeno
2- Avgustos 1945
SHKUP

Do GLABNIOT ODBOR NA E.N.O.F.

Tuka.

Prema aktot na Ministarstvoto na Socjalnata Politika, Br. Sluzbeno, dt. 26-VII-1945 god., kako i prema saopstenije na drugarot Qemal Agolli, na mesto Xheladin Palloshi i Hashim Toplica, koji su bili do sega vo ovija Redakcija kako prevoditeli, dojde Mustafa Hatibi i Skënder Pustina. Zatoa spisak za platite, kako nam javue Kemal Agolli, ke bide ovako:

1.- Dr. Petro Janura = 4000 dinara.
2.- Kamer Xherija = 3500 "
3.- Ali Mullai = 3300 "
4.- Mustafa Hatibi = 3000 "
5.- Skënder Pustina = 2500 "
6.- Ahmet Shabani = 1800 "

Redakcija:
Xherija



• Kuadrot e para të Flakës në regjistrin e pagesës. Dokument i Arkivit të RM-së. •

Gazeta "FLAKA e Vëllazërimit" - 70 vjetori

"FLAKA E VLLAZNIMIT" do 9-6 broj

Flaka e Vlaznimit započnala da ispadja na 4 april 1945 god.
so tiraž od 2400 komada.Ovaj tiraž dostigna sumata od 7.000 komada,a dene-
šniot tiraž e 4.000 parčinja.Umanjuvanjeto na tiražot se dolži na tova šo
licata koji go rasturuvaet našiot vesnik ne ni ispratile nikogaš točno ko-
lku vesnici možat da se prodadat,ma dase od niv tova baralo na nekolku pa-
ti,tuku nakon nekolku meseci kako odgovor na našeto baranje tija ni ispra-
tie edna golema količina na neprodadeni vesnici.

Eden drug faktor na tova e nestaranjeto na učitelite koji s
dobrovoljno go zedoe na sebe rasturuvanjeto na vesnicite.Ovija učiteli vo
početakot pobarae šo poće brojevi od vesnikot so nadež deka će možat da gi
prodadat,i za nekolku brojevi na vesnikot tiražot od 7.000 komada beše nu-
žen sprema baranjeto na ovija učitelji i čitalaci.Na osnovu na ovo baranje
se ugolemi tiražot,ali posle izvesno vreme tie ne obavestie da ne se pro-
dava vesnikot.Taka nastana so Debar koji vo početakot baraše 250 komadaa
a deneska ne troši-vo isključenije na pretplatnicite poće od 25 komada.Ki-
čevo vo početakot zemaše 200 komada a deneska ne zima nitu eden.Struga od
100 komada deneska zima 75 komada.Seloto Gorno Nerezi Skopje zimaše 30 ko-
mada a deneska ne zima nitu eden.Gostivar vo početakot zimaše 700 komada
a deneska troši samo 300 komada i ovaj broj ne e točen a ovo proisteknuva
